

20200420813

LIGJ PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE(*)

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Përmbajtja e ligjit

Neni 1

Me këtë ligj rregullohet mbrojtja e të dhënave personale dhe e drejta për privatësi në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, kurse veçanërisht parimet në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, të drejtat e subjektit të të dhënave personale, pozita e kontrollorit dhe përpunuesit, transferimi i të dhënave personale në shtete tjera, themelimi, statusi dhe kompetencat e Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, operacione të veçanta të përpunimit të të dhënave personale, mjetet juridike dhe përgjegjësia gjatë përpunimit të të dhënave personale, supervizioni mbi mbrojtjen e të dhënave personale si dhe kundërvajtjet dhe procedura për kundërvajtje në këtë fushë.

Zbatimi material

Neni 2

(1) Ky ligj zbatohet për përpunim tërësisht ose pjesërisht të automatizuar të të dhënave personale dhe të përpunimit tjetër të të dhënave personale të cilat janë pjesë e përmbledhjes ekzistuese të të dhënave personale ose janë dedikuar të jenë pjesë e përmbledhjes së të dhënave personale.

(2) Dispozitat e këtij ligji nuk do të zbatohen për përpunimin e të dhënave personale që bëhet nga ana e personave juridikë, ekskluzivisht për shkak të aktiviteteve personale ose aktiviteteve në shtëpi.

Zbatimi territorial

Neni 3

(1) Dispozitat e këtij ligji zbatohen mbi përpunimin e të dhënave personale nëse kontrollori ose përpunuesi është i themeluar në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, pavarësisht nëse përpunimi i të dhënave personale bëhet në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut ose jashtë kufijve të saj.

(2) Dispozitat e këtij ligji zbatohen mbi përpunimin e të dhënave personale të subjekteve të të dhënave personale nga Republika e Maqedonisë së Veriut, nga ana e kontrollorit ose përpunuesit që nuk është i themeluar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me ç'rast aktivitetet për përpunim të të dhënave personale ndërliken me:

- ofertë të mallrave ose shërbimeve, pavarësisht nëse nga subjekti i të dhënave personale nga Republika e Maqedonisë së Veriut kërkohet të bëjë pagesë ose

- mbikëqyrje të sjelljes së subjekteve të të dhënave personale, nëse ajo sjellje zhvillohet në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

□ Me këtë ligj bëhet harmonizim me rregullativën evropiane në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale edhe atë: Rregullativën (BE) 2016/679 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit nga 27 prill 2016 për mbrojtje të personave fizikë në aspekt të përpunimit të të dhënave personale, për qarkullim të lire të të dhënave të tilla dhe për shfuqizim të Direktivës 95/46/BE (Rregullorën e përgjithshme për mbrojtje të të dhënave) CELEX numër 32016R0679.

(3) Dispozitat e këtij ligji zbatohen mbi përpunimin e të dhënave personale nga ana e kontrollorit i cili nuk është i themeluar në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, por është i themeluar në territor ku aplikohet legjislacioni i Republikës së Maqedonisë së Veriut sipas marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Përkufizime

Neni 4

(1) Shprehje të veçanta të përdorura në këtë ligj e kanë këtë kuptim:

1. **“Të dhëna personale”** është secila informatë që ka të bëjë me person fizik të identifikuar ose person fizik i cili mund të identifikohet (subjekt i të dhënave personale), kurse person fizik i cili mund të identifikohet është person identiteti i të cilit mund të përcaktohet drejtpërsëdrejti ose tërthorazi, veçanërisht në bazë të identifikuesit siç janë emri dhe mbiemri, numri i amzës i qytetarit, të dhëna për lokacionin, identifikator nëpërmjet internetit, ose në bazë të një ose më shumë veçorive specifike për identitetin e tij fizik, fiziologjik, gjenetik, mental, ekonomik, kulturor ose social të atij personi fizik;

2. **“Përpunim i të dhënave personale”** është secili operacion ose përmbledhje e operacioneve të cilat kryhen mbi të dhënat personale, ose grup i të dhënave personale, në mënyrë automatike ose tjetër, siç janë: grumbullim, evidentim, organizim, strukturim, ruajtje, adaptim ose ndryshim, tërheqje, konsultim, këqyrje, përdorim, zbulim nëpërmjet transmetimit, publikim ose bërje të kapshme ndryshe, harmonizim ose kombinim, kufizim, shlyerje ose asgjësim;

3. **“Kufizim i përpunimit të të dhënave personale”** është shënim i të dhënave personale të cilat ruhen, e me qëllim të kufizimit të përpunimit të tyre në të ardhmen;

4. **“Profilim”** është secila formë e përpunimit automatik të të dhënave personale, që përbëhet nga përdorimi i të dhënave personale për vlerësim të aspekteve të caktuara personale në lidhje me personin fizik, kurse veçanërisht për analizë ose parashikim të aspekteve të cilat kanë të bëjnë me kryerjen e obligimeve profesionale të atij personi fizik, gjendjen e tij ekonomike, shëndetin, preferencat personale, interesat, besueshmërinë, sjelljen, lokacionin ose lëvizjen;

5. **“Pseudonimizim”** është përpunim i të dhënave personale në mënyrë që të dhënat personale nuk mund të ndërlidhen me subjekt të caktuar të të dhënave personale pa u shfrytëzuar informata shtesë, me kusht që informatat e tilla shtesë të ruhen veçmas dhe t’u nënshtrohen masave teknike dhe organizative me të cilat do të sigurohet që të dhënat personale nuk ndërlidhen me person fizik të identifikuar ose person fizik i cili mund të identifikohet;

6. **“Përmbledhje e të dhënave personale”** është grup i strukturuar i të dhënave personale që është e aksesshme në pajtim me kritere specifike, pa marrë parasysh nëse është e centralizuar, e decentralizuar ose e përhapur në bazë funksionale ose gjeografike;

7. **“Kontrollor”** është person fizik ose juridik, organ i pushtetit shtetëror, organ shtetëror ose person juridik i themeluar nga shteti për kryerje të autorizimeve publike, agjenci ose trup tjetër i cili në mënyrë të pavarur ose së bashku me të tjerë i përcakton qëllimet dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, kurse kur qëllimet dhe mënyra e përpunimit të të dhënave personale janë përcaktuar me ligj, me ligjin e njëjtë përcaktohen kontrollori ose kriteret e veçanta për caktimin e tij;

8. **“Përpunues i përmbledhjes së të dhënave personale”** është person fizik ose juridik, organ i pushtetit shtetëror, organ shtetëror ose person juridik i themeluar nga shteti për kryerje të autorizimeve publike, agjenci ose trup tjetër që i përpunon të dhënat personale në emër të kontrollorit;

9. **“Shfrytëzues”** është person fizik ose juridik, organ i pushtetit shtetëror, organ shtetëror ose person juridik i themeluar nga shteti për kryerje të autorizimeve publike, agjenci ose trup tjetër të cilit i zbulohen të dhënat personale pavarësisht nëse është ky është person i tretë ose jo. Megjithatë, organet e pushtetit shtetëror dhe organet shtetërore të cilëve u zbulohen të dhënat personale në kuadër të hetimit të veçantë në pajtim me ligj, nuk konsiderohen si shfrytëzues, me ç’rast përpunimi i këtyre të dhënave nga këto organe duhet të jetë në pajtim me rregullat në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale sipas qëllimeve të atij përpunimi;

10. **“Person i tretë”** është çdo person fizik ose juridik, organ i administratës shtetërore, organ shtetëror ose person juridik i themeluar nga shteti për kryerje të autorizimeve publike, agjenci ose trup tjetër, që nuk është subjekt i të dhënave personale, kontrollues, përpunues ose person, i cili është nën autorizim të drejtpërdrejtë të kontrollorit ose përpunuesit në mënyrë të autorizuar t’i përpunojë të dhënat;

11. **“Pëlqim”** i subjektit të të dhënave personale është çdo vullnet i paraqitur, i shprehur konkret, i informuar dhe i padyshimtë i subjektit të të dhënave personale nëpërmjet deklaratës ose veprimit qartë të konfirmuar, kurse me të cilat shprehet pëlqimi për përpunimin e të dhënave të tij personale;

12. **“Cenim i sigurisë së të dhënave personale”** është çdo cenim i sigurisë që shpie në shkatërrim të rastësishëm ose të paligjshëm, humbje, ndryshim, zbulim të paautorizuar ose qasje të të dhënave personale të cilat transferohen, ruhen ose përpunohen në mënyrë tjetër;

13. **“Kategori të veçanta të të dhënave personale”** janë të dhëna të cilat zbulojnë origjinë racore ose etnike, qëndrime politike, bindje fetare ose filozofike ose anëtarësi në organizata sindikale, si dhe të dhëna gjenetike, të dhëna biometrike, të dhëna që kanë të bëjnë me shëndetin ose të dhëna për jetën seksuale apo orientimin seksual të personit fizik;

14. **“Të dhëna gjenetike”** janë të dhëna personale në lidhje me karakteristikat gjenetike të personit fizik të cilat janë të trashëguara ose të fituara, kurse të cilat zbulojnë informatë të vetme për fiziologjinë ose shëndetin e tij, e cila posaçërisht fitohet me analizës së mostrës biologjike nga ai person fizik;

15. **“Të dhëna biometrike”** janë të dhëna personale të cilat fitohen nëpërmjet përpunimit specifik teknik të karakteristikave fizike ose fiziologjike të personit fizik ose karakteristika të sjelljes së tij, kurse nëpërmjet të cilave mundësohet ose vërtetohet identifikimi unik i personit fizik;

16. **“Të dhëna që kanë të bëjnë me shëndetin”** janë të dhëna personale në lidhje me shëndetin fizik ose mental të personit fizik, duke i përfshirë edhe të dhënat për mbrojtjen e fituar shëndetësore të cilat zbulojnë informata për shëndetin e tij;

17. **“Përfaqësues”** është person fizik ose juridik i themeluar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, që është i përcaktuar nga ana e kontrollorit ose përpunuesit i cili nuk është i themeluar në Republikën e Maqedonisë së Veriut me qëllim që ta përfaqësojë kontrollorin, përkatësisht përpunuesin në lidhje me obligimet e tij që rezultojnë nga ky ligj, me ç’rast përfaqësuesi përcaktohet në formë të shkruar në pajtim me nenin 31 të këtij ligji;

18. **“Rregulla obligative korporative”** janë politika për mbrojtjen e të dhënave personale të cilat respektohen nga ana e kontrollorit ose përpunuesit të themeluesit në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjatë transferimit ose serisë së transferimeve të të dhënave personale nga Republika e Maqedonisë së Veriut te kontrollues ose përpunues në një ose më tepër vende të treta në suaza të grupit të shoqërive (shoqëri të lidhura) ose grup të personave juridikë të cilët kryejnë veprimtari të përbashkët ekonomike;

19. **“Shërbime të shoqërisë informatike”** janë shërbime të cilat janë të përkufizuara në dispozitat për tregti elektronike;

20. **“Organizatë ndërkombëtare”** është organizatë dhe organet e saj të rregulluara me të drejtën publike ndërkombëtare ose çfarë do organi tjetër i formuar nga ana e ose në bazë të marrëveshjes ndërmjet dy ose më tepër shteteve;

21. **“Marketing i drejtpërdrejtë”** është çdo lloj komunikimi i realizuar në çfarë do mënyre sipas arritjeve më të reja teknologjike, kurse me qëllim të dërgimit të përmbajtjes reklamuese, marketingu ose propaganduese e cila është e fokusuar drejtpërsëdrejti kah ndonjë subjekt i të dhënave personale, si dhe përpunimi i të dhënave personale që përfshin edhe profilim deri në atë shkallë deri në të cilën i njëjti lidhet me këtë lloj komunikimi.

22. **“Trup mbikëqyrës”** është Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale e cila ka status të organit të pavarur shtetëror dhe të mëvetësishëm e themeluar në pajtim me këtë ligj (në tekstin e mëtejme: Agjencia).

23. **“Hulumtim”** në kuptim të këtij ligji është procedurë e testimi dhe kontrollimit të ndonjë kontrollori ose përpunuesi në lidhje me ligjshmërinë e aktiviteteve që janë ndërmarrë nga ana e tij gjatë përpunimit të të dhënave personale dhe mbrojtja e tyre gjatë zbatimit të këtij ligji dhe dispozitat e miratuara në bazë të këtij ligji,

24. **“Organ i pushtetit shtetëror”** në kuptim të këtij ligji janë organe dhe institucione tjera shtetërore të themeluara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut ose në pajtim me ligj tjetër,

25. **“Ikonë”** në kuptim të këtij ligji është pasqyrë vizuale e aplikacionit ose programit softuerik tashmë të instaluar në sistemin informatiko-komunikues të cilin e përdor subjekti i të dhënave personale dhe është i kuptueshëm për përdoruesin e sistemit.

(2) Shprehjet që përdoren në këtë ligj, domethënia e të cilave nuk është përkufizuar në paragrafin (1) të këtij neni, kanë domethënie të përcaktuar me ligj tjetër.

Ndalimi për diskriminim

Neni 5

Mbrojtja e të dhënave personale garantohej për çdo person fizik pa diskriminim të bazuar mbi nacionalitetin, racën, ngjyrën e lëkurës, besimet fetare, përkatësinë etnike, gjininë, gjuhën, bindjet politiket ose të tjera, pozitën materiale, prejardhjen, arsimimin, prejardhjen sociale, shtetësinë, vendin ose llojin e qëndrimit ose çfarë do karakteristika tjera personale.

Zbatimi i Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative

Neni 6

(1) Procedurat e parapara me këtë ligj do të udhëhiqen në pajtim me dispozitat nga Ligji për procedurë të përgjithshme administrative, nëse me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe.

(2) Komunikimi në lidhje me procedurat nga paragrafi (1) i këtij neni, ndërmjet Agjencisë dhe palëve zhvillohet në formë të shkruar, me gojë ose në formë elektronike, në pajtim me këtë ligj dhe Ligjin për procedurë të përgjithshme administrative.

Dërgimi i të dhënave

Neni 7

(1) Secili organ i administratës shtetërore, institucion publik, ent dhe person tjetër juridik që mban regjistra zyrtarë, përmbledhje të arritshme për publikun ose përmbledhje tjera të të dhënave është i obliguar pa kompensim me kërkesë të Agjencisë, t'i dërgojë të dhënat nga regjistrat dhe përmbledhjet e të dhënave për nevojat e procedurave që zbatohen në pajtim me këtë ligj.

(2) Komunikimi ndërmjet Agjencisë dhe organeve të pushtetit shtetëror, institucioneve publike, enteve dhe personave tjerë juridik nga paragrafi (1) i këtij neni zhvillohet në formë të shkruar, me gojë ose në formë elektronike në pajtim me ligj.

Dhënie e ndihmës

Neni 8

(1) Agjencia mund të kërkojë dhe t'i jepet ndihmë nga organi i administratës shtetërore, kompetent për kryerje të punëve nga fusha e punëve të brendshme gjatë zbatimit të aktvendimit që është ekzekutiv në pajtim me Ligjin për procedurë të përgjithshme administrative dhe me këtë ligj, nëse has në rezistencë fizike ose rezistencë e tillë mund të pritët me arsye, si dhe në raste tjera të përcaktuara me ligj.

(2) Në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga fusha e punëve të brendshme është i obliguar të jep ndihmë në pajtim me ligj.

II. PARIME

Parime në lidhje me përpunimin e të dhënave personale

Neni 9

(1) Të dhënat personale:

- përpunohen në pajtim me ligj, në masë të mjaftueshme dhe në mënyrë transparente në lidhje me subjektin e të dhënave personale ("ligjshmëri, drejtësi dhe transparencë"),

- grumbullohen për qëllime konkrete, të qarta dhe legjitime dhe nuk do të përpunohen në mënyrë që nuk është në pajtim me ato qëllime. Përpunimi i mëtejshëm për qëllime të arkivimit me interes publik, për hulumtime shkencore ose historike ose për qëllime statistikore, në pajtim me nenin 86 paragrafi (1) i këtij ligji, nuk do të konsiderohet që nuk është në pajtim me qëllimet fillestare për të cilat janë grumbulluar të dhënat personale ("kufizim i qëllimeve"),

- përkatëse, relevante dhe të kufizuara me atë që është e domosdoshme në lidhje me qëllimet për të cilat përpunohen ("vëllim minimal i të dhënave"),

- të sakta dhe ku është e nevojshme të azhurnuara, me ç'rast do të ndërmerren të gjitha masat përkatëse për shlyerje me kohë ose korigjim i të dhënave që janë të pasakta ose nuk janë të plota, duke i pasur parasysh qëllimet për të cilat janë përpunuar ("saktësi"),

- të ruajtura në formë që mundëson identifikimin e subjekteve të të dhënave personale, jo më gjatë se ajo që është e nevojshme për qëllimet për të cilat përpunohen të dhënat personale. Të dhënat personale mund të ruhen më gjatë se afati i ruajtjes së tyre nëse përpunohen vetëm për qëllimet e arkivimit me interes publik, për hulumtime shkencore ose historike ose për qëllime statistikore në pajtim me nenin 86 paragrafi (1) i këtij ligji, kurse me aplikim të teknikave dhe masave përkatëse organizative në pajtim me këtë ligj, për shkak të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të subjektit të të dhënave personale ("kufizim i afatit të ruajtjes"),

- të përpunuara në mënyrë që siguron nivel përkatëse të sigurisë së të dhënave personale, duke përfshirë mbrojtje nga përpunimi i paautorizuar ose i paligjshëm, si dhe humbja, shkatërrimi ose dëmtimi i tyre i rastësishëm, me aplikim të masave përkatëse teknike ose organizative ("integritet dhe besueshmëri").

(2) Kontrollori është përgjegjës për harmonizimin me paragrafin (1) të këtij neni, me ç'rast është i obliguar ta demonstrojë harmonizimin (llogaridhënie).

Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale

Neni 10

(1) Përpunimi i të dhënave personale është ligjshmëria, vetëm nëse dhe deri në atë shkallë nëse është plotësuar së paku njëri nga këto kushte:

- subjekti i të dhënave personale ka dhënë pajtim për përpunim të të dhënave të tij personale për një ose më tepër qëllime konkrete,

- përpunimi është i nevojshëm për plotësim të marrëveshjes ku subjekti i të dhënave personale është pala kontraktuese, ose për t'u ndërmarrë aktivitete me kërkesë të subjektit të të dhënave personale para inkuadrimin të tij në marrëveshjen,

- përpunimi është i nevojshëm për plotësim të obligimit ligjor të kontrollorit,

- përpunimi nevojitet për mbrojtje të interesave thelbësore të subjektit të të dhënave personale ose të personit tjetër fizik,

- përpunimi nevojitet për kryerje të punëve të interesit publik ose gjatë kryerjes së autorizimit publik të kontrollorit të përcaktuar me ligj,

- përpunimi nevojitet për qëllimet e interesave legjitim të kontrollorit ose të personit të tretë, përveç kur interesat e tilla nuk dominojnë mbi interesat apo të drejtat dhe liritë e subjektit të të dhënave personale të cilët kërkojnë mbrojtje të të dhënave personale, veçanërisht kur subjekti i të dhënave personale është fëmijë.

(2) Dispozitat nga paragrafi (1) alineja 6 i këtij neni nuk do të vlejë për përpunimin e të dhënave personale nga ana e organeve të pushtetit shtetëror gjatë zbatimit të kompetencave të tyre.

(3) Baza juridike për përpunimin e të dhënave personale është përmendura në paragrafin (1) alinetë 3 dhe 5 të këtij neni përcaktohet me ligj. Në ligjin detyrimisht parahihen dispozita për: kushtet të cilat e përcaktojnë ligjshmërinë e përpunimit nga ana e kontrollorit, qëllimet e përpunimit, kategoritë e të dhënave personale të cilat janë lëndë e përpunimit, kategoritë e subjekteve të të dhënave personale; subjekte të cilëve mund t'u zbulohen të dhëna personale si dhe qëllime për të cilat zbulohen të dhënat personale, kufizimet në lidhje me qëllimet e përpunimit, periudha e ruajtjes, operacionet dhe procedurat për përpunim, duke përfshirë edhe masa për sigurim të përpunimit ligjor dhe të drejtë, kurse me qëllim të plotësohet qëllimi i interesit publik dhe të jetë proporcionale me realizimin e qëllimit legjitim. Ligji doemos duhet të përmbajë edhe vlerësim të ndikimit të mbrojtjes së të dhënave personale për rastet e parapara në nenin 39 të këtij ligji.

(4) Nëse të dhënat personale përpunohen për qëllim tjetër ndryshe nga qëllimi për të cilin fillimisht janë grumbulluar, me ç'rast përpunimi nuk bëhet në bazë të pëlqimit të subjektit të të dhënave personale ose në bazë të ligjit, që është masë e domosdoshme dhe proporcionale për mbrojtjen e qëllimeve të përcaktuara në nenin 27 paragrafi (1) i këtij ligji atëherë kontrollori për të përcaktuar nëse përpunimi për qëllime tjera është në pajtim me qëllimin fillestar për të cilin janë grumbulluar të dhënat personale, është i obliguar mes tjerash t'i marrë parasysh:

- çdo lidhshmëri ndërmjet qëllimeve për shkak të të cilat grumbullohen të dhënat personale dhe qëllimet për përpunimin e paraparë të mëtejme,

- kontekstin në të cilin janë grumbulluar të dhënat personale, veçanërisht në aspekt të raporteve ndërmjet subjekteve të të dhënave personale dhe kontrollorit,

- natyrën e të dhënave personale, ndërsa veçanërisht nëse përpunohen kategori të veçanta të të dhënave personale në pajtim me nenin 13 të këtij ligji ose përpunohen të dhëna personale të cilat kanë të bëjnë me aktgjykime penale dhe vepra penale në pajtim me nenin 14 të këtij ligji,

- pasojat e mundshme nga përpunimi i paraparë i mëtejme për subjektet e të dhënave personale,

- ekzistimi i masave përkatëse mbrojtëse të cilat mund të kyçen në kriptom ose pseudonimizim.

Kushtet për pëlqim

Neni 11

(1) Kur përpunimi bëhet në bazë të pëlqimit, kontrollori është i obliguar të demonstrojë që subjekti i të dhënave personale ka dhënë pajtim për përpunimin e të dhënave të tij personale në kuptim të nenit 4 paragrafi (1) pika 11 e këtij ligji.

(2) Nëse pëlqimi i subjektit të të dhënave personale është dhënë në formë të deklaratës së shkruar që ka të bëjë edhe me çështje tjera, kërkesa për pëlqim doemos duhet të prezantohet në mënyrë që qartë mund të dallojë nga çështjet tjera, në formë të kuptueshme dhe lehtë të arritshme, duke përdorur mjete të qarta dhe të thjeshta. Secila pjesë e deklaratës së tillë që paraqet shkelje të dispozitave të këtij ligji, nuk është obligative.

(3) Subjekti i të dhënave personale ka të drejtë të tërheq pëlqimin në çdo kohë. Tërheqja e pëlqimit nuk ndikon mbi ligjshmërinë e përpunimit, të bazuar në pajtim që është dhënë para tërheqjes së tij. Para se të japë pëlqim, subjekti i të dhënave personale informohet për atë, kurse tërheqja e pëlqimit duhet të jetë po aq e thjeshtë, sikur edhe dhënia e vet.

(4) Kur vlerësohet nëse pëlqimi është dhënë në mënyrë vullnetare, në masën më të madhe të mundshme merret parasysh, ndër të tjerat, nëse zbatimi i marrëveshjes në të cilën është përfshirë ndonjë shërbim i caktuar është kushtëzuar nga dhënia e pëlqimit për përpunimin e të dhënave personale, kurse i cili nuk nevojitet për plotësim të marrëveshjes.

Kushte të cilat zbatohen për pëlqim të fëmijës në lidhje me shërbimet e shoqërisë informatike

Neni 12

(1) Në rast kur subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqim për përpunimin e të dhënave personale për një ose më tepër qëllime konkrete, në lidhje me ofrimin e drejtpërdrejtë të shërbimeve të shoqërisë informatike të fëmijëve, përpunimi i të dhënave personale të fëmijës është ligjor, nëse fëmija ka së paku 14 vjet. Nëse fëmija është në moshë nën 14 vite, përpunimi i tillë është ligjor vetëm nëse dhe kur pëlqimi i tillë është dhënë ose është lejuar nga përfaqësuesi ligjor i fëmijës.

(2) Në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni, kontrollori është i obliguar të bën përpjekje racionale për verifikim të pëlqimit që është dhënë nga përfaqësuesi ligjor i fëmijës, duke e pasur parasysh teknologjinë në dispozicion.

Përpunimi i kategorive të veçanta të të dhënave personale

Neni 13

(1) Është i ndaluar përpunimi i kategorive të veçanta të të dhënave personale të përcaktuara në nenin 4 paragrafi (1) pika 13 e këtij ligji.

(2) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, përpunimi i kategorive të veçanta të të dhënave personale mund të bëhet, nëse:

1) subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqim eksplicit për përpunimin e atyre të dhënave për një ose më tepër qëllime konkrete, përveç kur me ligj është paraparë që ndalesa nga paragrafi (1) i këtij neni për përpunim të të dhënave të tilla nuk mund të revokohet nga subjekti i të dhënave personale;

2) përpunimi është i domosdoshëm për qëllimet e zbatimit të obligimeve dhe realizimin e të drejtave të veçanta të kontrollorit ose të subjektit të të dhënave personale në fushën e punësimit dhe sigurisë sociale dhe në dispozitat për mbrojtje sociale, nëse kjo është e lejuar me ligj ose marrëveshje kolektive, në të cilën parashihen masa përkatëse për mbrojtjen e të drejtave fundamentale dhe interesat e subjektit të të dhënave personale;

3) përpunimi është i domosdoshëm për mbrojtjen e interesave thelbësore të subjektit të të dhënave personale ose të personit tjetër fizik, kur subjekti i të dhënave personale fizik ose juridik nuk është në gjendje të japë pëlqimin e vet;

4) përpunimi bëhet në suaza të aktiviteteve legjitime me masa përkatëse mbrojtëse nga fondacioni përkatës, shoqatë ose ndonjë organizatë tjetër joprofitabile me qëllim politik, filozofik, religjioz ose sindikal dhe me kusht përpunimi të vlejë vetëm për anëtarët e atyre organizatave ose të ish-anëtarëve të tyre ose të personave të cilët kanë kontakte të rregullta me ata në lidhje me qëllimet e tyre dhe me kusht të dhënat personale të mos zbulohen jashtë asaj organizate pa pëlqim të subjekteve të të dhënave personale;

5) përpunimi ka të bëjë me të dhëna personale të cilat dukshëm janë shpallur në mënyrë publike nga subjekti i të dhënave personale;

6) përpunimi është i domosdoshëm për vendosje, praktikim ose mbrojtje të kërkesave juridike ose gjithmonë kur gjykatat veprojnë në suaza të kompetencave të tyre;

7) përpunimi është i domosdoshëm për shkaqe të interesit publik në bazë të ligjit në mënyrë proporcionale me qëllimin dhe respektim të thelbit të së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe sigurim të masave përkatëse dhe konkrete për mbrojtjen e të drejtave fundamentale dhe interesat e subjektit të të dhënave personale;

8) përpunimi është i domosdoshëm për qëllimet e mjekësisë parandaluese ose të punës, për vlerësim të aftësisë për punë të të punësuarit, diagnozë mjekësore, sigurim të kujdesit ose trajtimit mjekësor apo social ose për qëllimet e menaxhimit me shërbimet dhe sistemet për mbrojtje shëndetësore apo sociale, në bazë të ligjit ose në pajtim me marrëveshjen me punëtorin shëndetësor në cilën lëndë janë kushtet dhe masat mbrojtëse të përmendura në paragrafin (3) të këtij neni;

9) përpunimi është i domosdoshëm për qëllimet e interesit publik në fushën e shëndetësisë publike, siç janë mbrojtje kundër rreziqeve serioze tejkufitare për shëndetin ose sigurim të standardeve të larta për cilësi dhe siguri të mbrojtjes shëndetësore dhe barnat ose ndihmesat mjekësore, në bazë të ligjit, në të cilin janë paraparë masa përkatëse dhe konkrete për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të subjektit të të dhënave personale, veçanërisht mbrojtje të fshehtësisë afariste;

10) përpunimi është i domosdoshëm për qëllimet e arkivimit në interes publik, për qëllimet e hulumtimeve shkencore dhe historike ose qëllime statistikore në pajtim me nenin 86 paragrafi (1) i këtij ligji, në bazë të ligjit, që është proporcionale me qëllimin në pajtim me respektimin e thelbit të së drejtës së mbrojtjes së të dhënave personale dhe sigurim të masave përkatëse dhe konkrete për mbrojtjen e të drejtave themelore dhe interesave të subjektit të të dhënave personale.

(3) Të dhënat personale të përmendura në paragrafin (1) të këtij neni, mund të përpunohen për qëllimet e përmendura në paragrafin (2) pikën 8) të këtij neni, kur këto të dhëna përpunohen nga ana e, ose nën përgjegjësi të personit profesional që i nënshtrohet obligimit për ruajtje të fshehtësisë afariste në pajtim me ligj ose me rregullat tjera të përcaktuara nga trupat kompetentë në Republikën e Maqedonisë së Veriut ose nga person tjetër i cili gjithashtu i nënshtrohet obligimit për ruajtje të fshehtësisë afariste në pajtim me ligj ose rregullat e përcaktuara nga trupat kompetent në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Përpunimi i të dhënave personale lidhur me dënimet për vepra penale

Neni 14

Përpunimi i të dhënave personale në lidhje me dënimet për vepra penale ose që lidhen me masat mbrojtëse bazuar në nenin 10 paragrafi (1) të këtij ligji, kryhet vetëm nën kontrollin e organit kompetent të pushtetit shtetëror ose kur përpunimi lejohet me ligj në të cilin përcaktohen

masat adekuate për mbrojtje në përputhje me të drejtat dhe liritë e subjekteve të të dhënave personale. Çdo regjistër gjithpërfshirës i dënimeve për vepra penale mbahet nën kontroll të organit kompetent të pushtetit qendror, në pajtim me ligjin.

Përpunim për të cilin nuk kërkohet identifikim

Neni 15

(1) Nëse qëllimet për të cilat kontrollori përpunon të dhënat personale nuk kërkojnë ose ka pushuar nevoja për identifikim të mëtutjeshëm të subjektit të të dhënave personale nga kontrollori, kontrollori nuk është i detyruar të ruajë, të marrë ose përpunojë informata shtesë identifikuese të subjektit të të dhënave personale vetëm për shkak të harmonizimit me këtë ligj.

(2) Në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni, kur kontrollori nuk është në gjendje të identifikojë subjektin e të dhënave personale, e informon në mënyrë adekuate subjektin, nëse është e mundur. Në raste të tilla, nenet 19 deri 24 të këtij ligji nuk zbatohen, përveç nëse subjekti i të dhënave personale, për të ushtruar të drejtat e tij nga këto nene, siguron informata shtesë, duke bërë të mundur identifikimin e tij.

III. TË DREJTAT E SUBJEKTIT TË TË DHËNAVE PERSONALE

1. Transparenca

Informatat transparente, komunikimi dhe mënyra e realizimit të të drejtave të subjektit të të dhënave personale

Neni 16

(1) Kontrollori është i detyruar të marrë masat e duhura për të siguruar të gjitha informatat e përmendura në nenet 17 dhe 18 të këtij ligji dhe në çdo komunikim të bazuar në nenet 19 deri 26, si dhe nenin 38 të këtij ligji, në lidhje me përpunimin që ka të bëjë me subjektin e të dhënave personale në mënyrë koncize, transparente, të kuptueshme dhe në një formë lehtësisht të arritshme, duke përdorur një gjuhë të thjeshtë e të qartë, veçanërisht për informatat të cilat janë dedikuar posaçërisht për fëmijë. Informatat duhet të jepen me shkrim ose me mjete tjera, duke përfshirë se ku është e zbatueshme në mënyrë elektronike. Me kërkesë të subjektit të të dhënave personale, informatat mund të jepet me gojë, me kusht që identiteti i subjektit të të dhënave personale të dëshmohet me mjete të tjera.

(2) Kontrollori ka për detyrë ta lehtësojë realizimin e të drejtave të subjektit të të dhënave personale në bazë të neneve 19 deri në 26 të këtij ligji. Në rastet që kanë të bëjnë me nenin 15 paragrafi (2) të këtij ligji, kontrollori nuk do të refuzojë të veprojë sipas kërkesës së subjektit të të dhënave personale për realizimin e të drejtave të tij në bazë të neneve prej 19 deri në 26 të këtij ligji, përveç nëse kontrollori dëshmon se nuk është në gjendje ta identifikojë subjektin e të dhënave personale.

(3) Kontrollori për kërkesën e subjektit të të dhënave personale ka për detyrë të dorëzojë informatë mbi aktivitetet e ndërmarra në bazë të neneve prej 19 deri në 26 të këtij ligji deri te subjekti i të dhënave personale pa anulimin e panevojshëm dhe në çdo rast, në periudhë prej një muaji nga dita e pranimit të kërkesës. Nëse është e nevojshme, ky afat mund të vazhdohet edhe për dy muaj duke i marrë parasysh ndërlikueshmërinë dhe numrin e kërkesave. Kontrollori e informon subjektin e të dhënave personale për çdo vazhdim në afat prej një muaji nga dita e pranimit të kërkesës, së bashku me arsyen e anulimit. Kur subjekti i të dhënave personale parashtron kërkesë në formë elektronike, informatat jepen me shfrytëzimin e mjeteve elektronike kur është e mundur, përveç nëse subjekti i të dhënave personale kërkon ndryshe.

(4) Nëse kontrollori nuk ndërmerr aktivitete sipas kërkesës së subjektit të të dhënave personale, kontrollori e informon subjektin e të dhënave personale pa anulim dhe më së voni në afat prej një muaji nga dita e pranimit të kërkesës, për arsyet e aktiviteteve të ndërmarra dhe për mundësinë e parashtrimit të kërkesës në Agjenci, si dhe për mundësinë e shfrytëzimit të mbrojtjes gjyqësore në pajtim me ligjin.

(5) Informata e siguruar në bazë të neneve 17 dhe 18 të këtij ligji dhe çdo komunikim dhe të gjitha aktivitetet e ndërmarra në bazë të neneve prej 19 deri në 26, si dhe neni 38 të këtij ligji mundësohen pa kompensim. Në rast kur kërkesat e subjektit të të dhënave personale janë dukshëm të pabazuara ose të tepërta, veçanërisht në lidhje me karakterin e tyre përsëritës, kontrollori mund:

- të arkëtojë kompensim duke i marrë parasysh vëllimin, ndërlikueshmërinë dhe kohën e nevojshme për të siguruar informatën ose komunikimin ose për të vepruar sipas kërkesës ose
- refuzon të veprojë sipas kërkesës.

Të dëshmuarit e pabazueshmërisë ose karakterit të tepërt të kërkesës është në ngarkim të kontrollorit.

(6) Me përjashtim nga neni 15 i këtij ligji, ku kontrollori ka dyshime të arsyeshme në lidhje me identitetin e personit fizik që e parashtron kërkesën sipas neneve prej 19 deri në 25 të këtij ligji, kontrollori mund të kërkojë dorëzimin e informatave shtesë, të nevojshme për të përcaktuar identitetin e subjektit të të dhënave personale.

(7) Informata që dorëzohet te subjektet e të dhënave personale, në pajtim me nenet 17 dhe 18 të këtij ligji, mund të sigurohet në kombinim me ikonat e standardizuara, me qëllim që t'u sigurohet një mënyrë lehtësisht e dukshme, e kuptueshme dhe qartë e lexueshme për të siguruar një pasqyrë të qartë të qëllimit të përpunimit. Nëse ikonat e standardizuara paraqiten në formë elektronike, ato duhet të jenë të lexueshme në mënyrë makinerike.

(8) Mënyra e përcaktimit të informatave që do të paraqitet në formën e ikonave të standardizuara, si dhe procedurat për sigurimin e ikonave të standardizuara i përcakton drejtori i Agjencisë.

2. Informata dhe qasje te të dhënat personale

Informata të cilat dorëzohen gjatë grumbullimit të të dhënave personale nga subjekti i të dhënave personale

Neni 17

(1) Kur të dhënat personale grumbullohen nga subjekti i të dhënave personale, kontrollori në momentin e grumbullimit të të dhënave personale, subjektit të të dhënave personale ia siguron këto informata:

1) identiteti dhe kontakt të dhënat e kontrollorit dhe të dhënat për përfaqësuesin e tij të autorizuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut;

2) kontakt të dhëna për oficerin për mbrojtje të të dhënave personale;

3) qëllimet e përpunimit për të cilat të dhënat personale janë dedikuar, si dhe baza juridike për përpunim;

4) interesat legjitime që i zbaton kontrollori ose personi i tretë, kur përpunimi kryhet në bazë të nenit 10 paragrafi (1) alineja 6 të këtij ligji;

5) shfrytëzuesit ose kategoritë e shfrytëzuesve të të dhënave personale, nëse i ka;

6) ku është e zbatueshme, fakti se kontrollori ka qëllim të bart të dhëna personale në vendin e tretë ose organizata ndërkombëtare, si dhe në rast të bartjes së të dhënave personale, në pajtim me nenin 50 ose nenin 51 ose nenin 53 paragrafi (1) nënparagrafi i dytë i këtij ligji, thirrje të masave mbrojtëse të pranueshme ose përkatëse dhe mënyra për marrje të kopjes nga ato ose informacione ku të njëjtat janë të kapshme.

(2) Përveç informatave të paragrafit (1) të këtij neni, kontrollori në momentin e grumbullimit të të dhënave personale, subjektit të të dhënave personale ia siguron këto informata plotësuese që janë të domosdoshme për sigurimin e përpunimit të drejtë dhe transparent:

1) periudha kohore për të cilën do të ruhen të dhënat personale, kurse nëse ajo është e pamundshme, kriteret që shfrytëzohen për përcaktimin e asaj periudhe;

2) ekzistimi i së drejtës të kërkohet nga kontrollori qasje, korigjim ose shlyerje e të dhënave personale ose kufizim i përpunimit të të dhënave personale që kanë të bëjnë me subjektin e të dhënave personale, ose e drejta e kundërshtimit për përpunim, si dhe e drejta e bartjes së të dhënave;

3) ekzistimi i së drejtës për tërheqjen e pëlqimit në çdo kohë, pa mos ndikuar në ligjshmërinë e përpunimit e cila ishte bazuar në pëlqimin para se të tërhiqet i njëjti, kur përpunimi kryhet në bazë të nenit 10 paragrafi (1) pika 1 të këtij ligji ose në bazë të nenit 13 paragrafi (2) pika 1) të këtij ligji;

4) e drejta e parashtrimit të kërkesës për Agjencinë në pajtim me këtë ligj;

5) informatë nëse dhënia e të dhënave personale është ligjore ose detyrim kontraktues ose kusht që është i nevojshëm për lidhje të marrëveshje, si dhe nëse subjekti i të dhënave personale ka detyrim t'i japë të dhënat personale dhe pasojat e mundshme nëse këto të dhëna nuk jepen;

6) ekzistimi i procesit të automatizuar i vendosjes, duke përfshirë edhe profilimin siç është theksuar në nenin 26 paragrafët (1) dhe (4) të këtij ligji dhe së paku në ato raste, kur është përfshirë informatë e rëndësishme për proceset logjike të lidhura të përpunimit, si dhe rëndësia dhe pasojat e parapara nga përpunimi i tillë për subjektin e të dhënave personale.

(3) Kur kontrollori ka për qëllim edhe më tej të përpunojë të dhëna personale për qëllim ndryshëm nga ai për të cilin janë grumbulluar të dhënat personale, kontrollori para përpunimit të mëtejshëm, subjektit të të dhënave personale i siguron informacione për qëllimin tjetër dhe të gjitha informacionet tjera të nevojshme, siç është theksuar në paragrafin (2) të këtij neni.

(4) Paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni nuk zbatohen vetëm nëse dhe deri në atë shkallë kur subjekti i të dhënave personale tashmë disponon me informatat.

Informata të cilat dorëzohen kur të dhënat personale nuk janë marrë nga subjekti i të dhënave personale

Neni 18

(1) Kur të dhënat personale nuk janë marrë nga subjekti i të dhënave personale, kontrollori subjektit i të dhënave personale ia siguron këto informata:

1) identitetin dhe kontakt të dhënat të kontrollorit dhe të dhënat për përfaqësuesin e tij të autorizuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut;

2) kontakt të dhënat për oficerin për mbrojtje të të dhënave personale;

3) qëllimet e përpunimit për të cilat të dhënat personale janë dedikuar, si dhe baza juridike për përpunim;

4) kategoritë e të dhënave personale të cilat përpunohen;

5) shfrytëzuesit ose kategoritë e shfrytëzuesve të të dhënave personale, nëse i ka;

6) kur është e zbatueshme, qëllimin e kontrollorit që të bartë të dhëna personale në vendin e tretë ose organizata ndërkombëtare, si dhe në rast të bartjes së të dhënave personale, në pajtim me nenin 50 ose nenin 51 ose nenin 53 paragrafi (1) nënparagrafi i dytë i këtij ligji, thirrje e masave mbrojtëse të pranueshme ose përkatëse dhe mënyra për marrje të kopjes nga ato ose informata ku të njëjtat janë të kapshme.

(2) Përveç informatave të paragrafit (1) të këtij neni, kontrollori i subjektit i të dhënave personale, ia jep këto informata plotësuese që janë të domosdoshme për sigurimin e përpunimit të drejtë dhe transparentë të të dhënave të tij personale edhe atë:

1) periudha kohore për të cilën do të ruhen të dhënat personale, e nëse kjo është e pamundshme, kriteret që shfrytëzohen për përcaktimin e asaj periudhe;

2) interesat legjitime që i zbaton kontrollori ose personi i tretë, kur përpunimi kryhet në bazë të nenit 10 paragrafi (1) alineja 6 të këtij ligji;

3) ekzistimi i të drejtës të kërkohet nga kontrollori qasje, korrigjim ose shlyerje e të dhënave personale ose kufizim i përpunimit të të dhënave personale që kanë të bëjnë me subjektin e të dhënave personale, ose e drejta e kundërshtimit për përpunim, si dhe e drejta e bartjes së të dhënave;

4) ekzistimi i të drejtës për tërheqjen e pëlqimit në çdo kohë, pa mos ndikuar në ligjshmërinë e përpunimit e cila ishte bazuar në pëlqimin para se të tërhiqet e njëjta, kur përpunimi kryhet në bazë të nenit 10 paragrafi (1) pika 1 të këtij ligji ose në bazë të nenit 13 paragrafi (2) pika 1) të këtij ligji;

5) e drejta e parashtrimit të kërkesës për Agjencinë në pajtim me këtë ligj;

6) burimi i të dhënave personale dhe nëse është i zbatueshëm, nëse të dhënat janë nga burime publikisht të kapshme;

7) ekzistimi i procesit të automatizuar të vendosjes, duke përfshirë edhe profilimin siç është theksuar në nenin 26 paragrafët (1) dhe (4) të këtij ligji dhe së paku në ato raste, kur është përfshirë informatë e rëndësishme për logjikën e përpunimit, si dhe rëndësinë dhe pasojat e parapara nga përpunimi i tillë për subjektin e të dhënave personale.

(3) Kontrollori i siguron informatat të theksuara në paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni:

1) në afat të arsyeshëm pas marrjes së të dhënave personale, por më së voni në afat prej një muaji, duke pasur parasysh rrethanat e posaçme nën të cilat të dhënat personale përpunohen;

2) nëse të dhënat personale shfrytëzohen për komunikim me subjektin e të dhënave personale, më së voni gjatë realizimit të kontaktit të parë me subjektin e të dhënave personale; ose

3) nëse është paraparë zbulim i pranuesit tjetër, më së voni deri në momentin kur të dhënat personale janë zbuluar për herë të parë.

(4) Kur kontrollori ka për qëllim edhe më tej të përpunojë të dhëna personale për qëllim të ndryshëm nga ai për të cilin janë grumbulluar të dhënat personale, kontrollori para përpunimit të mëtejshëm, subjektit të të dhënave personale i siguron informacione për qëllimin tjetër dhe të gjitha informacionet tjera të nevojshme, siç është theksuar në paragrafin (2) të këtij neni.

(5) Paragrafët (1) deri në (4) të këtij neni nuk zbatohen nëse edhe deri në atë shkallë kur:

1) subjekti i të dhënave personale tashmë disponon me informatat;

2) sigurimi i informatave të tilla është i pamundur ose kërkon përpjekje të mëdha joproportionale, veçanërisht për përpunimin e të dhënave për qëllime të arkivimit me interes publik, për hulumtime shkencore ose historike ose për qëllime statistikore, që janë lëndë e kushteve dhe masave mbrojtëse, në pajtim me nenin 86 paragrafi (1) i këtij ligji, ose nëse ekziston mundësia se detyrimi i theksuar në paragrafin (1) të këtij neni, do ta bëjë të pamundur ose seriozisht do të pengojë arritjen e qëllimeve të atij përpunimi. Në këto raste, kontrollori merr masa përkatëse për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave legjitime të subjektit të të dhënave personale, duke përfshirë edhe sigurimin e qasjes publike të informatat;

3) marrja ose zbulimi është qartë i lejueshëm me ligj në të cilin parashihen masat përkatëse për mbrojtje të interesave legjitime të subjektit të të dhënave personale ose

4) të dhënat personale doemos duhet të mbesin të besueshme në pajtim me detyrimin për sekret afarist, që rregullohet me ligj, duke përfshirë edhe detyrimin ligjor për besueshmëri.

E drejta për qasje të subjektit të të dhënave personale

Neni 19

(1) Subjekti i të dhënave personale ka të drejtë të marrë vërtetim nga kontrollori nëse përpunohen të dhënat personale të tij ose të dhënat personale për atë dhe nëse përpunohen, të ketë qasje në të dhënat personale dhe në informatat si vijojnë:

- 1) qëllimet e përpunimit;
- 2) kategoritë e të dhënave personale të cilat përpunohen;
- 3) shfrytëzuesit ose kategoritë e shfrytëzuesve të cilëve u janë zbuluar ose do të zbulohen të dhënat personale, posaçërisht shfrytëzuesve në vende të treta ose organizata ndërkombëtare;
- 4) periudhën e paraparë për të cilën do të ruhen të dhënat personale, ndërsa nëse kjo nuk është e mundur, kriteret e përdorura për ta përcaktuar atë periudhë;
- 5) ekzistimin e të drejtës që të kërkohej nga kontrollori korigjim ose shlyerje e të dhënave personale ose kufizim i përpunimit të të dhënave personale në lidhje me subjektin e të dhënave personale, ose të drejtën për t'u ankuar kundër përpunimit të tillë;
- 6) të drejtën e parashtrimit të kërkesës në Agjenci në pajtim me nenin 97 të këtij ligji;
- 7) kur të dhënat personale nuk janë mbledhur nga subjekti i të dhënave personale, të gjitha informacionet e kapshme për burimin e tyre;
- 8) ekzistimin e procesit të automatizuar të vendimmarrjes, duke përfshirë profilimin e përmendur në nenin 26 paragrafët (1) dhe (4) të këtij ligji dhe së paku në ato raste, kur përfshihet informacion i rëndësishëm për logjikën e përpunimit, si dhe rëndësinë dhe pasojat e parashikuara të përpunimit të tillë për subjektin e të dhënave personale.

(2) Kur të dhënat personale barten në vend të tretë ose organizatë ndërkombëtare, subjekti i të dhënave personale ka të drejtë të informohet për masat mbrojtëse përkatëse që lidhen me bartjen në pajtim me nenin 50 të këtij ligji.

(3) Kontrollori është i detyruar të sigurojë kopje nga të dhënat personale që përpunohen. Për të gjitha kopjet plotësuese të kërkuara nga subjekti i të dhënave personale, kontrollori miraton vendim nëse do të paguajë kompensim. Nëse kontrollori arkëton kompensim, lartësia e të njëjtit varet nga vëllimi, ndërlikueshmëria dhe koha e nevojshme për sigurimin e kopjeve. Nëse subjekti i të dhënave personale parashtron kërkesë në mënyrë elektronike, subjektit të të dhënave personale do t'i sigurohen informacione në mënyrën e zakonshme që shfrytëzohet në rast të formës elektronike, përveç nëse subjekti i të dhënave personale nuk ka kërkuar ndryshe.

(4) E drejta për të marrë kopje nga paragrafi (3) i këtij neni, nuk guxon të ndikojë negativisht mbi të drejtat dhe liritë e personave të tjerë fizikë.

3. Korigjimi dhe shlyerja

E drejta për korigjim

Neni 20

Subjekti i të dhënave personale ka të drejtë të kërkojë dhe të marrë nga kontrollori në afat prej 15 ditëve nga dita e parashtrimit të kërkesës, korigjimin e të dhënave personale të tij të pasakta. Duke marrë parasysh qëllimet e përpunimit, subjekti i të dhënave personale ka të drejtë t'i plotësojë të dhënat personale jo të plota, me dhënien e deklaratës shtesë.

E drejta për shlyerje (“e drejta që të harrohet”)

Neni 21

(1) Subjekti i të dhënave personale ka të drejtë të kërkojë nga kontrollori t'i shlyejë të dhënat personale të tij me ç'rast kontrollori ka për obligim t'i shlyejë të dhënat personale në afat prej 30 ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës për shlyerje, nëse është plotësuar një nga kushtet si vijojnë:

1) të dhënat personale nuk janë të nevojshme për qëllimet për të cilat janë grumbulluar ose përpunuar në mënyrë tjetër;

2) subjekti i të dhënave personale e tërheq pëlqimin e vet mbi të cilin bazohet përpunimi i të dhënave në pajtim me nenin 10 paragrafi (1) pika 1) dhe 13 paragrafi (2) të këtij ligji dhe nëse nuk ekziston bazë tjetër ligjore për përpunim;

3) subjekti i të dhënave personale paraqet kundërshtim të përpunimit në pajtim me nenin 25 paragrafi (1) të këtij ligji, me ç'rast nuk ekzistojnë qëllime dominuese legjitime, ose subjekti i të dhënave personale ka paraqitur kundërshtim të përpunimit, në pajtim me nenin 25 paragrafi (2) të këtij ligji;

4) të dhënat personale kanë qenë të përpunuara në mënyrë të paligjshme;

5) të dhënat personale duhet të shlyhen me qëllim të respektimit të obligimit të përcaktuar me ligjin i cili ka të bëjë me kontrollorin;

6) të dhënat personale janë grumbulluar në lidhje me ofertën e shërbimeve të shoqërisë informatike, në pajtim me nenin 12 paragrafi (1) të këtij ligji.

(2) Kur kontrollori i ka shpallur publikisht të dhënat personale dhe është i detyruar në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni t'i shlyejë të dhënat personale, atëherë kontrollori ndërmerr veprime, duke përfshirë masa teknike që t'i njoftojë kontrollorët tjerë të cilët i përpunojnë të dhënat personale se subjekti i të dhënave personale ka kërkuar shlyerjen e të gjitha linqeve ose kopjeve ose reproduksioneve të të dhënave personale nga ata kontrollorë, duke i marrë parasysh teknologjinë e arritshme dhe shpenzimet e zbatimit.

(3) Paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni nuk zbatohen deri në atë shkallë deri në të cilën përpunimi është i domosdoshëm:

a) për realizimin e të drejtës së lirisë së shprehjes dhe informimit;

b) për harmonizim me detyrim ligjor e cila kërkon përpunim sipas ligjit i cili zbatohet në lidhje me kontrollorin, ose për realizim të punëve nga interesi publik ose gjatë kryerjes së autorizimit publik të përcaktuar me ligj e ndarë kontrollorit

c) për shkaqe të interesit publik në sferën e shëndetit publik në pajtim me nenin 13 paragrafi (2) pikat 8) dhe 9) dhe paragrafi (3) të këtij ligji;

ç) për qëllimet e arkivimit nga interesi publik, për qëllime të hulumtimit shkencor ose historik ose për qëllime statistikore, në pajtim me nenin 86 paragrafi (1) të këtij ligji, nëse ekziston mundësi e drejta e përcaktuar në paragrafin (1) të këtij neni të bëhet e pamundshme ose seriozisht ta vështirësojë arritjen e qëllimeve të atij përpunimi ose

d) për vendosje, realizim ose mbrojtje të kërkesave të bazuara në ligj.

E drejta e kufizimit të përpunimit

Neni 22

(1) Subjekti i të dhënave personale ka të drejtë të kërkojë kufizim të përpunimit nga kontrollori, nëse është plotësuar njëri nga kushtet në vijim:

a) saktësia e të dhënave personale kontestohet nga subjekti i të dhënave personale, për periudhë e cila i mundëson kontrollorit ta kontrollojë saktësinë e të dhënave personale;

b) përpunimi është i paligjshëm dhe subjekti i të dhënave personale kundërshton shlyerjen e të dhënave personale, me ç'rast në vend të kësaj kërkon kufizim të përdorimit të tyre;

c) për qëllimet e përpunimit, kontrollori nuk ka më tej nevojë nga të dhënat personale, por subjekti i të dhënave personale i kërkon për vendosje, realizim ose mbrojtje të kërkesave të tyre juridike;

ç) subjekti i të dhënave personale kundërshton në përpunimin në pajtim me nenin 25 paragrafi (1) i këtij ligji në pritje të verifikimit nëse interesat legjitime të kontrollorit mbizotërojnë mbi interesat e subjektit të të dhënave personale.

(2) Kur përpunimi është i kufizuar sipas paragrafit (1) të këtij neni, të dhënat personale të tilla mund të përpunohen, vetëm me pëlqim të subjektit të të dhënave personale me përjashtim të ruajtjes së tyre, ose për vendosje, realizim ose mbrojtje të kërkesave të tyre juridike ose për mbrojtje të së drejtës të personit tjetër fizik ose juridik ose për shkak të shkaqeve të rëndësishme nga interesi publik.

(3) Kur subjekti i të dhënave personale e ka realizuar të drejtën e kufizimit të përpunimit në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni, atëherë kontrollori e informon para se të pushojë kufizimi i përpunimit.

Detyrimi për njoftim gjatë korrigjimit ose shlyerjes së të dhënave personale ose kufizimi i përpunimit

Neni 23

Kontrollori është i detyruar t'i paraqesë të gjitha korrigjimet ose shlyerjet e të dhënave personale ose kufizimet në përpunimin e kryer në pajtim me nenet 20, 21 paragrafi (1) dhe 22 të këtij ligji, për çdo shfrytëzues të cilit të dhënat personale i janë zbuluar, përveç nëse kjo është e pamundur ose kërkon përpjekje të mëdha joproporcionale. Nëse subjekti i të dhënave personale kërkon atëherë kontrollori e informon subjektin e të dhënave personale për ato shfrytëzues.

E drejta e bartjes së të dhënave

Neni 24

(1) Subjekti i të dhënave personale ka të drejtë të marrë të dhënat e tij personale, të cilat i ka siguruar kontrollorit në format të strukturuar, të përdorur zakonisht, të lexueshëm nga makina, me ç'rast ka të drejtë t'ia bartë ato të dhëna kontrollorit tjetër pa ndërhyrjen nga ana e kontrollorit të cilit i janë dhënë të dhënat personale, nëse:

a) përpunimi është themeluar në bazë të pëlqimit sipas nenit 10 paragrafi (1) alineja 1 ose nenit 13 paragrafi (2) pika 1) të këtij ligji, ose në bazë të detyrimit kontraktues sipas nenit 10 paragrafi (1) alineja 2 të këtij ligji dhe

b) përpunimi kryhet në mënyrë të automatizuar.

(2) gjatë realizimit të së drejtës për bartjen e të dhënave nga paragrafi (1) i këtij neni, subjekti i të dhënave personale ka të drejtë të marrë bartje të drejtpërdrejtë të të dhënave personale nga një kontrollues në tjetrin, nëse teknikisht është e mundur.

(3) Realizimi i së drejtës nga paragrafi (1) i këtij neni nuk pengon realizimin e së drejtës të parashikuar në nenin 21 të këtij ligji. E drejta nga paragrafi (1) të këtij neni nuk ka të bëjë me përpunimin e kërkuar për kryerjen e punëve me interes publik ose gjatë kryerjes së autorizimit zyrtar që i është dhënë kontrollorit.

(4) E drejta për transferimin e të dhënave nga paragrafi (1) i këtij neni nuk mund të ndikojë negativisht në të drejtat dhe liritë e personave të tjerë fizikë.

4. E drejta e ankesës dhe miratimi i automatizuar i vendimeve të veçanta

E drejta e ankesës

Neni 25

(1) Subjekti i të dhënave personale në bazë të situatës konkrete në lidhje me të ka të drejtë të paraqesë ankesë te kontrollori në çdo kohë, kundër përpunimit të të dhënave të tij personale, në bazë të nenit 10 paragrafi (1) alineja 5 ose 6 të këtij ligji, duke përfshirë profilimin e bazuar në këto dispozita. Kontrollori nuk mund të kryejë përpunim të të dhënave personale, përveç nëse

vërteton se ekzistojnë interesa relevante të përpunimit legjitim, që mbizotërojnë mbi interesat, të drejtat dhe liritë e subjektit të të dhënave personale, ose për vendosjen, realizimin ose mbrojtjen e kërkesave të tij ligjore.

(2) Nëse të dhënat personale përpunohen për qëllime të drejtpërdrejta të marketingut, subjekti i të dhënave personale ka të drejtë në çdo kohë të paraqet ankesë për përpunimin e të dhënave personale të tij në lidhje me këtë lloj të marketingut, duke përfshirë profilimin deri në atë shkallë që i njëjti është në lidhje me marketingun e drejtpërdrejtë.

(3) Kur subjekti i të dhënave personale i kundërshton përpunimin e të dhënave të tij personale për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë, kontrollori e ndalon përpunimin e mëtejshëm të të dhënave personale për ato qëllime.

(4) Më së voni deri në momentin e komunikimit të parë me subjektin e të dhënave personale, subjekti i të dhënave personale duhet të njoftohet në mënyrë të qartë për të drejtën e tij e përcaktuar në paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, me ç'rast njoftimi duhet të bëhet në mënyrë të qartë dhe të ndarë nga çdo informacion tjetër.

(5) Në kontekstin e shfrytëzimit të shërbimeve të shoqërisë informatike dhe të pavarur nga rregullat e komunikimeve elektronike, subjekti i të dhënave personale mund ta shfrytëzojë të drejtën e kundërshtimit përmes mjeteve automatike me shfrytëzimin e specifikimeve teknike.

(6) Kur të dhënat personale përpunohen për qëllime të hulumtimeve shkencore ose historike ose për qëllime statistikore, në pajtim me nenin 86 paragrafi (1) të këtij ligji, subjekti i të dhënave ka të drejtë, në bazë të situatës konkrete të lidhur me to të parashtojë kundërshtim kundër përpunimit të të dhënave të tij personale, përveç nëse përpunimi është i nevojshëm për kryerjen e çështjeve me interes publik.

Miratimi automatik të vendimeve individuale, duke përfshirë dhe profilimin

Neni 26

(1) Subjekti i të dhënave personale ka të drejtë të mos jetë lëndë e vendimit të bazuar në vetëm në përpunimin e automatizuar, duke përfshirë edhe profilimin që shkakton pasoja juridike për të ose në mënyrë të ngjashme dukshëm ndikon në të.

(2) Paragrafi (1) i këtij neni nuk zbatohet nëse vendimi:

a) është i nevojshëm për lidhjen ose zbatimin e marrëveshjes ndërmjet subjektit të të dhënave personale dhe kontrollorit;

b) lejohet me ligj që zbatohet në lidhje me kontrollorin, dhe i cili gjithashtu parashikon masa të përshtatshme për mbrojtjen e të drejtave dhe liritë dhe interesat legjitime të subjektit të të dhënave personale ose

c) bazohet në pëlqimin eksplisit të subjektit të të dhënave personale.

(3) Në rastet e theksuara në paragrafin (2) pikat (a) dhe (c) të këtij neni, kontrollori është i detyruar të zbatojë masa përkatëse për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive, si dhe të interesave legjitim të subjektit të të dhënave personale, ndërsa së paku të drejtë për sigurimin e intervenimit njerëzor nga kontrollori, të drejtë të shprehjes së qëndrimit personal dhe të drejtë të kontestimit të vendimit të atillë.

(4) Vendimet nga paragrafi (2) i këtij neni nuk guxojnë të bazohen në kategori të veçanta të të dhënave personale, përveç nëse zbatohet neni 13 paragrafi (2) pika 1) ose 7) të këtij ligji, gjatë së cilës janë vendosur edhe masa përkatëse për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive dhe interesave legjitim të subjektit të të dhënave personale.

5. Kufizime

Kufizime

Neni 27

(1) Me Ligjin që zbatohet për kontrollorin ose përpunuesin mund të kufizohet vëllimi dhe të drejtat e përcaktuara në nenet nga 16 deri në 26 të këtij ligji dhe nenin 38 të këtij ligji, si dhe në nenin 9 të këtij ligji, nëse ato dispozita janë në pajtim me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në nenet nga 16 deri 26 të këtij ligji dhe kur kufizimi i tillë është në pajtim me esencën e të drejtave dhe lirive themelore dhe paraqet masë të nevojshme dhe proporcionale me qëllim të që të sigurohen:

- 1) siguria nacionale;
- 2) mbrojtja;
- 3) siguria publike;
- 4) parandalimi, hetimi, zbulimi ose përndjekja e autorëve të veprave penale ose sanksionet e shqiptuara ndëshkimore, përfshirë parandalimin e kërcënimeve për sigurinë publike;
- 5) qëllime tjera të rëndësishme me interes të përgjithshëm publik për Republikën e Maqedonisë së Veriut, e veçanërisht interes ekonomik ose financiar të Republikës së Maqedonisë së Veriut, përfshirë çështje monetare, buxhetore dhe tatimore, shëndetin publik dhe mbrojtjen sociale;
- 6) mbrojtja e pavarësisë së gjykatave dhe procedurave gjyqësore;
- 7) parandalim, hetim, zbulim dhe përndjekje të kundërvajtjes së rregullave etike për profesione të rregullta;
- 8) ndjekje, mbikëqyrje inspektuese ose funksione rregullatore që të paktën herë pas here janë të lidhura me përmbushjen e kompetencave të autoriteteve shtetërore në rastet e përmendura në pikat 1) deri në 5) dhe pikën 7) të këtij paragrafi;
- 9) mbrojtje të subjektit të të dhënave personale ose të drejtave dhe lirive të personave të tjerë fizikë;
- 10) realizim të kërkesave në procedurat civile.

(2) Çdo masë ligjore e përmendur në paragrafin (1) të këtij neni, në veçanti, përmban dispozita të posaçme, sipas nevojës së paku për:

- 1) qëllimet e përpunimit ose kategoritë e përpunimit;
- 2) kategoritë e të dhënave personale;
- 3) vëllimin e kufizimeve të vendosura;
- 4) masat e mbrojtura për parandalimin e keqpërdorimit ose qasjen ose bartjen joligjore;
- 5) specifikimin e kontrollorit ose kategoritë e kontrollorit;
- 6) afatet e ruajtjes dhe masat mbrojtëse të zbatueshme, duke marrë parasysh natyrën, vëllimin dhe qëllimet e përpunimit ose kategoritë e përpunimit;
- 7) rreziqet për të drejtat dhe liritë e subjekteve të të dhënave personale dhe
- 8) të drejtën e subjekteve të të dhënave të informohen për kufizimin, përveç kur kjo me përjashtim do të ishte në kundërshtim me qëllimin e kufizimit.

IV. KONTROLLORI DHE PËRPUNUESI

Obligimet e përgjithshme Përgjegjësia e kontrollorit

Neni 28

(1) Duke marrë parasysh natyrën, vëllimin, kontekstin dhe qëllimet e përpunimit, si dhe rreziqet me probabilitet të ndryshëm dhe seriozitetin për të drejtat dhe liritë e personave fizikë, kontrollori është i detyruar që të zbatojë masat e duhura teknike dhe organizative për të siguruar dhe të mund të vërtetojë që përpunimi bëhet në përputhje me këtë ligj. Masat teknike dhe organizative sipas nevojës analizohen dhe azhurnohen.

(2) Nëse është proporcionale me aktivitetet për përpunim, atëherë masat nga paragrafi (1) i këtij neni përfshijnë edhe zbatim të politikave adekuate për mbrojtje të të dhënave personale nga kontrollori.

(3) Respektimi i kodeve të miratuara të sjelljes të përmendura në nenin 44 të këtij ligji ose mekanizmat e aprovuara për certifikim të përmendur në nenin 46 të këtij ligji, mund të përdoren si një element për të dëshmuar harmonizimin me detyrimet nga ana e kontrollorit.

Mbrojtja teknike dhe e integruar e të dhënave personale (Data protection by design and by default)

Neni 29

(1) Sipas arritjeve të fundit teknologjike, shpenzimet për zbatimin, natyra, vëllimi, konteksti dhe qëllimet e përpunimit, si dhe rreziqet me probabilitet të ndryshëm dhe serioziteti për të drejtat dhe liritë e personave fizikë që dalin nga përpunimi, kontrollori në momentin e definimit të mjeteve për përpunim si dhe në momentin e vetë përpunimit, është i detyruar të zbatojë masa përkatëse teknike dhe organizative, siç janë pseudonimizimi, të cilat janë zhvilluar për të zbatuar në mënyrë efektive parimet e mbrojtjes së të dhënave personale, siç është zvogëlimi i sasisë minimale të të dhënave dhe përfshirja e masave të nevojshme mbrojtëse në procesin e përpunimit, me qëllim për të përmbushur kërkesat e këtij ligji dhe për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të subjekteve të të dhënave personale.

(2) Kontrollori do t'i zbatojë masat e duhura teknike dhe organizative për të siguruar që përpunohen në mënyrë të integruar vetëm ato të dhëna personale të nevojshme për çdo qëllim të veçantë të përpunimit. Ky obligim ka të bëjë me sasinë e të dhënave të mbledhura personale, shtrirjen e përpunimit të tyre, afatin e ruajtjes dhe arritshmërinë e tyre. Masat e tilla duhet të sigurojnë veçanërisht se të dhënat personale pa pëlqimin e subjektit të të dhënave nuk janë automatikisht të arritshme për numër të pakufizuar të personave fizikë.

(3) Mekanizmi i miratuar i certifikimit, në përputhje me nenin 46 të këtij ligji, mund të përdoret si një element për të provuar pajtueshmërinë me kërkesat e përcaktuara në paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni.

Kontrollorët e përbashkët

Neni 30

(1) Nëse dy ose më shumë kontrollorë bashkërisht i përcaktojnë qëllimet dhe mënyrat e përpunimit, atëherë ato janë kontrollorë të përbashkët. Kontrollorët e përbashkët janë të detyruar të përcaktojnë në mënyrë transparente ta përcaktojnë përgjegjësinë e tyre përkatëse për përmbushjen e detyrimeve të këtij ligji, veçanërisht në lidhje me realizimin e të drejtave të subjektit të të dhënave personale dhe detyrimet e tyre për të siguruar informacionin e përmendur

në nenet 17 dhe 18 të këtij ligji, me marrëveshjen e tyre të ndërsjellë, përveç kur përgjegjësitë e kontrolluesve përcaktohen me ligj që zbatohet për ata kontrollorë. Në marrëveshjen mund të përcaktohet edhe personi i cili do të jetë pika kontaktuese me subjektet e të dhënave personale.

(2) Marrëveshja nga paragrafi (1) i këtij neni duhet t'i pasqyrojë në mënyrë konsekuente rolet dhe marrëdhëniet e caktuara të kontrollorëve të përbashkët në lidhje me subjektet e të dhënave personale. Karakteristikat themelore të marrëveshjes duhet të jenë të arritshme për subjektin e të dhënave personale.

(3) Pavarësisht kushteve nga marrëveshja nga paragrafi (1) i këtij neni, subjekti i të dhënave personale mund t'i realizojë të drejtat e tij sipas këtij ligji në lidhje me secilin prej kontrolluesve dhe kundër secilit prej tyre.

Përfaqësuesit e kontrolluesve ose përpunuesit që nuk janë themeluar në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Neni 31

(1) Gjatë zbatimit të nenit 3 paragrafi (2) i këtij ligji, kontrollori ose përpunuesi është i detyruar që të caktojë përfaqësues të autorizuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut në formë me shkrim.

(2) Detyrimi i përcaktuar në paragrafin (1) të këtij neni, nuk ka të bëjë me:

(a) përpunimin i cili është i përkohshëm dhe nuk përfshin në një masë të madhe përpunimin e kategorive specifike të të dhënave personale, ose përpunimin e të dhënave personale në lidhje me dënimet penale dhe veprat nga neni 14 të këtij ligji, për të cilat nuk ekziston gjasë se do të paraqesë rrezik për të drejtat dhe liritë e personave fizikë, duke marrë parasysh natyrën, kontekstin, shtrirjen dhe qëllimet e përpunimit ose

(b) organet e pushtetit shtetëror ose trupit tjetër.

(3) Subjektet e të dhënave personale dhe Agjencia, përveç ose në vend kontrollorit ose përpunuesit, mund t'i drejtohen edhe përfaqësuesit të autorizuar për të gjitha çështjet që lidhen me përpunimin e të dhënave personale, e për qëllimet e harmonizimit të këtij ligji.

(4) Përcaktimi i përfaqësuesit të autorizuar nga ana e kontrollorit ose përpunuesit nuk duhet të ndikojë në veprimet juridike që mund të iniciohen kundër vetë kontrollorit ose përpunuesit.

Përpunuesi

Neni 32

(1) Nëse përpunimi kryhet në emër të kontrollorit, atëherë kontrollori shfrytëzon vetëm përpunues që sigurojnë garanci të mjaftueshme për zbatimin e masave të duhura teknike dhe organizative në atë mënyrë që përpunimi të zhvillohet në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe siguron mbrojtje të të drejtave të subjektit të të dhënave personale.

(2) Përpunuesi nuk mund të angazhojë përpunues tjetër pa autorizim paraprak të veçantë ose të përgjithshëm me shkrim nga ana e kontrollorit. Në rast të autorizimit të përgjithshëm me shkrim nga ana e kontrollorit, përpunuesi e informon kontrollorin për të gjitha ndryshimet e planifikuara për angazhim ose zëvendësim të përpunuesve të tjerë, duke i dhënë mundësi kontrollorit që t'i kundërshtojë ndryshimet e tilla.

(3) Përpunimi nga ana e përpunuesit rregullohet me marrëveshje ose akt tjetër juridik në përputhje me ligjin, i cili është i detyrueshëm për përpunuesin në lidhje me kontrollorin, dhe i cili rregullon lëndën dhe kohëzgjatjen e përpunimit, natyrën dhe qëllimin e përpunimit, llojin e të dhënave personale dhe kategoritë e subjekteve të të dhënave personale, si dhe detyrimet dhe të drejtat e kontrollorit. Në këtë marrëveshje ose akt tjetër juridik rregullohet veçanërisht se përpunuesi:

(a) i përpunon të dhënat personale vetëm sipas udhëzimeve të dokumentuara nga kontrollori, përfshirë edhe bartjen e të dhënave personale në vend të tretë ose organizatë ndërkombëtare, përveç kur është i detyruar ta bëjë këtë në përputhje me kërkesat e ligjit që zbatohet në lidhje me përpunuesin; në këtë rast, përpunuesi e informon kontrollorin për atë kërkesë juridike përpara përpunimit, përveç nëse ai ligj ndalon informim të tillë për arsye të rëndësishme të interesit publik.

(b) siguron që personat e autorizuar për përpunim të të dhënave personale janë të detyruar të respektojnë konfidencialitetin ose t'i nënshtrihen detyrimit ligjor për të respektuar konfidencialitetin;

(c) i ndërmerret të gjitha masat e nevojshme në pajtim me nenin 36 të këtij ligji;

(ç) i respekton kushtet e përmendura në paragrafët (2) dhe (4) të këtij neni për anagzhimin e përpunuesit tjetër;

(d) duke e marrë parasysh natyrën e përpunimit, ndihmon kontrollorin, duke zbatuar masat e duhura teknike dhe organizative, aq sa është e mundur, t'i përmbushë detyrimet e kontrollorit për t'u përgjigjur kërkesave për realizimin e të drejtave të subjektit të të dhënave të përcaktuara në Kapitullin III të këtij ligji;

(dh) ndihmon kontrollorin për të siguruar harmonizimin e detyrimeve në pajtim me nenet nga 36 deri 40 të këtij ligji, duke marrë parasysh natyrën e përpunimit dhe informacioneve që janë të arritshme për përpunuesin;

(e) pas zgjedhjes së kontrollorit, i fshin ose ia kthen të gjitha të dhënat personale kontrollorit pas përfundimit të shërbimeve lidhur me përpunimin e të dhënave personale dhe i fshin kopjet ekzistuese, përveç nëse me ligj ekziston detyrim me ligj për ruajtje të të dhënave personale;

(ë) i siguron qasje kontrollorit në të gjitha informacionet e nevojshme për të dëshmuar përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë nen, si dhe mundëson dhe kontribuon në kryerjen e revizioneve, përfshirë inspektimet nga ana e kontrollorit ose revizorit tjetër të autorizuar nga ana e kontrollorit.

Në lidhje me pikën (ë) të këtij paragrafi, përpunuesi duhet ta njoftojë menjëherë kontrollorin nëse, sipas mendimit të tij, udhëzime të caktuara të dhëna nga kontrollori e shkelin këtë ligj ose rregulla të tjera në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale.

(4) Nëse përpunuesi angazhon përpunues tjetër për të kryer aktivitete specifike për përpunim në emër të kontrollorit, atëherë të njëjtat detyrime për mbrojtjen e të dhënave personale siç janë detyrimet të parapara në marrëveshjen ose akt tjetër juridik ndërmjet kontrollorit dhe përpunuesit nga paragrafin (3) i këtij neni i imponohen edhe përpunuesit tjetër përmes marrëveshjes ose aktit tjetër juridik në përputhje me ligjin, dhe veçanërisht detyrimi për të siguruar një garanci të mjaftueshme për zbatimin e masave të duhura teknike dhe organizative, në mënyrë që përpunimi t'i përmbushë kërkesat e këtij ligji. Nëse përpunuesi i angazhuar nuk e përmbush detyrimin e vet për mbrojtje të të dhënave personale, përpunuesi i parë mbetet tërësisht përgjegjës para kontrollorit për përmbushjen e detyrimeve të përpunuesit të angazhuar.

(5) Respektimi nga ana e përpunuesit i kodeve të miratuara të sjelljes të përmendura në nenin 44 të këtij ligji ose mekanizmat e aprovuara për certifikim të përmendur në nenin 46 të këtij ligji, mund të përdoren si një element për të dëshmuar përmbushjen e detyrimeve nga paragrafët (1) dhe (4) të këtij neni.

(6) Marrëveshja ose akti tjetër juridik i përmendur në paragrafët (3) dhe (4) të këtij neni mund të bazohen tërësisht ose pjesërisht në klauzolat standarde të marrëveshjes, të përmendura në paragrafin (7) të këtij neni, përfshirë këtu edhe kur janë pjesë e një certifikimi që i jepet kontrollorit ose përpunuesit në përputhje me nenet 46 dhe 47 të këtij ligji, njëkohësisht pa e vënë në pyetje marrëveshjen individuale midis kontrollorit dhe përpunuesit.

(7) Agjencia mund të përcaktojë klauzola standarde të marrëveshjes për çështjet të përmendura në paragrafët (3) dhe (4) të këtij neni.

(8) Marrëveshja ose akti tjetër juridik nga paragrafët (3) dhe (4) të këtij neni duhet të jetë në formë me shkrim, përkatësisht në formë elektronike, në pajtim me ligjin.

(9) Nëse përpunuesi me përcaktim të qëllimeve dhe mënyrës së përpunimit e shkel këtë ligj, atëherë përpunuesi konsiderohet si kontrollor në lidhje me atë përpunim, njëkohësisht duke mos e vënë në pikëpyetje nenin 101 dhe dispozitat nga kapitulli IX i këtij ligji.

Përpunimi me autorizimin nga ana e kontrollorit ose përpunuesit

Neni 33

Përpunuesi dhe çdo person që vepron me autorizim nga ana e kontrollorit ose përpunuesit, e që ka qasje në të dhënat personale, nuk duhet t'i përpunojë të dhënat e tilla përveç nëse jepen udhëzime nga kontrollori, përveç nëse nuk kërkohet përpunimi me këtë ligj ose ligj tjetër.

Evidenca e aktiviteteve për përpunim

Neni 34

(1) Çdo kontrollues dhe përfaqësuesi i tij i autorizuar, mban evidencë të operacioneve për përpunim, e për të cilat është përgjegjës. Kjo evidencë, veçanërisht i përmban informatat vijuese:

(a) emërtimin, përkatësisht emrin dhe mbiemrin dhe të dhënat kontaktuese të kontrollorit dhe të gjithë kontrollorët e përbashkët, të përfaqësuesit të autorizuar dhe oficerit për mbrojtjen e të dhënave personale;

(b) qëllimet e përpunimit;

(c) përshkrimin e kategorive të subjekteve të të dhënave personale dhe të kategorive të të dhënave personale;

(ç) kategoritë e shfrytëzuesve të të cilëve u janë zbuluar ose do t'u zbulohen të dhënat personale, përfshirë shfrytëzuesit në vendet e treta ose organizatat ndërkombëtare;

(d) bartjen e të dhënave personale në vendin e tretë ose organizatën ndërkombëtare, përfshirë identifikimin e atij vendi të tretë ose organizate ndërkombëtare, e në rast të bartjes së të dhënave personale, nga neni 53 paragrafi (1) nënparagrafi i dytë i këtij ligji, dokumentacion për masa mbrojtëse përkatëse;

(dh) afatet e parapara për fshirje të kategorive të ndryshme të të dhënave personale;

(e) përshkrimin e përgjithshëm të masave teknike dhe organizative për siguri nga neni 36 paragrafi (1) i këtij ligji.

(2) Çdo përpunues dhe përfaqësuesi i tij i autorizuar, mban shënime për të gjitha kategoritë e operacioneve të përpunimit të kryera në emër të kontrollorit, ku janë përfshirë:

(a) emërtimi, përkatësisht emri dhe mbiemri dhe të dhënat kontaktuese të përpunuesit ose përpunuesve dhe të gjitha kontrolluesve në emër të të cilave vepron përpunuesi, të përfaqësuesve të autorizuar të kontrollorit ose përpunuesit dhe oficerit për mbrojtjen e të dhënave personale;

(b) kategoritë e përpunimit që kryhen në emër të çdo kontrollori;

(c) bartja e të dhënave personale në vendin e tretë ose organizatën ndërkombëtare, përfshirë identifikimin e atij vendi të tretë ose organizate ndërkombëtare, e në rast të bartjes së të dhënave personale, nga neni 53 paragrafi (1) nënparagrafi i dytë i këtij ligji, dokumentacion për masa mbrojtëse përkatëse;

(ç) përshkrimin e përgjithshëm të masave teknike dhe organizative për siguri nga neni 36 paragrafi (1) i këtij ligji.

(3) Evidencat nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, mbahen në formë me shkrim, përkatësisht edhe në formë elektronike, në pajtim me ligjin.

(4) Kontrollori ose përpunuesi dhe ku është e zbatueshme, përfaqësuesit e tyre të autorizuar, me kërkesë të Agjencisë, sigurojnë qasje në evidencat nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni.

(5) Detyrimet nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni nuk zbatohen për kompani ose organizatë tregtare me më pak se 50 të punësuar, përveç nëse ekziston mundësi që përpunimi që e kryejnë ata të përbëjë rrezik për të drejtat dhe liritë e subjekteve të të dhënave personale, nëse përpunimi nuk është i përkohshëm ose përpunimi përfshin kategori të veçanta të të dhënave personale ose të dhënave personale që lidhen me dënimet penale dhe veprat ndëshkimore nga neni 14 i këtij ligji.

Bashkëpunimi me Agjencinë

Neni 35

Kontrollori dhe përpunuesi dhe përfaqësuesit e tyre të autorizuar, janë të detyruar që me kërkesë të Agjencisë të bashkëpunojnë me të, gjatë përmeshjes së detyrave të saj.

2. Siguria e të dhënave personale

Siguria e përpunimit

Neni 36

(1) Sipas arritjeve më të fundit teknologjike, shpenzimet për zbatimin dhe natyrën, vëllimin, kontekstin dhe qëllimet e përpunimit, si dhe rreziqet me shkallë të ndryshme të mundësisë dhe serioziteti për të drejtat dhe liritë e personave fizikë, kontrollori dhe përpunuesi janë të detyruar të zbatojnë teknika dhe masa organizative përkatëse për të siguruar nivel të sigurisë adekuat për rrezikun, duke përfshirë, sipas nevojës:

- (a) pseudominimizimin dhe kriptimin e të dhënave personale;
- (b) aftësinë për sigurim të konfidencialitetit, integritetit, arritshmërisë dhe rezistencës së vazhdueshme të sistemeve dhe shërbimet për përpunim;
- (c) aftësinë për vendosje në kohë, të sërishme të arritshmërisë së të dhënave personale dhe qasjes në to në rast të incidentit fizik ose teknik;
- (ç) procesin e testimit, vlerësimit dhe evaluimit të rregullt të efikasitetit të masave teknike dhe organizative me qëllim për të garantuar sigurinë e përpunimit.

(2) Gjatë vlerësimit të nivelit përkatës të sigurisë merren parasysh veçanërisht rreziqet që janë të lidhura me përpunimin, veçanërisht nga shkatërrimi i rastësishëm ose joligjor, humbjen, ndryshimin, zbulimin e paautorizuar të të dhënave personale ose qasjen e paautorizuar në të dhënat e përpunuara personale të bartura, të ruajtura ose në mënyrë tjetër të përpunuara.

(3) Respektimi i kodeve të miratuara të sjelljes të përmendura në nenin 44 të këtij ligji ose mekanizmat e aprovuara për certifikim të përmendur në nenin 46 të këtij ligji, mund të shfrytëzohet si element për të dëshmuar harmonizimin me kërkesat e përcaktuara në paragrafin (1) të këtij neni.

(4) Kontrollori dhe përpunuesi duhet të marrin masa për të siguruar që çdo person fizik që vepron sipas autoritetit të kontrollorit ose përpunuesit, e që ka qasje në të dhënat personale nuk do t'i përpunojë këto të dhëna, nëse nuk u jepen udhëzime nga kontrollori, përveç nëse është i detyruar t'i përpunojë sipas ligjit.

(5) Kontrollori dhe përpunuesi janë të detyruar që ta demonstrojnë zbatimin e masave sipas kërkesave të përcaktuara në paragrafin (1) të këtij neni.

Njoftimi i Agjencisë për cenim të sigurisë së të dhënave personale

Neni 37

(1) Në rast të cenimit të sigurisë së të dhënave personale, kontrollori menjëherë dhe jo më vonë se 72 orë pasi të mësojë këtë shkelje, është i detyruar të njoftojë Agjencinë për cenimin e sigurisë së të dhënave personale, përveç nëse nuk ekziston mundësi që cenimi i sigurisë së të dhënave personale të krijojë rrezik për të drejtat dhe liritë e individëve. Kur njoftimi në Agjenci nuk është parashtruar në afat prej 72 orëve, bashkë me njoftimin duhet të dorëzohet edhe arsytim për shkaqet për vonimin.

(2) Përpunuesi është i detyruar ta njoftojë kontrollorin menjëherë pasi të ketë mësuar për cenimin e sigurisë së të dhënave personale.

(3) Njoftimi nga paragrafi (1) i këtij neni, doemos duhet ta përmbajë së paku:

(a) përshkrimin e natyrës së cenimit të sigurisë së të dhënave personale, përfshirë kategoritë dhe numrin e përafërt të subjekteve të të dhënave personale në fjalë, si dhe kategoritë dhe numrin e përafërt të të dhënave personale të prekura të evidentuara;

(b) shënimin e emrit, mbiemrit dhe të dhënave kontaktuese të zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave personale ose të personit tjetër për kontakt, nga i cili mund të merren më shumë informata;

(c) përshkrimin e pasojave të mundshme nga cenimi i sigurisë së të dhënave personale;

(ç) përshkrimin e masave të ndërmarra ose të propozuara nga ana e kontrollorit për ballafaqim me cenimin e sigurisë së të dhënave personale, përfshirë masa përkatëse për zvogëlimin e efekteve të mundshme negative.

(4) Informatat mund gradualisht të sigurohen pa prolongim të mëtutjeshëm të panevojshëm, vetëm nëse nuk ka qenë e mundshme ose një pjesë e informatave të parashtrohen njëkohësisht.

(5) Kontrollori i dokumenton të gjitha cenimet e sigurisë së të dhënave personale, përfshirë faktet që lidhen me cenimin e sigurisë së të dhënave personale, pasojat e tyre dhe aktivitetet e ndërmarra për ballafaqim me cenimin, në mënyrë që t'i mundësojë Agjencisë ta kontrollojë harmonizimin me këtë nen.

Njoftimi i subjektit të të dhënave personale për cenimin e sigurisë së të dhënave personale

Neni 38

(1) Në rast të cenimit të sigurisë së të dhënave personale, për të cilin ekziston mundësi që të shkaktojë rrezik të lartë për të drejtat dhe liritë e personave fizikë, kontrollori, menjëherë e njofton subjektin e të dhënave personale për cenimin e sigurisë së të dhënave personale.

(2) Në njoftimin drejtuar subjektit të të dhënave personale nga paragrafi (1) i këtij neni, në gjuhë të qartë dhe të thjeshtë përshkruhet natyra e cenimit të sigurisë së të dhënave personale dhe përmenden së paku informatat dhe masat e përmendura në nenin 37 paragrafi (3) pikat (b), (c) dhe (ç) të këtij ligji.

(3) Njoftimi drejtuar subjektit të të dhënave personale nga paragrafi (1) i këtij neni, nuk është i detyrueshëm, nëse është përmbushur njëri prej kushteve vijuese:

(a) kontrollori ka zbatuar masa përkatëse teknike dhe organizative për mbrojtje dhe ato masa janë zbatuar në lidhje me të dhënat personale të prekura nga cenimi i sigurisë së të dhënave personale, veçanërisht masa që i bëjnë të dhënat personale të kuptueshme për çdo person që nuk ka autorizim për qasje në to, siç është kriptimi;

(b) kontrollori ka zbatuar masa plotësuese që garantojnë se tashmë nuk ekziston mundësi për paraqitje të rrezikut të lartë për të drejtat dhe liritë e subjekteve të të dhënave personale nga paragrafi (1) i këtij neni;

(c) nëse njoftimi kërkon përpjekje joproportionale. Në atë rast, bëhet njoftimi publik ose zbatohet masa tjetër e ngjashme me të cilën subjektet e të dhënave personale do të informohen barazisht në mënyrë efikase.

(4) Nëse kontrollori nuk e ka njoftuar subjektin e të dhënave personale për cenimin e sigurisë së të dhënave personale, Agjencia pas konstatimit të mundësisë se cenimi i sigurisë së të dhënave personale shkakton rrezik të lartë, mund të kërkojë nga kontrollori ta njoftojë për cenimin ose të vendosë se është përmbushur ndonjë prej kushteve nga paragrafi (3) i këtij neni.

3. Vlerësimi i ndikimit të mbrojtjes së të dhënave personale dhe konsultimi paraprak

Vlerësimi i ndikimit të mbrojtjes së të dhënave personale

Neni 39

(1) Kur gjatë shfrytëzimit të teknologjive të reja për ndonjë lloj të përpunimit, sipas natyrës, vëllimit, kontekstit dhe qëllimeve të përpunimit, ekzistim gjasa që ajo të shkaktojë rrezik të lartë për të drejtat dhe liritë e personave fizikë para se të bëhet përpunimi, kontrollori ka për detyrë të vlerësojë ndikimin e operacioneve të parapara të përpunimit në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale. Një vlerësim mund të lidhet me një seri operacionesh të ngjashme të përpunimit që paraqesin rreziqe të ngjashme të larta.

(2) Gjatë kryerjes së vlerësimit të ndikimit mbi mbrojtjen e të dhënave personale, kontrollori ka për detyrë të kërkojë këshillë nga personi i autorizuar për mbrojtjen e të dhënave personale, nëse ai është caktuar.

(3) Vlerësimi i ndikimit mbi mbrojtjen e të dhënave personale nga paragrafi (1) i këtij neni, kërkohet në veçanti në rastin e:

a) vlerësimit sistematik dhe gjithëpërfshirës të aspekteve personale në lidhje me personat fizikë, që bazohet në përpunimin automatik, duke e përfshirë edhe profilimin, në bazë të së cilës miratohen vendimet që prodhojnë veprim juridik në lidhje me personin fizik ose ndikojnë dukshëm në personin fizik;

(b) përpunimit të gjerë të kategorive të veçanta të të dhënave personale ose të dhënave personale që lidhen me dënimet penale dhe veprat penale nga neni 14 i këtij ligji ose

(c) mbikëqyrjes sistematike të hapësirave të arritshme publikisht në përmasa të mëdha.

(4) Agjencia vendos dhe boton publikisht listë të llojeve të operacioneve të përpunimit, për të cilat kërkohet vlerësimi i ndikimit mbi mbrojtjen e të dhënave personale, në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni.

(5) Agjencia mund të vendos dhe publikisht të botojë listë të llojeve të operacioneve të përpunimit, për të cilat nuk kërkohet vlerësimi i ndikimit mbi mbrojtjen e të dhënave personale.

(6) Vlerësimi nga paragrafi (1) i këtij neni duhet të përmbajë së paku:

a) përshkrimin sistematik të operacioneve për përpunimin e parashikuar dhe qëllimet e përpunimit, duke i përfshirë, ku është e zbatueshme edhe interesat legjitime të kontrollorit;

b) vlerësimin e domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit të operacioneve të përpunimit në lidhje me qëllimet;

c) vlerësimin e rreziqeve për të drejtat dhe liritë e subjekteve të të dhënave personale nga paragrafi (1) i këtij neni dhe

ç) masat e parapara për zgjidhjen e rreziqeve, duke i përfshirë masat e mbrojtjes, masat e sigurisë dhe mekanizmat për të siguruar mbrojtjen e të dhënave personale dhe për të demonstruar harmonizimin me këtë ligj, duke i marrë parasysh të drejtat dhe interesat legjitime të subjekteve të të dhënave personale dhe personave të tjera të prekur.

(7) Respektimi i kodeve të miratuara të sjelljes të theksuara në nenin 44 të këtij ligji nga kontrollorit ose përpunuesit, do të merret parasysh gjatë vlerësimit të ndikimit të operacioneve gjatë përpunimit nga ana e atyre kontrolluesve ose përpunuesve, veçanërisht për qëllimet e vlerësimit të ndikimit të mbrojtjes së të dhënave personale.

(8) Kontrollori kërkon mendim nga subjektet e të dhënave personale ose përfaqësuesve të tyre për përpunimin e planifikuar, pa ndikuar në mbrojtjen e interesave komerciale ose publike ose sigurinë e operacioneve të përpunimit.

(9) Kontrollori e kryen rishqyrtimin për të vlerësuar nëse përpunimi kryhet në pajtim me vlerësimin e ndikimit të mbrojtjes së të dhënave personale të paktën në rastet kur ka ndryshim të rrezikut të shkaktuar nga operacionet e atij përpunimi.

Konsultimi paraprak

Neni 40

(1) Kontrollori ka për detyrë të konsultohet me Agjencinë përpara përpunimit, nëse vlerësimi i ndikimit të mbrojtjes së të dhënave personale nga neni 39 i këtij ligji tregon se, nëse kontrollori nuk ndërmerr masa për zbutjen e rrezikut, atëherë përpunimi do të shkaktojë rrezik të lartë.

(2) Kur Agjencia konsideron se përpunimi i planifikuar i theksuar në paragrafin (1) të këtij neni e shkel këtë ligj, veçanërisht kur kontrollori nuk e ka identifikuar apo zvogëluar rrezikun në masën e mjaftueshme, atëherë Agjencia në afat jo më të gjatë se 60 ditë nga dita e pranimit të kërkesës për konsultim, i jep mendim me shkrim kontrollorit ose kur është e zbatueshme përpunuesit, me ç'rast mund të shfrytëzojë cilëndo qoftë nga autorizimet e tij nga neni 66 i këtij ligji. Ky afat mund të vazhdohet për 40 ditë shtesë, duke e pasur parasysh kompleksitetin e përpunimit të planifikuar. Agjencia në afat prej 30 ditësh nga pranimi i kërkesës për konsultim, e informon kontrollorin dhe përpunuesin për vazhdimin e afatit, duke i përfshirë arsyet për anulimin e afatit. Këto afate mund të pezullohen derisa Agjencia nuk i merr të gjitha informatat e kërkuara për qëllimet e konsultimit.

(3) Gjatë konsultimit me Agjencinë në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni, kontrollori i Agjencisë i dorëzon informatat si vijon:

(a) të dhënat për përgjegjësitë konkrete të kontrollorit, kontrollorit e përbashkët dhe përpunuesit e përfshirë në përpunim, veçanërisht gjatë përpunimit në kuadër të grupit të personave juridikë;

(b) qëllimet dhe mjetet e përpunimit të planifikuar;

(c) masat e parapara të mbrojtjes dhe masat e tjera për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të subjekteve të të dhënave personale në pajtim me këtë ligj;

(ç) të dhënat për kontakt të oficerit për mbrojtjen e të dhënave personale;

(d) vlerësimin e ndikimit të mbrojtjes së të dhënave personale, sipas nenit 39 të këtij ligji dhe

(dh) të gjitha të dhënat tjera të kërkuara nga Agjencia.

(4) Organet e pushtetit shtetëror dhe organet shtetërore do të konsultohen me Agjencinë gjatë përgatitjes së propozim-ligjeve ose akteve nënligjore që të miratohen në bazë të këtyre ligjeve, ndërsa të cilat kanë të bëjnë me përpunimin e të dhënave personale.

(5) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, gjatë procesit të konsultimit të kontrollorëve me Agjencinë, kontrollori ka për detyrë të kërkojë lejen paraprak nga Agjencia për përpunimin që do të kryhet nga kontrollori për qëllimet e interesit publik, duke e përfshirë edhe përpunimin për qëllimet e mbrojtjes sociale dhe shëndetësisë publike.

(6) Leja nga paragrafi (5) i këtij neni kërkohe veçanërisht në rast kur:

(a) aktivitetet themelore të kontrollorit përbëhen nga operacionet e përpunimit, të cilat për shkak të natyrës, fushëveprimit dhe / ose qëllimeve të tyre, kërkojnë në masë të madhe ndjekjen e rregullt dhe sistematike të subjekteve të të dhënave personale;

(b) aktivitetet themelore të kontrollorit përbëhen nga përpunimi i gjerë i kategorive të veçanta të të dhënave personale ose të të dhënave personale në lidhje me dënimet penale dhe veprat penale nga neni 14 i këtij ligji ose

(c) do të kryhet mbikëqyrja sistematike e hapësirave në përmasa të mëdha.

4. Personi i autorizuar për mbrojtjen e të dhënave personale

Caktimi i personit të autorizuar për mbrojtjen e të dhënave personale

Neni 41

(1) Kontrollori dhe përpunuesi kanë për detyrë të përcaktojnë person të autorizuar për mbrojtjen e të dhënave personale (në tekstin e mëtejshëm: oficer për mbrojtjen e të dhënave personale) në çdo rast kur:

(a) përpunimi kryhet nga organi i pushtetit shtetëror, përveç në gjykatat kur veprojnë në kuadër të kompetencave të tyre, ndërsa të cilët do të caktojnë oficer për përpunimin tjetër të të dhënave personale që kryhet në pajtim me ligjin;

(b) aktivitetet themelore të kontrollorit ose përpunuesit përbëhen nga operacionet e përpunimit, të cilat për shkak të natyrës, fushëveprimit dhe / ose qëllimeve të tyre, kërkojnë në masë të madhe ndjekjen e rregullt dhe sistematike të subjekteve të të dhënave personale ose

(c) aktivitetet themelore të kontrollorit ose përpunuesit përbëhen nga përpunimi i gjerë i kategorive të veçanta të të dhënave personale ose të të dhënave personale në lidhje me dënimet penale dhe veprat penale nga neni 14 i këtij ligji.

(2) Grupi i personave juridikë mund të caktojnë një oficer për mbrojtjen e të dhënave personale, me kusht që oficeri për mbrojtjen e të dhënave personale është lehtësisht i arritshëm për çdo person juridik në kuadër të grupit, Agjencisë dhe subjekteve të të dhënave personale.

(3) Kur kontrollori ose përpunuesi është organ i administratës shtetërore, një oficer për mbrojtjen e të dhënave personale mund të caktohet për disa organe në përbërje, duke e marrë parasysh strukturën dhe madhësinë e tyre organizative.

(4) Përveç rasteve të theksuara nga paragrafi (1) i këtij neni, kontrollori ose përpunuesi ose shoqatat dhe trupat tjerë që i përfaqësojnë kategoritë e kontrolluesve ose përpunuesve, mund të caktojnë oficer për mbrojtjen e të dhënave personale. Oficeri për mbrojtjen e të dhënave personale mund t'i kryejë detyrat për atë shoqatë ose trup tjetër që i përfaqëson kontrollorit dhe përpunuesit.

(5) Oficeri për mbrojtjen e të dhënave personale caktohet në bazë të kualifikimeve të tij profesionale, dhe veçanërisht në bazë të njohurive profesionale për legjislacionin dhe praktikat në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, si dhe aftësinë e tij për t'i kryer detyrat e theksuara në nenin 43 të këtij ligji.

Oficer për mbrojtjen e të dhënave personale caktohet personi i cili:

- i përmbush kushtet e punësimit të caktuara me këtë ligj dhe me ligj tjetër,
- në mënyrë aktive e njeh gjuhën maqedonase,
- në momentin e përcaktimit me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion i kundërvajtjes ndalim për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë ose detyrës,
- ka të mbaruar arsimin e lartë dhe
- ka fituar njohuri dhe aftësi në lidhje me praktikat dhe rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale, në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(6) Oficeri për mbrojtjen e të dhënave personale mund të jetë i punësuar te kontrollori ose përpunuesi ose mund t'i kryejë punët në bazë të kontratës për shërbime.

(7) Kontrollori ose përpunuesi i publikon publikisht të dhënat e kontaktit për oficerin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe e njofton Agjencinë.

Pozita e oficerit për mbrojtjen e të dhënave personale

Neni 42

(1) Kontrollori dhe përpunuesi kanë për detyrë të sigurojnë që oficeri për mbrojtjen e të dhënave personale është i përfshirë në mënyrë të duhur dhe me kohë në të gjitha çështjet që lidhen me mbrojtjen e të dhënave personale.

(2) Kontrollori dhe përpunuesi kanë për detyrë t'i sigurojnë mbështetje oficerit për mbrojtjen e të dhënave personale gjatë kryerjes së punëve të theksuara në nenin 43 të këtij ligji, duke i siguruar resurse të domosdoshme për kryerjen e atyre punëve dhe qasjen në të dhënat personale dhe operacionet e përpunimit, si dhe mbajtjen e njohurisë së tij personale.

(3) Kontrollori dhe përpunuesi kanë për detyrë të garantojnë që oficeri për mbrojtjen e të dhënave personale nuk do të marrë kurrfarë udhëzimesh nga niveli më i lartë udhëheqës i kontrollorit ose përpunuesit në lidhje me kryerjen e punëve të tij. Oficeri për mbrojtjen e të dhënave personale nuk mund të ndërrohet ose ndëshkohet nga kontrollori ose përpunuesi për kryerjen e punëve të tij. Oficeri për mbrojtjen e të dhënave personale drejtpërdrejt përgjigjet para nivelit më të lartë udhëheqës të kontrollorit ose përpunuesit.

(4) Subjektet e të dhënave personale mund ta kontaktojnë oficerin për mbrojtjen e të dhënave personale për të gjitha çështjet në lidhje me përpunimin e të dhënave të tyre personale dhe për realizimin e të drejtave të tyre sipas këtij ligji.

(5) Oficeri për mbrojtjen e të dhënave personale ka për detyrë ta respektojë sekretin ose konfidencialitetin në lidhje me kryerjen e punëve të tij, në pajtim me ligjin.

(6) Oficeri për mbrojtjen e të dhënave personale mund të kryejë edhe punë dhe detyra të tjera. Kontrollori ose përpunuesi ka për detyrë të sigurojë që punët dhe detyrat e tilla nuk shkaktojnë konflikte të interesit.

Punët që i kryen oficeri për mbrojtjen e të dhënave personale

Neni 43

(1) Oficeri për mbrojtjen e të dhënave personale i kryen së paku punët si në vijim:

(a) informon dhe i këshillon kontrollorin ose përpunuesin dhe të punësuarit që kryejnë përpunimin në mënyrë përkatëse me obligimet e tyre sipas dispozitave të këtij ligji;

(b) e ndjek harmonizimin me këtë ligj, me ligjet tjera që merren me mbrojtjen e të dhënave personale në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si dhe me politikat e kontrollorit ose përpunuesit në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale, duke e përfshirë shpërndarjen e përgjegjësive, ndërgjegjësimin dhe trajnimin e të punësuarve që do të marrin pjesë në operacionet e përpunimit, si dhe kryerjen e revizioneve për mbrojtjen e të dhënave personale;

(c) kur është e nevojshme, jep këshilla në lidhje me vlerësimin e ndikimit të mbrojtjes së të dhënave personale dhe e ndjek kryerjen e vlerësimit në pajtim me nenin 39 të këtij ligji;

(ç) bashkëpunon me Agjencinë;

(d) vepron si pikë kontakti për Agjencinë në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me përpunimin, duke e përfshirë konsultimin paraprak nga neni 40 i këtij ligji, si dhe këshillimin sipas nevojave për të gjitha çështjet e tjera.

(2) Gjatë kryerjes së punëve të tij, oficeri për mbrojtjen e të dhënave personale i merr parasysh rreziqet që lidhen me operacionet e përpunimit, si dhe natyrën, vëllimin, kontekstin dhe qëllimet e përpunimit.

5. Kodet e sjelljes dhe certifikimi

Kodet e sjelljes

Neni 44

(1) Në pajtim me karakteristikat specifike të sektorëve të ndryshëm të përpunimit të të dhënave personale dhe nevojave specifike të shoqërive tregtare mikro, të vogla dhe të mesme, dhe me qëllim të kontribuohet për zbatimin e drejtë të këtij ligji, shoqatat dhe trupat tjerë që i përfaqësojnë kategoritë e kontrolluesve ose përpunuesve mund të përpunojnë kode të sjelljes ose ndryshimet ose plotësimet e kodeve të tilla me qëllim të saktësohet zbatimi i këtij ligji, në lidhje me:

- (a) përpunimin e drejtë dhe transparent;
- (b) interesat legjitime të kontrolluesve në kontekstet specifike;
- (c) grumbullimin e të dhënave personale;
- (ç) pseudonimizimin e të dhënave personale;
- (d) informimin e opinionit dhe subjekteve të të dhënave personale;
- (dh) realizimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave personale;
- (e) informimin dhe mbrojtjen e fëmijëve dhe mënyrën e marrjes së pëlqimit nga përfaqësuesit ligjorë të fëmijës;

(ë) masat dhe procedurat e theksuara në nenet 28 dhe 29 të këtij ligji, si dhe masat për të garantuar sigurinë gjatë përpunimit të të dhënave personale të përcaktuara në nenin 36 të këtij ligji;

(f) njoftimin e Agjencisë për shkeljet e sigurisë së të dhënave personale dhe informimin e subjekteve të të dhënave personale për shkeljet e tilla të sigurisë së të dhënave personale;

(g) bartjen e të dhënave personale në vendet e treta ose organizatat ndërkombëtare; ose

(gj) procedurat jashtëgjyqësore dhe procedurat e tjera për zgjidhjen e kontesteve ndërmjet kontrolluesve dhe subjekteve të të dhënave personale në lidhje me përpunimin, duke mos i cenuar të drejtat e subjekteve të të dhënave personale, në bazë të neneve 97 dhe 99 të këtij ligji.

(2) Kodi i sjelljes nga paragrafi (1) i këtij neni i përmban mekanizmat që i mundësojnë trupit monitorues nga neni 45 të këtij ligji detyrimisht të monitorojë në harmonizimin me dispozitat e tij nga kontrollorit ose përpunuesit që janë obliguar për zbatimin e tij, pa i përjashtuar kompetencat dhe detyrat e Agjencisë sipas neneve 64 ose 65 të këtij ligji.

(3) Shoqatat dhe trupat tjerë nga paragrafi (1) të këtij neni, të cilët hartojnë kod të sjelljes ose e ndryshojnë dhe plotësojnë kodin ekzistues, e dorëzojnë propozim-kodin, ndryshimin ose plotësimin e tij në Agjenci. Agjencia jep mendim për atë nëse propozim-kodi, ndryshimi ose plotësimi i tij janë harmonizuar me këtë ligj, dhe njëherazi e miraton propozim-kodin, ndryshimin ose plotësimin e tij, nëse konsideron se siguron masa të mjaftueshme përkatëse të mbrojtjes.

(4) Kur propozim-kodi i sjelljes, ndryshimi ose plotësimi i tij miratohen në pajtim me paragrafin (3) të këtij neni, Agjencia e regjistron dhe e boton Kodin.

(5) Agjencia mban regjistër të të gjitha kodeve të miratuara të sjelljes, ndryshimeve dhe plotësimeve dhe siguron qasjen e publikut në to në mënyrë përkatëse.

(6) Formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit nga paragrafi (5) i këtij neni i përcakton drejtori i Agjencisë.

Monitorimi i kodeve të miratuara të sjelljes

Neni 45

(1) Pa i përjashtuar detyrat dhe autorizimet e Agjencisë nga nenet 65 dhe 66 të këtij ligji, monitorimi i harmonizimit të kodit të sjelljes, në pajtim me nenin 44 të këtij ligji, mund të kryhet nga trupi që ka nivel të duhur të profesionalizmit në lidhje me lëndën e kodit dhe është i akredituar për atë qëllim nga Agjencia.

(2) Trupi nga paragrafi (1) të këtij neni, mund të akreditohet për monitorimin e harmonizimit të kodit të sjelljes, nëse:

(a) para Agjencisë e ka dëshmuar pavarësinë dhe profesionalizmin e vet në lidhje me lëndën e kodit;

(b) ka vendosur procedura që i mundësoan t'i vlerësojë kualifikimet e kontrolluesve dhe përpunuesve për të zbatuar kodin, për të monitoruar nëse ato janë harmonizuar me dispozitat e kodit, si dhe të bëjë kontroll periodik të funksionimit të tyre;

(c) ka vendosur procedura dhe struktura për të vepruar sipas kundërshtimeve për shkeljen e kodit ose për mënyrën në të cilën kodi ishte zbatuar ose zbatohet nga kontrollori ose përpunuesi dhe ato janë transparente në lidhje me subjektet e të dhënave personale dhe publikun dhe

(ç) Agjencisë në masë të madhe i ka dëshmuar se detyrat dhe punët e saj nuk çojnë në konfliktin e interesave.

(3) Standardet dhe normativat më të afërta për akreditimin e trupit nga paragrafi (1) i këtij neni i përcakton drejtori i Agjencisë.

(4) Pa i përjashtuar detyrat dhe autorizimet e Agjencisë dhe dispozitat e Kapitullit VIII dhe Kapitullit IX të këtij ligji, gjatë ekzistimit të masave përkatëse të mbrojtjes, trupi nga paragrafi (1) të këtij neni, ndërmerr veprime të duhura në rast të shkeljes së kodit të sjelljes nga kontrollori ose përpunuesi, duke e përfshirë pezullimin ose përjashtimin e kontrollorit ose përpunuesit të prekur nga kodi. Trupi nga paragrafi (1) i këtij neni e informon Agjencinë për këto aktivitete dhe për arsyet e ndërmarrjes së tyre.

(5) Agjencia e tërheq akreditimin e trupit nga paragrafi (1) të këtij neni në afat prej 15 ditësh nga krijimi i kushteve, përkatësisht kushtet e akreditimit nuk respektohen ose nuk plotësohen më, ose nëse aktivitetet që zbatohen nga trupi e shkelin këtë ligj.

(6) Dispozitat e këtij neni nuk zbatohen në lidhje me përpunimin e kryer nga organet e pushtetit shtetëror dhe organet e tjera shtetërore.

Certifikimi

Neni 46

(1) Në pajtim me karakteristikat specifike të sektorëve të ndryshëm të përpunimit të të dhënave personale dhe nevojave specifike të shoqërive tregtare mikro, të vogla dhe të mesme, për të kontribuar në zbatimin e duhur të këtij ligji, Agjencia inkurajon vendosjen e certifikimit të mbrojtjes së të dhënave personale, si dhe vulat dhe shenjat për mbrojtjen e të dhënave personale me qëllim të demonstrimit të harmonizimit me këtë ligj gjatë përpunimit të operacioneve nga kontrollorit dhe përpunuesit.

(2) Certifikimi është vullnetar dhe është i arritshëm publikisht.

(3) Certifikimi sipas këtij neni nuk e zvogëlon përgjegjësinë e kontrollorit ose përpunuesit për harmonizimin me këtë ligj, si dhe nuk i përjashton kompetencat dhe detyrat e Agjencisë sipas neneve 64 ose 65 të këtij ligji.

(4) Certifikimi i këtij neni kryhet nga Agjencia ose nga trupat certifikues, në pajtim me nenin 47 të këtij ligji, dhe në bazë të standardeve dhe normativave të përcaktuara nga drejtori i Agjencisë.

(5) Për përpunimin që është lëndë e mekanizmit të certifikimit, kontrollori ose përpunuesi i trupit certifikues nga neni 47 të këtij ligji ose Agjencisë ia siguron të gjitha informacionet dhe qasjen në operacionet e tij të përpunimit që janë të domosdoshme për mbajtjen e procedurës së certifikimit.

(6) Certifikata i lëshohet kontrollorit ose përpunuesit për periudhë jo më të gjatë se tre vjet dhe mund të rinovohet me të njëjtat kushte nëse standardet dhe normativat nga paragrafi (4) të këtij neni dhe më tutje përmbushen. Certifikata tërhiqet nga trupat e certifikimit nga neni 47 të këtij ligji ose nga Agjencia, kur kërkesat e certifikimit nuk janë përmbushur ose më nuk përmbushen.

(7) Agjencia mban regjistër për të gjitha mekanizmat e certifikimit, si dhe të gjitha vultat dhe shenjat për mbrojtjen e të dhënave personale dhe siguron qasje publike në to në mënyrë përkatëse.

(8) Formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit nga paragrafi (7) i këtij neni i përcakton drejtori i Agjencisë.

Trupat e certifikimit

Neni 47

(1) Pa u përjashtuar detyrat dhe autorizimet e Agjencisë, në pajtim me nenet 65 dhe 66 të këtij ligji, trupat e certifikimit që kanë nivel përkatës të profesionalizmit në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, e njoftojnë Agjencinë me qëllim që t'u lejojë t'i zbatojnë autorizimet e tyre, me ç'rast nëse është e nevojshme Agjencia u lëshon dhe rinovon certifikatat në pajtim me nenin 66 paragrafi (2) pika (ë) të këtij ligji.

(2) Trupat e certifikimit nga paragrafi (1) i këtij neni që do të kryejnë certifikimin në pajtim me dispozitat e këtij ligji, do të akreditohen nga Instituti i Akreditimit i Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: Instituti), në pajtim me rregullat e akreditimit. Trupat e certifikimit nga ky paragraf, akreditohen vetëm nëse:

(a) e kanë dëshmuar para Institutit pavarësinë dhe profesionalizmin e tyre në lidhje me lëndën e certifikimit;

(b) janë obliguar t'i respektojnë standardet dhe normativat e certifikimit nga neni 46 paragrafi (4) të këtij ligji;

(c) kanë vendosur procedura për lëshimin, kontrolle periodike dhe tërheqje të certifikatave, vulave dhe shenjave për mbrojtjen e të dhënave personale;

(ç) kanë vendosur procedura dhe struktura për veprimin sipas kundërshtimeve për shkelje të certifikimit ose për mënyrën në të cilën certifikimi ishte kryer ose zbatohet nga kontrollori ose përpunuesi dhe ato janë transparente në lidhje me subjektet e të dhënave personale dhe publikun;

(d) Institutit në masë të mjaftueshme i kanë dëshmuar se detyrat dhe punët e tyre nuk çojnë në konflikt të interesave.

(3) Akreditimi i trupave të certifikimit nga paragrafi (1) i këtij neni kryhet në bazë të standardeve dhe normativave të përcaktuara nga drejtori i Agjencisë.

(4) Trupat e certifikimit nga paragrafi (1) i këtij neni janë përgjegjës për vlerësimin përkatës, që çon në certifikimin ose në tërheqjen e certifikatës së lëshuar, pa u përjashtuar përgjegjësia e kontrollorit ose përpunuesit për harmonizimin me këtë ligj. Akreditimi lëshohet për periudhë jo më të gjatë se pesë vjet dhe mund të rinovohet me të njëjtat kushte nëse trupi i certifikimit edhe më tutje i përmbushë kërkesat e përcaktuara në këtë nen.

(5) Trupat e certifikimit nga paragrafi (1) i këtij neni Agjencisë i dorëzojnë të dhënat e kërkuara dhe / ose dokumentet së bashku me arsyet e lëshimit ose tërheqjes së certifikatës së kërkuar.

(6) Institutit e tërheq akreditimin e trupit të certifikimit nga paragrafi (1) të këtij neni, nëse nuk respektohen ose më nuk përmbushen kushtet e akreditimit, ose nëse aktivitetet të cilat zbatohen nga trupi e shkelin këtë ligj.

(7) Standardet teknike për mekanizmat e certifikimit dhe për vulat dhe shenjat për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe mekanizmat për promovimin dhe njohjen e atyre mekanizmave të certifikimit, vulat dhe shenjat i përcakton drejtori i Agjencisë.

(8) Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe gjatë certifikimit të trupave për zbatimin e trajnimeve në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

V. BARTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

Parimi i përgjithshëm për bartje

Neni 48

(1) Çdo transferim i të dhënave personale që i nënshtrohen përpunimit ose janë të dedikuara për përpunim në vende të tretë ose në organizatë ndërkombëtare mund të kryhet vetëm nëse kushtet e përcaktuara në këtë ligj janë përmbushur dhe zbatohen nga ana e kontrollorit dhe përpunuesi, duke përfshirë transferimin e mëtejshëm të të dhënave personale nga vend i tretë ose organizatë ndërkombëtare nga vend tjetër i tretë ose organizatë ndërkombëtare. Dispozitat e këtij kapitulli do të zbatohen që të sigurohen se nuk do të rrezikohet niveli i mbrojtjes së personave fizik të garantuar me këtë ligj.

(2) Dispozitat e këtij kapitulli nuk do të zbatohen për transferimin e të dhënave personale nga paragrafi (1) të këtij neni nga Republika e Maqedonisë së Veriut në vend anëtar të Bashkimit Evropian ose Zonës Ekonomike Evropiane.

(3) Në rast të transferimit të të dhënave personale në vend anëtar të Bashkimit Evropian, përkatësisht shtetit anëtar i Zonës Ekonomike Evropiane, kontrollori ose përpunuesi është i detyruar të informojë Agjencinë.

Bartja e të dhënave personale në bazë të vendimit për përshtatshmëri

Neni 49

(1) Bartja e të dhënave personale në shtet të tretë ose organizatë ndërkombëtare mund të bëhet kur Agjencia do të përcaktojë se shtete të treta ose organizata ndërkombëtare siguron nivel të duhur të mbrojtjes.

(2) Gjatë vlerësimit të përshtatshmërisë të nivelit të mbrojtjes, Agjencia i merr parasysh veçanërisht elementet si vijojnë:

(a) sundimi i së drejtës, respektimi i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, legjislacioni relativ, si i përgjithshëm ashtu edhe sektorial, duke përfshirë sigurinë publike, mbrojtjen, sigurinë kombëtare dhe të drejtën penale, dhe qasjen e organeve publike në të dhënat personale, kurse gjithashtu edhe zbatimi i legjislacionit i tillë, rregullat e mbrojtjes të të dhënave personale, rregullat profesionale dhe masat e sigurisë, duke përfshirë edhe rregullat për transferim të mëtejshëm të të dhënave personale në vend tjetër të tretë ose organizatë ndërkombëtare, të cilat respektohen në atë vend ose organizatë ndërkombëtare, praktikë gjyqësore, si dhe vendime të plotfuqishme dhe ekzekutive të cilat zbatohen për subjektet e të dhënave personale dhe mbrojtje efektive administrative dhe gjyqësore për subjektet e të dhënave personale, kurse të dhënat personale barten;

(b) ekzistimi dhe funksionimi efikas i një ose më shumë organeve të pavarura mbikëqyrëse për mbrojtjen e të dhënave personale në vendin e tretë të interesuar ose trupa që i nënshtrohet një organizate ndërkombëtare, kurse janë përgjegjëse për sigurimin dhe zbatimin e rregullave për

mbrojtjen e të dhënave personale, duke përfshirë autorizimet e duhura për zbatim, për ndihmë dhe këshilla të subjekteve të të dhënave personale gjatë realizimit të të dhënave personale gjatë realizimit të të drejtave të tyre, si dhe për bashkëpunim me Agjencinë dhe

(c) detyrimet ndërkombëtare të cilat merren nga vende të treta ose organizatë ndërkombëtare, ose detyrime të tjera që rrjedhin nga konventat detyruese juridike ose instrumentet, si dhe pjesëmarrja e saj në sistemet shumëpalëshe ose rajonale, veçanërisht në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale.

(3) Nëse vendi i tretë ose organizatë ndërkombëtare, në të cilën duhet të transferohen të dhënat personale, sigurohet shkallë e përshtatshme e mbrojtjes të të dhënave personale nga paragrafi (2) të këtij neni, atëherë kontrollori ose përpunuesi mund të kryejë bartje të të dhënave personale në bazë të vendimit në pajtueshmërinë nga ana e Agjencisë.

(4) Nëse vendi i tretë ose organizata ndërkombëtare, në të cilën do të transferohen të dhënat, nuk sigurojnë shkallë të duhur të mbrojtjes të të dhënave personale, kontrollori ose përpunuesi nuk e kryen bartjen e të dhënave personale.

Bartja e të dhënave të cilat i nënshtrohen masave mbrojtëse

Neni 50

(1) Në rastet kur nuk është sjellë vendim nga neni 49 paragrafi (3) të këtij ligji, kontrollori ose përpunuesi mund të transferojë të dhëna personale në vend të tretë ose organizatë ndërkombëtare vetëm nëse kontrollori ose përpunuesi ka siguruar masat e duhura mbrojtëse dhe me kusht që subjektet e të dhënave personale të kenë mbrojtje gjyqësore të zbatueshme dhe të arritshme.

(2) Kur nuk është sjellë vendim nga neni 49 paragrafi (3) të këtij ligji, masat mbrojtëse adekuate në paragrafin (1) të këtij neni, pa kërkuar miratimin paraprak të Agjencisë, mund të parashihen, përmes:

(a) instrumenteve juridik obligues dhe ekzekutiv mes organeve publike ose trupa;

(b) rregullat korporatave të detyrueshme në pajtim me nenin 51 të këtij ligji;

(c) klauzola standarde për mbrojtjen e të dhënave personale të cilat i përcakton Agjencia ose janë miratuar nga ana e Komisionit Evropian;

(ç) kodeksi i sjelljes të aprovuar, në përputhje me nenin 44 të këtij ligji, së bashku me detyrimet obliguese dhe ekzekutive të kontrollorit ose përpunuesit në shtetin e tretë për të zbatuar masat mbrojtëse të përshtatshme, duke përfshirë edhe në lidhje me të drejtat e subjekteve të të dhënave personale ose

(d) mekanizëm mbrojtës për certifikim, në përputhje me nenin 46 të këtij ligji, së bashku me detyrimet obliguese dhe ekzekutive të kontrollorit ose përpunuesit në shtetin e tretë për të zbatuar masat mbrojtëse të përshtatshme, duke përfshirë edhe në lidhje me të drejtat e subjekteve të të dhënave personale.

(3) Me kusht të kërkohet leje nga ana e Agjencisë, masa mbrojtëse adekuate nga paragrafi (1) të këtij neni, gjithashtu, mund të parashihen, në veçanti përmes:

(a) klauzolës kontraktuese mes kontrollorit ose përpunuesit, si dhe kontrollori, përpunuesi ose shfrytëzuesi i të dhënave personale në shtete të treta ose në organizatat ndërkombëtare; ose

(b) dispozitave që duhen parashikuar në marrëveshjet administrative mes organeve publike ose trupa, kurse përmbajnë të drejta të zbatueshme dhe efektive të subjekteve të të dhënave personale.

Bartja e të dhënave personale në bazë të rregullave korporative të detyrueshme

Neni 51

(1) Agjencia miraton rregulla korporatave të detyrueshme, me kusht nëse ato:

(a) janë juridikisht të detyrueshme dhe zbatohen për çdo anëtar të interesuar të grupit të caktuar të personave juridikë ose të grupit të personave juridikë që kryejnë veprimtari të përbashkët ekonomike, duke i përfshirë të punësuarit e tyre, kurse të cilat ata i zbatojnë;

(b) qartë sigurojnë të drejta të zbatueshme për subjektet e të dhënave personale në lidhje me përpunimin e të dhënave të tyre personale; dhe

(c) i plotësojnë kushtet e përcaktuara nga paragrafi (2) i këtij neni.

(2) Detyrimisht të drejtat korporative nga paragrafi (1) i këtij neni e përcaktojnë së paku:

(a) strukturën dhe kontaktin e të dhënave të grupit të personave juridikë ose të grupit të personave juridikë të cilët kryejnë veprimtari të përbashkët ekonomike, si dhe të çdo anëtar;

(b) bartjen e të dhënave personale ose serisë së bartjeve, përfshirë kategoritë e të dhënave personale, llojin e përpunimit dhe qëllimet e tij, llojin e subjekteve të të dhënave personale në fjalë dhe identifikimin e vendit të tretë ose vendeve në të cilat do të kryhet bartja;

(c) karakterin e tyre të detyrueshëm juridik, si në nivel të brendshëm ashtu edhe të jashtëm;

(ç) zbatimin e parimeve të përgjithshme për mbrojtjen e të dhënave personale, në veçanti kufizimin e qëllimeve, vëllimin minimal të të dhënave, kufizimin e kohës së ruajtjes, kualitetin e të dhënave, mbrojtjen teknike dhe të integruar të të dhënave personale, bazën juridike për përpunimin, përpunimin e kategorive të veçanta të të dhënave personale, masat për të siguruar sigurinë e të dhënave personale, si dhe kërkesat në lidhje me transferimin e mëtejshëm të të dhënave personale të subjektet tjera që nuk janë të detyruara nga rregullat e detyrueshme korporative;

(d) të drejtat e subjekteve të të dhënave për përpunimin dhe mjetet e realizimit të këtyre të drejtave, duke përfshirë të drejtën e subjektit të të dhënave personale të mos jetë vetëm lëndë e miratimit automatik i vendimeve individuale, duke përfshirë profilizimin në përputhje me nenin 26 nga ky ligj, të drejtën e paraqitjes të kërkesës në Agjenci dhe gjykatat kompetente në përputhje me ligjin, si dhe të drejtën për mbrojtje gjyqësore dhe kur është e zbatueshme, të drejtën e kompensimit për shkeljen e rregullave të detyrueshme korporative;

(dh) pranimin e përgjegjësisë së kontrolluesit ose përpunuesit të themeluar në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për çdo shkelje të rregullave të detyrueshme korporative të ndonjë anëtarit të grupit të prekur, që nuk është themeluar në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Kontrolluesi ose përpunuesi lirohet tërësisht ose pjesërisht nga ky detyrim vetëm nëse vërteton se anëtarit i grupit të prekur nuk ka përgjegjësi për ngjarjen që ka sjell në shkaktimin e dëmit;

(e) mënyrën në të cilën informacionet mbi rregullat e detyrueshme korporative u jepen subjekteve të të dhënave personale, veçanërisht në lidhje me dispozitat e pikave (g), (d) dhe (gj) të këtij paragrafi, kurse përveç informacioneve nga nenet 17 dhe 18 të këtij ligji;

(ë) punët e çdo oficeri për mbrojtjen e të dhënave personale të përcaktuara në përputhje me nenin 41 të këtij ligji, ose çdo personi ose organi tjetër përgjegjës për monitorimin e harmonizimit me rregullat e detyrueshme korporative në suaza të grupit të personave juridikë ose grupit të personave juridikë që kryejnë aktivitetit ekonomik të përbashkët, si dhe ndjekjen e trajnimit dhe zgjidhjen e ankesave;

(f) procedurat në lidhje me vendosjen e ankesave;

(g) mekanizmat në suaza të grupit të personave juridikë ose grupit të personave juridikë që kryejnë veprimtari të përbashkët ekonomike për sigurimin e harmonizimit me rregullat të detyrueshme korporative. Këto mekanizma përfshijnë revizion të mbrojtjes së të dhënave personale dhe metodat e sigurimit të aktiviteteve korigjuese për të mbrojtur të drejtat e subjektit të të dhënave personale. Rezultatet e këtij kontrolli duhet t'i dorëzohen personit ose trupit nga

pika (zh) e këtij paragrafi dhe strukturave më të larta drejtuese të personit juridik me pozitë mbizotëruese në suaza të grupit të personave juridikë ose grupit të personave juridikë që kryejnë veprimtari të përbashkët ekonomike, si dhe të jenë në dispozicion me kërkesë të Agjencisë;

(gj) mekanizmat për raportimin dhe mbajtjen e evidencës për ndryshimet në rregulla dhe për njoftimin e Agjencisë për ndryshime të tilla;

(h) mekanizmat për bashkëpunimin me Agjencinë për të siguruar harmonizim të çdo anëtari të grupit të personave juridikë ose të grupit të personave juridikë që kryejnë veprimtari të përbashkët ekonomike, në veçanti përmes sigurimit të Agjencisë rezultatet e kontroleve të masave nga pika (x) të këtij paragrafi ;

(i) mekanizmat për njoftim të Agjencisë për të gjithë kërkesat ligjore që lidhen me anëtar të grupit të personave juridikë ose të grupit të personave juridikë që kryejnë një veprimtari të përbashkët ekonomike, të cilat zbatohen në vend të tretë, kurse sigurisht do të shkaktojnë dëme të konsiderueshme për të garantuar masa të siguruar me rregulla të detyrueshme korporative dhe

(j) trajnim adekuat për mbrojtjen e të dhënave personale për personelin që kanë qasje të përhershme ose të rregullt në të dhënat personale.

Bartja ose zbulimi i të dhënave personale të bazuar në marrëveshje ndërkombëtare

Neni 52

Çdo vendim gjyqësor ose çdo vendim i marrë nga organ administrativ i vendit të tretë që kërkon nga kontrollori ose përpunuesi të bartin ose të zbulojnë të dhëna personale mund të njihet ose t'i nënshtrohet zbatimit në çfarëdo mënyre, vetëm nëse bazohet në marrëveshje ndërkombëtare, siç është marrëveshja e ndërsjellë ndërkombëtare për ndihmë juridike, që është në fuqi midis vendeve të treta e cila e ka parashtruar kërkesën edhe Republikës së Maqedonisë së Veriut pa marrë parasysh dispozitat për bartjen e të dhënave personale të përcaktuara në këtë Kapitull.

Shmangia për situata specifike

Neni 53

(1) Nëse nuk ekziston vendim për përshtatshmëri në pajtim me nenin 49 paragrafin (3) të këtij ligji ose masa mbrojtëse përkatëse në pajtim me nenin 50 të këtij ligji, të cilat përfshijnë rregulla të detyrueshme korporative, transferimin ose serinë e transferimeve të të dhënave personale në vend të tretë ose në organizatë ndërkombëtare mund të kryhet vetëm nëse është plotësuar një nga kushtet si vijojnë:

(a) subjekti i të dhënave personale ka dhënë pajtim në mënyrë të qartë për kontrolluesin e transmetimit të propozuar pasi të jetë informuar për rreziqet e mundshme për transferim të tillë për subjektin e të dhënave personale kurse për shkak të mosekzistimit të vendimit për përputhshmëri dhe të masave mbrojtëse të përshtatshme;

(b) transferimi është i nevojshëm për shkak të marrëveshjes ndërmjet subjektit të të dhënave personale dhe kontrolluesit ose për zbatimin e masave parakontraktuese të cilat janë marrë me kërkesën e subjektit të të dhënave personale;

(c) transferimi është i domosdoshëm për lidhje ose kryerjen e marrëveshjes ndërmjet kontrolluesit dhe personit tjetër fizik ose juridik, kurse në interes të subjektit të të dhënave personale;

(ç) bartja është e domosdoshme për shkak të arsyeve të rëndësishme me interes publik;

(d) bartja është e domosdoshme për vendosje, realizim ose mbrojtje të kërkesave juridike;

(dh) transferimi është i domosdoshëm me qëllim që të mbrohen interesat thelbësore të subjektit të të dhënave personale ose të personave të tjerë kur subjekti i të dhënave personale është i paaftë fizikisht ose i është marrë aftësia afariste për të dhënë pëlqimin;

(e) transferimi kryhet nga regjistër i cili sipas ligjit ka për qëllim, të sigurojë informacione për publikun dhe i cili është i hapur për konsultime me publikun ose për cilindo person që mund të provojë interes legjitim, por vetëm deri në atë shkallë në të cilën kushtet e përcaktuara me ligj janë plotësuar me konsultime në rast të veçantë.

Kur transferimi nuk mund të bazohet në dispozitat nga e nenet 49 ose 50 të këtij ligji, përfshirë edhe dispozitat për rregullat e detyrueshme korporative dhe asnjë prej përjashtimeve për situatë specifike nga nënparagrafi i parë të këtij paragrafi është e pa zbatueshme, transferimi në vend të tretë ose organizatë ndërkombëtare, mund të kryhet vetëm nëse transferimi nuk është përsëritës, dhe ka të bëjë vetëm për numër të kufizuar të subjekteve të të dhënave personale, kurse i njëjti është i nevojshëm për plotësimin e interesit legjitim të kontrolluesit mbi të cilin nuk mbisundojnë interesat e kontrolluesit ose të drejtat dhe liritë e subjektit të të dhënave personale, gjatë së cilës kontrolluesi i ka vlerësuar të gjitha rrethanat në lidhje me transferimin e të dhënave personale dhe në bazë të këtij vlerësimi ka siguruar masa mbrojtëse adekuatë në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale. Kontrolluesi është i detyruar të informojë Agjencinë për transferimin e të dhënave personale. Krahas informacionevei nga nenet 17 dhe 18 të këtij ligji, kontrollori e informon gjithashtu subjektin e të dhënave personale për transferimin e të dhënave personale dhe për përmbushjen e interesave të tij legjitime.

(2) Transferimi sipas pikës (e) të nënparagrafit të parë të paragrafit (1) të këtij neni, nuk duhet të përfshijë të gjitha të dhënat personale ose të gjitha kategoritë e të dhënave personale të përfshira në regjistër. Në rast kur regjistri shërben për konsultim nga personat që kanë interes legjitim, transferimi mund të bëhet vetëm me kërkesë të personave të tillë ose nëse ata do të ishin përdorues.

(3) Pikat (a), (b) dhe (v) nga nënparagrafi i parë i paragrafit (1) të këtij neni dhe nënparagrafit të dytë të paragrafit (1) të këtij neni nuk zbatohen për aktivitetet e kryera nga organet shtetërore dhe organet tjera shtetërore gjatë kryerjes së autorizimeve të tyre publike të parashikuara me ligj.

(4) Interesi publik i theksuar në pikën (g) të nënparagrafit të parë të paragrafit (1) të këtij neni duhet të njihet me ligj, kurse të zbatohet në lidhje me kontrolluesin e prekur.

(5) Në rast kur nuk ekziston vendim për përshtatshmëri, për arsye të interesit publik, me ligji mund të përcaktohet kufizim për transferimin e kategorive specifike të të dhënave personale në vend të tretë ose në organizatë ndërkombëtare.

(6) Kontrolluesi ose përpunuesi janë të detyruar të dokumentojnë vlerësimin, si dhe masat mbrojtëse përkatëse nga nënparagrafi i dytë i paragrafit (1) të këtij neni, në evidencën e përcaktuar në nenin 34 të këtij ligji.

Bashkëpunimi ndërkombëtar për mbrojtjen e të dhënave personale

Neni 54

Në lidhje me vendet e treta dhe organizatat ndërkombëtare, Agjencia do të marrë masat e duhura për:

(a) zhvillimin e mekanizmave për bashkëpunim ndërkombëtar për të lehtësuar zbatimin efektiv të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale;

(b) sigurimin e ndihmës juridike ndërkombëtare në zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, që përfshin raportimin, paraqitjen e parashtresave, ndihmën e hetimit dhe shkëmbimin e informacioneve, në përputhje me masat mbrojtëse të përshtatshme për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtave dhe lirive fundamentale;

(c) përfshirjen e palëve të interesuara përkatëse në diskutime dhe aktivitete që synojnë thellimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale;

(ç) promovimin e shkëmbimit dhe dokumentimit të legjislacionit dhe praktikave për mbrojtjen e të dhënave personale, duke përfshirë edhe ndeshjen e kompetencave me vendet e treta.

Vendimmarrja e Agjencisë

Neni 55

(1) Për rastet nga neni 49 paragrafi (3), neni 50 paragrafi (3) dhe neni 51 të këtij ligji, Agjencia vendos në afat prej 90 ditëve nga dita e pranimit të kërkesës.

(2) Kundër vendimit të Agjencisë nga paragrafi (1) të këtij ligji mund të paraqitet padi për ngritjen e kontestit administrativ te gjykata kompetente në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit.

Aktet nënligjore të Agjencisë

Neni 56

Mënyra e njoftimit për transferim të të dhënave personale në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe shtetet anëtare të Zonës Ekonomike Evropiane, formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës për marrjen e autorizimit për transferim në rastet nga neni 49 paragrafi (3), neni 50 paragrafi (3) dhe neni 51 të këtij ligji, si dhe formën dhe përmbajtjen e formularit për regjistrimet e transferimit të të dhënave personale në vendet e treta dhe organizatat ndërkombëtare, Bashkimin Evropian dhe hapësirën ekonomike evropiane, si dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrave i përcakton drejtori i Agjencisë.

VI. AGJENCIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

1. Statusi i pavarur

Trupi mbikëqyrës

Neni 57

(1) Agjencia është organ shtetëror i pavarur dhe i mëvetësishëm, kompetent për kryerjen e mbikëqyrjes mbi ligjshmërinë e aktiviteteve të ndërmarra në përpunimin e të dhënave personale në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të personave fizikë, në lidhje me përpunimin e të dhënave të tyre personale.

(2) Agjencia për punën e saj përgjigjet para Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(3) Agjencia ka cilësinë e personit juridik.

(4) Selia e Agjencinë është në Shkup.

(5) Agjencia ka një shërbim profesional që kryen punë profesionale, normative-juridike, administrative, administrative-mbikëqyrëse, supervizore, materiale-financiare, kontabilitetit, informacionit dhe çështje të tjera në kompetencën e Agjencisë (në tekstin në vijim: Shërbimi profesional).

(6) Me shërbimin profesional udhëheq sekretari i përgjithshëm.

Pavarësia

Neni 58

(1) Agjencia do të jetë plotësisht e pavarur politikisht, financiare dhe funksionale në kryerjen e kompetencave, detyrave dhe autorizimeve të saj në përputhje me këtë ligj.

(2) Drejtori, zëvendësdrejtori dhe të punësuarit në Agjenci nuk guxojnë të marrin dhe të kërkojnë udhëzime nga organet e pushtetit qendror, organet komunale, organet e qytetit të Shkupit dhe personat e tjerë juridikë dhe/ose fizikë.

(3) Drejtori, zëvendësdrejtori dhe të punësuarit në Agjenci në kryerjen e funksioneve dhe detyrave të tyre janë të detyruar të kenë kujdes të konfliktit eventual të interesave dhe gjatë kryerjes së autorizimeve publike nuk guxojnë të udhëhiqen nga lidhjet personale, familjare, fetare, partiake dhe etnike, as nga presionet apo premtimet e eprorit ose të personit tjetër.

(4) Pavarësia e Agjencisë duhet të respektohet në çdo kohë dhe askush nga organet dhe/ose personat nga paragrafi (2) i këtij neni nuk mund të ndikojnë te drejtori, zëvendësdrejtori dhe të punësuarit në Agjenci gjatë kryerjes së funksioneve përkatësisht punëve të tyre, as të kompetencave të Agjencisë.

(5) Drejtori, zëvendësdrejtori dhe të punësuarit në Agjenci gjatë kryerjes së detyrave të tyre të punës dhe/ose gjatë vendimmarrjes janë të detyruar të:

1) të veprojnë në mënyrë profesionale, të paanshme, objektive dhe pa ndikimin e kontrolluesve dhe përpunuesve, si dhe çdo palë tjetër të interesuar;

2) nuk udhëhiqen nga interesa personale, afariste dhe financiare;

3) nuk i keqpërdorin autorizimet dhe statusin që e kanë në Agjenci ose si të punësuar në Agjenci; dhe

4) e mbrojnë reputacionin e Agjencisë.

Drejtori dhe zëvendësdrejtori

Neni 59

(1) Me Agjencinë udhëheq drejtori, i cili zgjidhet dhe shkarkohet nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut me propozim të Komisionit për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërimeve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejme: Komisioni).

(2) Për zgjedhjen e drejtorit shpallet konkurs publik në të paktën dy gazeta ditore, të cilat publikohen në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, njëra prej të cilave që botohet në gjuhë të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve që flasin gjuhë zyrtare, të ndryshme nga gjuha maqedonase.

(3) Drejtori i Agjencisë zgjidhet për kohë prej pesë vitesh, me të drejtë për edhe një mandat.

(4) Drejtori i Agjencisë ka zëvendës që e zgjedh dhe shkarkon Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut me propozim të Komisionit për kohë prej pesë vitesh, me të drejtën për edhe një mandat.

(5) Për zgjedhjen e zëvendësdrejtorit shpallet konkurs publik në të paktën dy gazeta ditore, të cilat publikohen në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, njëra prej të cilave që botohet në gjuhë të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve që flasin gjuhë zyrtare, të ndryshme nga gjuha maqedonase.

(6) Komisioni është i detyruar të kontrollojë nëse kandidatët që janë paraqitur në konkursin publik për drejtor respektivisht zëvendësdrejtor i plotësojnë kushtet për paraqitjen në konkurs publik të përcaktuar me këtë ligj.

(7) Komisioni është i detyruar në afat prej një muaji pas përfundimit të skonskursit publik të organizojë debat publik për kandidatët për drejtor respektivisht zëvendësdrejtor që i plotësojnë kushtet e përcaktuara në këtë ligj.

(8) Pas përfundimit të debatit publik, Komisioni përpilon propozim listë të kandidatëve për drejtor respektivisht zëvendës drejtor. Për propozim listën përfundimtare të kandidatëve për drejtor respektivisht zëvendës drejtor, Komisioni vendos në përputhje me Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(9) Zëvendës drejtori e zëvendëson drejtorin e Agjencisë në rast kur ai mungon ose nuk është në gjendje të kryejë funksionin e tij për shkak të sëmundjes ose për arsye të tjera, me të gjitha kompetencat dhe përgjegjësitë e tij në menaxhim.

(10) Zëvendës drejtori në bashkëpunim me drejtorin e Agjencisë, kryejnë punë në fushëveprimin e punës së drejtorit të Agjencisë që ai do t'ia besojë.

(11) Për punën e tyre dhe punën e Agjencisë drejtori dhe zëvendës drejtori japin llogari para Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Kushtet për zgjedhje dhe shkarkim

Neni 60

(1) Drejtor mund të zgjidhet personi i cili i plotëson këto kushte:

- 1) është shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- 2) në momentin e zgjedhjes me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtës ndalim për ushtrim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- 3) të ketë fituar më së paku 240 kredi sipas EKTS-së ose shkallën VII/1 të përfunduar të shkencave juridike;
- 4) nuk është anëtar i organi të partisë politike;
- 5) të ketë së paku 10 vjet përvojë pune pas përfundimit të arsimit të lartë;
- 6) të ketë së paku pesë vjet përvojë pune, si dhe kualifikime personale dhe aftësi në sferën e mbrojtjes së të dhënave personale;
- 7) posedon certifikatë për njohje të programeve kompjuterike për punë në zyrë; dhe
- 8) posedon një nga certifikatat e pranuar ndërkombëtare dhe vërtetime për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet, si vijon:
 - TOEFELL IBT së paku 74 pikë;
 - IELLS (IELTS) së paku 6 pikë;
 - ILLEC (ILEC) (Cambridge English: Legal) së paku nivelin B2 (B2) , – FCE (FCE) (Cambridge English: First) – të dhënë;
 - BULLATS (BULATS) së paku 60 pikë; ose
 - APTIS (APTIS) së paku nivelin B2 (B2).

(2) Zëvendës drejtori Agjencisë mund të zgjidhet personi i cili i plotëson kushtet e theksuara në paragrafin (1) të këtij neni.

(3) Drejtorit, përkatësisht zëvendës drejtorit, i pushon funksioni para përfundimit të mandatit, në këto raste:

- nëse parashtron dorëheqje;
- nëse në mënyrë të përhershme e humb aftësinë për ushtrim të funksionit, që e konstaton Kuvendi i Republikës së Maqedonisë;
- nëse i plotëson kushtet për pension të moshës;
- nëse ndodh vdekje;
- nëse është zgjedhur ose emëruar në funksion tjetër publik; ose
- nëse është i shkarkuar nga funksioni para përfundimit të mandatit.

(4) Drejtori, përkatësisht zëvendës drejtori mund të shkarkohet para përfundimit të mandatit vetëm në këto raste:

- në kërkesë të tij;

- nëse është i gjykuar me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor për vepër penale dënim me burg pa kusht në kohëzgjatje prej së paku gjashtë muajsh;

- për shkak të keqpërdorimit të të dhënave personale gjë që e konstaton Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut; dhe

- kur do të pushojë te plotësojë cilin do nga kushtet e theksuara në paragrafin (1) alinetë 1, 2 dhe 4 të këtij neni gjë që e konstaton Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(5) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut në rastet nga paragrafët (3) dhe (4) të këtij neni konstaton pushim të funksionit.

(6) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut e shkarkon drejtorin, përkatësisht zëvendësdrejtorin e Agjencisë pas propozimi të Komisionit, nëse është plotësuar një nga këto kushte:

- përcaktohet se nuk i plotëson kushtet nga paragrafi (1) i këtij neni;

- pa arsye ka munguar nga puna e Agjencisë më gjatë se gjashtë muaj;

- për shkak të keqpërdorimit të të dhënave personale; ose

- qartë i ka shkelur rregullat për konflikt interesi, përkatësisht tërheqje në situata në të cilat drejtori, përkatësisht zëvendësdrejtori e ka ditur ose është dashur të dijë për ekzistim të ndonjëres nga bazat për konflikt interesi, përkatësisht përjashtimi të parapara me ligj.

(7) Në rast të pushimit të funksionit ose shkarkimit të drejtorit të Agjencisë, deri në zgjedhje të drejtorit të ri të Agjencisë, funksionin e drejtorit të Agjencisë e ushtron zëvendësdrejtori i Agjencisë, me të gjitha të drejtat, detyrat dhe autorizimet të cilat i ka pasur drejtori.

(8) Në rast të shkarkimit, përkatësisht pushimit të funksionit të drejtorit, përkatësisht zëvendësdrejtorit të Agjencisë para përfundimit të mandatit, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut më së voni në afat prej dhjetë ditësh fillon procedurë për zgjedhje të drejtorit të ri, përkatësisht zëvendësdrejtorit të Agjencisë.

Deklarata solemne

Neni 61

Para hyrjes në funksion, drejtori, përkatësisht zëvendësdrejtori, para kryetarit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut jep dhe nënshkruan deklaratë solemne, si vijon:

"Deklarojë se funksionin drejtor, përkatësisht zëvendësdrejtor do ta kryej me ndërgjegje, në mënyrë të paanshme dhe me përgjegjësi, do ta mbroj të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe do të përmbahem në Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Maqedonisë së Veriut".

Mosbashkimi i funksionit dhe besueshmërisë

Neni 62

(1) Funksioni drejtor, përkatësisht funksioni zëvendësdrejtor, është i pabashkueshëm me ushtrimin e funksioneve ose profesioneve të tjera publike, si dhe me ushtrimin e funksionit në parti politike ose vend pune.

(2) Drejtori dhe zëvendësdrejtori janë të obliguar t'i ruajnë si sekret të dhënat të cilat kanë ardhur në punën e tyre, si gjatë mandatit, ashtu edhe pas përfundimit të tij, ndërsa të cilat paraqesin të dhëna personale ose informata të klasifikuara në pajtim me ligj. Drejtori dhe zëvendësdrejtori janë të obliguar t'i ruajnë si sekret veçanërisht njoftimet nga personat fizikë të cilat kanë të bëjnë me shkeljen e dispozitave të këtij ligji.

Fushëveprimi i punës së drejtorit të Agjencisë

Neni 63

(1) Drejtori i Agjencisë:

- e prezanton dhe përfaqëson Agjencinë para organeve kompetente, përveç për të drejtat pronësore dhe interesa për të cilat para gjykatave dhe organeve tjera e përfaqëson Prokuroria shtetërore e Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- i ndërmerr të gjitha veprimet juridike në emër dhe në llogari të Agjencisë,
- organizon dhe siguron ushtrim ligjor, efektiv dhe efikas të punëve dhe detyrave në Agjenci,
- vendos për të drejtat dhe detyrimet e të punësuarve në Agjenci në pajtim me ligj,
- i miraton aktet për organizim dhe sistematizim të brendshëm të vendeve të punës të Agjencisë,
- miraton dokumente financiare, përkatësisht dokumente strategjike dhe program vjetor për punë të Agjencisë, si dhe e organizon zbatimin e tyre,
- miraton aktvendime në pajtim me ligj;
- miraton rregulla dhe akte të tjera për të cilat është e autorizuar në pajtim me ligj,
- kujdeset për transparencën e punës së Agjencisë, dhe
- ushtron pune të tjera me kompetencë të Agjencisë në pajtim me ligj.

(2) Aktet nënligjore, të cilat i miraton drejtori i Agjencisë botohen në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

2. Kompetencat, detyrat dhe autorizimet e Agjencisë

Kompetenca

Neni 64

(1) Agjencia është kompetente për ushtrimin e detyrave dhe të autorizimeve të ndara në pajtim me këtë ligj.

(2) Agjencia nuk është kompetente të ushtrojë mbikëqyrje mbi gjykatat të cilat veprojnë në korniza të funksioneve të tyre gjyqësore, përveç për mbikëqyrje mbi ligjshmërinë e aktiviteteve të ndërmarra gjatë përpunimit tjetër të të dhënave personale e cila bëhet nga gjykatat në pajtim me ligj.

Detyra

Neni 65

(1) Pa u vënë në pikëpyetje detyrat të tjera të përcaktuara me këtë ligj, në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Agjencia:

- (a) e ndjek dhe zbaton zbatimin e këtij ligji;
- (b) e promovon vetëdijen publike dhe pikëpamjen e rreziqeve, rregullat, masat mbrojtëse dhe të drejtat në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, ndërsa veçanërisht të aktiviteteve të cilat janë drejtuar ndaj fëmijëve;
- (c) në pajtim me ligj, i jep mendime Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe institucioneve dhe trupave të tjera për masat ligjvënëse dhe administrative për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale;

(ç) e promovon vetëdijen e kontrolluesve dhe përpunuesve për detyrimet e tyre sipas këtij ligji;

(d) me kërkesë, i siguron informata çdo subjekti të të dhënave personale në lidhje me realizimin e të drejtave të tij sipas këtij ligji dhe nëse është e nevojshme, për atë qëllim bashkëpunon me organe tjera mbikëqyrëse për mbrojtje të të dhënave personale;

(dh) i shqyrton kërkesat e parashtruara nga subjekti i të dhënave personale ose nga shoqata në pajtim me këtë ligj dhe e hulumton me masë adekuate lëndën e kërkesës, si dhe në afat të arsyeshëm e informon parashtruesin e kërkesës për rezultatin e procedurës, veçanërisht nëse është e nevojshme hulumtim plotësues ose koordinim me organ tjetër mbikëqyrës për mbrojtje të të dhënave personale;

(e) bashkëpunon me organe tjera mbikëqyrëse për mbrojtjen e të dhënave personale, duke përfshirë edhe nëpërmjet këmbimit të informatave dhe ndihmës së ndërsjellë, me qëllim që të sigurohet mbrojtje e të drejtave dhe lirive të personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale;

(ë) zbaton hulumtim në lidhje me zbatimin e këtij ligji, duke përfshirë edhe në bazë të informatave të mara nga organ tjetër mbikëqyrës për mbrojtjen e të dhënave personale ose organ tjetër publik;

(f) e përcjell zhvillimin adekuat, veçanërisht në sferën e teknologjisë informatike dhe të komunikimit dhe praktikat tregtare, nëse ajo ndikon në mbrojtjen e të dhënave personale;

(g) miraton klauzola kontraktuese standarde të theksuara në nenin 32 paragrafin (7) dhe nenin 50 paragrafin (2) pikën (c) të këtij ligji;

(gj) vendos dhe mban listë në lidhje me kërkesën për vlerësim të ndikimit të mbrojtjes së të dhënave personale në pajtim me nenin 39 paragrafi (4) të këtij ligji;

(j) jep mendim për operacionet për përpunim të të dhënave personale të theksuara në nenin 40 paragrafin (2) të këtij ligji;

(h) e nxit përpilimin e kodekseve të sjelljes në pajtim me nenin 44 të këtij ligji, si dhe jep mendime dhe lejon kodeks të sjelljes të cilat sigurojnë masa adekuate të mbrojtjes në pajtim me nenin 44 paragrafin (3) të këtij ligji.

(i) e nxit krijimin e mekanizmave për certifikim për mbrojtje të të dhënave personale dhe të vulave dhe shenjave për mbrojtje të të dhënave personale në pajtim me nenin 46 të këtij ligji;

(j) kur është e zbatueshme, ushtron rikontrollim periodik të certifikatave të lëshuara në pajtim me nenin 46 paragrafin (6) të këtij ligji;

(k) i shpall standardet dhe normativat për akreditim të trupit për monitoring të kodekseve të lejuara të sjelljes në pajtim me nenin 45 të këtij ligji dhe të trupit certifikues në pajtim me nenin 47 të këtij ligji;

(l) ushtron akreditim të trupit për monitoring të kodekseve të lejuara të sjelljes në pajtim me nenin 45 të këtij ligji;

(ll) jep leje për klauzolat kontraktuese dhe dispozita të theksuara në nenin 50 paragrafin (3) të këtij ligji;

(m) i lejon rregullat e obligueshme korporative në pajtim me nenin 51 të këtij ligji;

(n) vendos dhe mban evidencë të prishjeve të këtij ligji, si dhe të masave të ndërmarra në pajtim me nenin 66 paragrafin (2) të këtij ligji,

(nj) kryen trajnim për mbrojtje të të dhënave personale, dhe

(o) kryen edhe detyra të tjera të lidhura me mbrojtjen e të dhënave personale, në pajtim me ligj.

(2) Agjencia e lehtëson parashtrimin e kërkesës nga pika (dh) paragrafi (1) të këtij neni, nëpërmjet masave siç janë: formular për parashtrim të kërkesës, i cili mund të jetë i plotësuar edhe në formë elektronike në pajtim me ligjin, ndërsa pa u përjashtuar edhe mjetet tjera për komunikim.

(3) Zbatimi i detyrave nga paragrafi (1) i këtij neni është falas për subjektin e të dhënave personale edhe kur ajo është e zbatueshme, për oficerin për mbrojtjen e të dhënave personale.

(4) Kur kërkesat janë dukshëm të pabaza ose jashtë mase, veçanërisht për shkak të përsëritjes së vet, Agjencia mund të paguajë kompensim në bazë të shpenzimeve reale administrative, ose të refuzojë të veprojë për kërkesën. Barra e dëshimit për karakter dukshëm të pabazë ose tej mase të kërkesës i bie Agjencisë. Agjencia kompensimin e cakton me vendim në bazë të vëllimit, kohës dhe ndërlikimit për sigurim të informatës.

(5) Krahas detyrave nga paragrafi (1) i këtij neni, Agjencia mund të:

- iniciojë ndryshime dhe plotësime të ligjeve dhe akteve tjera nënligjore për shkak të harmonizimit të tyre me dispozitat e këtij ligji, si dhe me marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut;

- parashtro propozime të Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut për vlerësim të kushtetutshmërisë të ligjeve dhe kushtetutshmërisë së rregullave të tjera ose akteve të përgjithshme në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale.

Autorizime

Neni 66

(1) Agjencia i ka këto autorizime për hulumtim:

(a) t'i urdhërojë kontrollorit dhe përpunuesit edhe kur është e zbatueshme, përfaqësuesit të autorizuar të kontrollorit ose të përpunuesit, t'i sigurojë të gjitha informatat e nevojshme për zbatimin e detyrave të veta;

(b) të zbatojë supervizion në pajtim me këtë ligji;

(c) të zbatojë rikontrollim të certifikatave të lëshuara në pajtim me nenin 46 paragrafin (6) të këtij ligji;

(ç) ta njoftojë kontrolluesin ose përpunuesin në rastet kur ka dyshim se janë shkelur dispozitat e këtij ligji;

(d) të marrë nga kontrolluesi dhe nga përpunuesi qasje të të gjitha të dhënat personale dhe të të gjitha informatat të cilat janë të nevojshme për zbatimin e detyrave të veta;

(dh) të marrë qasje të të gjitha hapësirat e kontrolluesit dhe përpunuesit, duke përfshirë të çdo pajisje dhe mjete për përpunim të të dhënave personale në pajtim me ligj.

(2) Agjencia i ka këto autorizime korrigjuese:

(a) të lëshojë paralajmërim të kontrolluesit ose përpunuesit kur ekziston gjasë se operacionet e planifikuara të përpunimit të të dhënave personale do t'i shkelin dispozitat e këtij ligji;

(b) të lëshojë sugjerim të kontrolluesit ose të përpunuesit, kur operacionet e përpunimit të të dhënave personale i kanë shkelur dispozitat e këtij ligji;

(c) t'i urdhërojë kontrolluesit ose përpunuesit t'i plotësojë kërkesat e subjektit të të dhënave personale për realizim të të drejtave të subjektit në pajtim me këtë ligj;

(ç) t'i urdhërojë kontrolluesit ose përpunuesit t'i harmonizojë operacionet e përpunimit të të dhënave personale me dispozitat e këtij ligji, si dhe sipas nevojave në mënyrë të caktuar saktë dhe periudhë kohore të caktuar saktë;

(d) t'i urdhërojë kontrolluesit ta njoftojë subjektin e të dhënave personale për prishje të sigurisë së të dhënave personale;

(dh) të shqiptojë kufizim kohor dhe të përhershëm, duke përfshirë ndalim të përpunimit të të dhënave personale;

(e) të urdhërojë korrigjim ose shlyerje të të dhënave personale ose kufizim të përpunimit në pajtim me nenet 20, 21 dhe 22 të këtij ligji, si dhe njoftim për aktivitete rrjedhëse të shfrytëzuesve në të cilat u janë zbardhur të dhëna personale në pajtim me nenin 21 paragrafin (2) dhe neni 23 të këtij ligji;

(ë) ta tërheq certifikatën ose t'i urdhërojë trupit certifikues ta tërheqë certifikatën e lëshuar në pajtim me nenet 46 dhe 47 të këtij ligji, ose t'i urdhërojë trupit certifikues të mos lëshojë certifikatë nëse kërkesat për certifikim nuk janë plotësuar ose tashmë nuk respektohen;

(f) të shqiptojë sanksion kundërvajtës në pajtim me këtë ligj, së bashku me masat ose në vend të masave të cilat janë theksuar në këtë paragraf, ndërsa në varësi nga rrethanat në çdo rast individual;

(g) të urdhërojë pushim të bartjes së të dhënave personale të shfrytëzuesit në vend tjetër ose në organizatë ndërkombëtare.

(3) Agjencia i ka këto autorizime në lidhje me dhënien e lejeve dhe mendimeve:

(a) t'i japë mendime kontrolluesit në pajtim me procedurën për konstatim paraprak sipas nenit 40 të këtij ligji;

(b) me iniciativë personale ose me kërkesë, të japë mendime te Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ose në pajtim me ligj te institucione dhe trupa të tjerë, si dhe te publiku në lidhje me të gjitha çështjet të lidhura me mbrojtjen e të dhënave personale;

(c) të japë leje për përpunim sipas nenit 40 paragrafit (5) të këtij ligji;

(ç) të japë mendim dhe të lejojë propozim-kodeks të miratimit në pajtim me nenin 40 paragrafin (3) të këtij ligji;

(d) të japë certifikata për certifikim në pajtim me nenin 46 paragrafin (4) të këtij ligji;

(dh) të japë mendim pozitiv ose negativ për plotësimin e standardeve dhe normativave për dhënie të akreditimit në pajtim me nenin 47 të këtij ligji;

(e) të miratojë klauzola standarde kontraktuese të cekura në nenin 32 paragrafin (7) dhe nenin 50 paragrafin (2) pikën (v) të këtij ligji;

(ë) të japë leje për klauzolat kontraktuese të theksuara në nenin 50 paragrafin (3) pikën (a) të këtij ligji;

(f) të japë leje për kontratat administrative (administrative) të theksuara në nenin 50 paragrafin (3) pika b) të këtij ligji;

(g) t'i lejojë rregullat e obligueshme korporative në pajtim me nenin 51 të këtij ligji.

(4) Zbatimi i autorizimeve nga Agjencia në pajtim me këtë nen nënshtrohen në masa adekuate mbrojtëse, duke përfshirë mbrojtje efektive juridike dhe procedurë adekuate, në pajtim me ligj.

(5) Agjencia ka autorizim t'i njoftojë gjykatat për cenimet e dispozitave të këtij ligji, si dhe sipas nevojave të fillojë ose në mënyrë tjetër të marrë pjesë në procedura gjyqësore, me qëllim zbatim të dispozitave të këtij ligji.

(6) Drejtori i Agjencisë përcakton udhëzim për veprim të kontrolluesve dhe përpunuesve gjatë përpunimit të të dhënave personale në pajtim me këtë ligj.

(7) Kur gjatë shfrytëzimit të teknologjive për ndonjë lloj të përpunimit, duke i marrë parasysh natyrën, vëllimin, kontekstin dhe qëllimet e përpunimit të të dhënave personale, ekziston gjasë e njëjta të shkaktojë rrezik të madh për të drejtat dhe liritë të personave fizikë, Agjencia mund të shpall vendime, mendime dhe sugjerime të dhëna në ueb faqen e vet.

(8) Vendimet, mendimet dhe sugjerimet nga paragrafi (7) i këtij neni, anonimizohen ose pseudonimizohen.

Marrëdhëniet e Agjencisë me organet e pushtetit shtetëror

Neni 67

(1) Organet e pushtetit shtetëror janë të obliguara ta njoftojnë Agjencinë për masat e ndërmarra për zbatim të kërkesave të veta, propozimeve, mendimeve, rekomandimeve ose sugjerimeve në afatin të cilin Agjencia do ta caktojë, ndërsa më së voni në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës së dorëzuar te Agjencia.

(2) Nëse organi i pushtetit shtetëror nuk e njofton Agjencinë në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni ose kërkesat, propozimet, mendimet, rekomandimet ose sugjerimet e saj vetëm pjesërisht i pranon ose nuk vepron sipas të njëjtave, Agjencia me raport të posaçëm për atë e informon organin drejtpërdrejtë më të lartë, funksionarion i cili udhëheq me organin ose Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, përkatësisht Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(3) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, përkatësisht Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut pas pranimit të raportit të posaçëm për mosrespektim dhe moszbatim të kërkesës, propozimeve, mendimeve, rekomandimeve ose sugjerimeve të Agjencisë, në mbledhje në të cilën në mënyrë të obligueshme merr pjesë funksionari ose personi zyrtar i cili udhëheq me organin e pushtetit shtetëror me të cilin ka të bëjë raporti i veçantë, debaton dhe merr qëndrim me propozim-masa, ndërsa për masat e ndërmarra e njofton Agjencinë në afatin e përcaktuar me raportin e veçantë.

Evidenca e oficerëve për mbrojtje të të dhënave personale

Neni 68

(1) Agjencia mban evidencë të oficerëve për mbrojtjen e të dhënave personale nga neni 41 paragrafi (7) të këtij ligji dhe të njëjtën e shpall në ueb faqen e vet.

(2) Evidenca nga paragrafi (1) i këtij neni përmban:

- emër dhe seli të kontrolluesit, përkatësisht përpunuesit;
- emër dhe mbiemër të oficerit për mbrojtje të të dhënave personale;
- kontakt të dhëna për oficerin për mbrojtje të të dhënave personale (postë elektronike dhe numër telefonik).

Trajnimi për mbrojtje të të dhënave personale

Neni 69

(1) Agjencia përpilon dhe zbaton trajnim për të punësuarit në kontrolluesit, përkatësisht përpunuesit, si dhe për oficerët për mbrojtje të të dhënave personale me ç'rast jep certifikatë, për çka mban evidencë.

(2) Trajnimi organizohet me qëllim të punësuarit të kontrolluesit, përkatësisht përpunuesit të pajisen me dijeni nga sfera e mbrojtjes së të dhënave personale, si dhe me qëllim oficerët për mbrojtje të të dhënave personale të pajisen me dijeni dhe aftësi në lidhje me dërgesat dhe rregullat për mbrojtje të të dhënave personale dhe me aftësi t'i kryejnë punët nga neni 43 i këtij ligji.

(3) Orari i zbatimit të trajnimeve nga paragrafi (1) i këtij neni shpallet në ueb faqen e Agjencisë.

(4) Shpenzimet për trajnim nga paragrafi (1) i këtij neni bien në barë të kontrolluesit, përpunuesit, përkatësisht personit fizik, ndërsa kanë të bëjnë me mbulimin e shpenzimeve reale të nevojshme për organizim dhe zbatim të trajnimit.

(5) Të punësuarve të kontrolluesit, përpunuesit, përkatësisht personi fizik, si dhe për oficerin për mbrojtje të të dhënave personale të cilët kanë marrë pjesë në trajnim, Agjencia u lëshon certifikatë me afat të skadimi prej tre vjetësh nga dita e lëshimit të saj.

(6) Mënyrën e zbatimit të trajnimit të këtij neni, programin për trajnim për mbrojtje të të dhënave personale, formën dhe përmbajtjen e formularit për certifikatë, si dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës për certifikatat e lëshuara e përcakton drejtori i Agjencisë.

(7) Trajnimin nga ky nen e zbatojnë të punësuarit në Agjenci të caktuar nga drejtori i Agjencisë.

Raporti vjetor për punë i Agjencisë

Neni 70

(1) Agjencia përpilon raport vjetor për punën e vet, i cili mund të përfshijë listë të cenimeve për të cilin është njoftuar, si dhe për llojet e masave të ndërmarra në pajtim me nenin 66 paragrafin (2) të këtij ligji.

(2) Agjencia e dorëzon te Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut për shkak të njohjes, raportin vjetor nga paragrafi (1) i këtij neni për vitin paraprak kalendarik, më së voni deri në fund të muajit mars të viti rrijdhës.

(3) Raportin vjetor nga paragrafi (1) i këtij neni, Agjencia e shpall në ueb faqen e saj.

(4) Me nevojë dhe kërkesë nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Agjencia dorëzon edhe raporte plotësuese.

Njoftimi për përpunim (të të dhënave personale) me rrezik të madh

Neni 71

(1) Kur gjatë shfrytëzimit të teknologjive për ndonjë lloj të përpunimit, duke i marrë parasysh natyrën, vëllimin, kontekstin dhe qëllimet e përpunimit të të dhënave personale, ekziston gjasë e njëjta të shkaktojë rrezik të madh për të drejtat dhe liritë e personave fizikë, ndërsa në funksion të nenit 9 paragrafit (2) të këtij ligji, kontrolluesi e njofton Agjencinë.

(2) Njoftimin nga paragrafi (1) i këtij ligji përmban:

1) titullin dhe shumën e të dhënave personale;

2) titullin, përkatësisht emrin dhe mbiemrin dhe kontakt të dhënat e kontrolluesit, nëse është e zbatueshme dhe në të gjitha kontrollet e përbashkëta, të përfaqësuesit të autorizuar të kontrolluesit, nëse i ka, si dhe oficerit për mbrojtje të të dhënave personale;

3) qëllimin ose qëllimin e përpunimit;

4) bazën juridike për vendosje të përmbledhjes së të dhënave personale;

5) përshkrimin e kategorive të subjekteve të të dhënave personale dhe të kategorive të të dhënave personale të cilat kanë të bëjnë me to;

6) kategorinë e shfrytëzuesve të cilëve u janë, ose do t'u jenë zbuluar të dhënat personale, duke përfshirë shfrytëzues në vende të treta ose organizata ndërkombëtare;

7) afatin e ruajtjes së të dhënave personale, përkatësisht afatet e parapara për shlyerje të kategorive të ndryshme të të dhënave personale;

8) bartjen e të dhënave personale në vende të treta ose organizata ndërkombëtare dhe

9) përshkrimin e përgjithshëm të masave të ndërmarra teknike dhe organizative sipas nenit 36 të këtij ligji.

(3) Agjencia mban evidencë elektronike të shumave të të dhënave personale përpunimi i të cilave është me rrezik të madh në të cilën janë përmbajtur të dhënat nga njoftimet në pajtim me dispozitat e këtij neni.

(4) Formën dhe përmbajtjen e formularit të njoftimit, mënyrën e njoftimit nga paragrafi (1) i këtij neni, si dhe formën dhe përmbajtjen e evidencës nga paragrafi (3) i këtij neni i përcakton drejtori i Agjencisë.

3. Bashkëpunimi dhe ndihma juridike ndërkombëtare

Bashkëpunimi

Neni 72

(1) Agjencia mund të bashkëpunojë me organe tjera mbikëqyrëse për mbrojtjen e të dhënave personale në përputhje me këtë ligj në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale. Agjencia dhe organet

mbikëqyrëse të interesuara për mbrojtjen e të dhënave personale mund të shkëmbejnë ndërmjet veti të gjitha informatat përkatëse në mënyrë elektronike, pa përjashtuar edhe mjete tjera për korrespondencë dhe duke zbatuar masa përkatëse teknike dhe organizative për të siguruar fshehtësinë dhe mbrojtjen e përpunimit të të dhënave personale.

(2) Agjencia në çdo kohë mund të kërkojë nga organet tjera mbikëqyrëse për mbrojtjen e të dhënave personale të sigurojnë ndihmë të ndërsjellë në përputhje me nenin 73 të këtij ligji, si dhe mund të kryejnë operacione të përbashkëta në përputhje me nenin 74 të këtij ligji, në veçanti për kryerjen e hulumtimit ose monitorimit të zbatimit të masave në lidhje me kontrolluesin ose përpunuesin, të themeluar jashtë kufijve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Ndihma e ndërsjellë

Neni 73

(1) Agjencia dhe organet tjera mbikëqyrëse për mbrojtjen e të dhënave personale mund të sigurojnë ndërmjet veti informacione përkatëse dhe ndihmë të ndërsjellë, me qëllim të zbatimit konsekuent dhe zbatimit të këtij ligji, si dhe për vendosjen e masave për një bashkëpunim efektiv të ndërsjellë. Ndihma e ndërsjellë, në veçanti përfshin kërkesa për informata dhe masa për mbikëqyrje, siç janë kërkesa për zbatimin e miratimeve dhe konsultimeve paraprake, supervizionit dhe hulumtimit.

(2) Agjencia i merr të gjitha masat adekuate të nevojshme për t'iu përgjigjur kërkesave të një organi tjetër mbikëqyrës për mbrojtjen e të dhënave personale, pa vonesë të panevojshme dhe jo më shumë se një muaj nga data e marrjes së kërkesës. Masat e atilla, në veçanti mund të përfshijnë bartjen e informatave relevante për zbatimin e hulumtimit.

(3) Kërkesat për ndihmë të ndërsjellë i përmbajnë të gjitha informatat e nevojshme, duke përfshirë qëllimin dhe shkaqet e kërkesës. Informatat e shkëmbyera shfrytëzohen në veçanti për qëllimet e nevojshme.

(4) Agjencia nëse pranon kërkesë për ndihmë të ndërsjellë, nuk mund të refuzojë të veprojë sipas kërkesës, përveç se në rastet kur:

(a) nuk është kompetente për lëndën e kërkesës ose për masat të cilat kërkohen t'i ndërmarrë; ose

(b) plotësimi i kërkesës do të ishte në kundërshtim me ligjin.

(5) Agjencia e informon organin mbikëqyrës të prekur për mbrojtjen e të dhënave personale i cili ka paraqitur kërkesë për ndihmë të ndërsjellë për rezultatet ose, varësisht nga rasti, për rrjedhën e masave të ndërmarrë për të përmbushur kërkesën. Agjencia i thekson shkaqet në rast të refuzimit të kërkesës sipas paragrafit (4) të këtij neni.

(6) Agjencia, sipas rregullit i siguron informatat e kërkuara nga organet tjera mbikëqyrëse për mbrojtjen e të dhënave personale, në mënyrë elektronike, pa përjashtuar edhe mjete tjera për korrespondencë dhe duke zbatuar teknika adekuate dhe masa organizative për të siguruar fshehtësinë dhe mbrojtjen e përpunimit të të dhënave personale.

(7) Agjencia nuk do të arkëtojë për aktivitetet të cilat i ka ndërmarrë si përgjigje për kërkesën për ndihmë të ndërsjellë. Agjencia me organet tjera mbikëqyrëse për mbrojtjen e të dhënave personale mund të arrijë marrëveshje lidhur me rregullat për sigurimin e kompensimit të ndërsjellë për shpenzimet konkrete lidhur sigurimin e ndihmës së ndërsjellë në rrethana të jashtëzakonshme.

Operacionet e përbashkëta

Neni 74

(1) Agjencia mund të zbatojë operacione të përbashkëta me organe tjera mbikëqyrëse për mbrojtjen e të dhënave personale, përfshirë hetimet e përbashkëta dhe masat e përbashkëta të veprimit, ku marrin pjesë anëtarët ose punonjësit e organeve mbikëqyrëse që zbatojnë operacion të përbashkët.

(2) Agjencia mund të sigurojë autorizime, përfshirë kompetencat e hetimit, për anëtarët ose punonjësit e organit mbikëqyrës të prekur për mbrojtjen e të dhënave personale të përfshirë në operacionet e përbashkëta në pajtim me ligjin. Këto autorizime për hulumtim mund të kryhen vetëm nën udhëheqësi dhe në prani të të punësuarve të Agjencisë. Anëtarët ose të punësuarit e organit mbikëqyrës të prekur për mbrojtjen e të dhënave personale që marrin pjesë në operacione të përbashkëta i nënshtrohen të drejtës së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(3) Për zbatimin e operacioneve të përbashkëta me organet tjera mbikëqyrëse për mbrojtjen e të dhënave personale Agjencia mund të lidhë memorandume bashkëpunimi për zbatimin e dispozitave të këtij ligji.

Procedura urgjente

Neni 75

Në rrethana të jashtëzakonshme, kur Agjencia konsideron se ka nevojë urgjente për të vepruar për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e subjekteve të të dhënave personale menjëherë mund të marrë masa të përkohshme që çojnë në pasoja juridike në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me afat të caktuar vlefshmërie që nuk tejkalon tre vite, duke llogaritur nga dita e miratimit të masave të përkohshme. Agjencia informon menjëherë organet tjera mbikëqyrëse të prekura për mbrojtjen e të dhënave personale për masat e marra dhe shkaqet për miratimin e tyre.

4. Shërbimi profesional

Neni 76

(1) Për kryerjen e punëve profesionale, normative-juridike, administrative, administrative mbikëqyrëse, të supervizionit, materiale-financiare, të kontabilitetit, punët informatike dhe punët tjera formohet shërbim profesional i Agjencisë.

(2) Drejtori i Agjencisë miraton akte të përgjithshme për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Shërbimit profesional në përputhje me rregullat për të punësuarit e sektorit publik, ku përcaktohen vendet e punës, përkrahimi i punëve dhe detyrave, numri i përgjithshëm i të punësuarve dhe kushtet për çdo vend pune.

(3) Sekretari i përgjithshëm dhe të punësuarit në Shërbimin profesional, përveç personave ndihmës teknikë, kanë statusin e nëpunësve administrativë.

(4) Me shërbimin teknik udhëheq sekretari shtetëror i Agjencisë i cili zgjidhet në përputhje me rregullat për nëpunës administrativë.

(5) Për çështjet që kanë të bëjnë me marrëdhënien e punës për të punësuarit në Agjenci zbatohen dispozitat e Ligjit për nëpunës administrativë, rregullat e përgjithshme për marrëdhënie pune dhe ky ligj.

(6) Shërbimi profesional i kryen punët e fushëveprimit të tij të punës në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe rregullat e miratuara në bazë të tij.

(7) Procedurat për plotësimin e vendeve të punës (punësim, avancim dhe mobilitet gjatë sistematizimit ose marrjes), zbatohen në përputhje me rregullat për nëpunës administrativë, rregullat për të punësuarit në sektorin publik dhe rregullat e përgjithshme për marrëdhëniet e punës, në suaza të mjeteve të siguruara financiare në ndarjen e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut të dedikuar për Agjencinë.

Rroga dhe shtojcat e rrogës së të punësuarve në Shërbimin Profesional të Agjencisë

Neni 77

Të punësuarit në Shërbimin Profesional të Agjencisë kanë të drejtë për rrogë, kompensime të rrogës dhe shtesa të rrogës, në përputhje me rregullat për nëpunës administrativë dhe dispozitat e këtij ligji.

Besueshmëria

Neni 78

Të punësuarit në Agjenci janë të detyruar t'i ruajnë sekret të dhënat që kanë marrë në punën e tyre, si gjatë punësimit në Agjenci, ashtu edhe pas përfundimit të tij dhe që paraqesin të dhëna personale ose informata të klasifikuara në përputhje me ligjin. Të punësuarit në Agjenci janë të detyruar të mbajnë si sekret në veçanti njoftimet nga personat fizikë që kanë të bëjnë me shkeljen e dispozitave të këtij ligji.

5. Financimi i Agjencisë

Mjetet për punë

Neni 79

(1) Mjetet për punën e Agjencisë sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, të hyrat personale nga kompensimet, donacionet dhe burimet tjera, në përputhje me ligjin.

(2) Kompensimet që i paguan Agjencia janë për:

- akreditimin e trupit për monitorimin e harmonizimit të kodeksit të sjelljes sipas nenit 45 të këtij ligji;

- dhënien e certifikatave sipas nenit 46 të këtij ligji;

- dhënien e mendimit për plotësimin e standardeve dhe normativave për dhënien e akreditimit sipas nenit 47 të këtij ligji;

- organizimin dhe zbatimin e trajnimit sipas nenit 69 të këtij ligji; dhe

- kompensimet tjera që Agjencia i paguan nga puna e vet në pajtim me ligjin.

(3) Agjencia kompetencat nga paragrafi (2) i këtij neni i përcakton me vendim në bazë të vëllimit dhe ndërlikueshmërisë për kryerjen e autorizimeve të përcaktuara me këtë ligj.

(4) Të hyrat personale nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni përdoren për të mbuluar shpenzimet për punë investuese dhe rrjedhëse, zhvillim profesional, për trajnimin dhe përsosjen e të punësuarve, si dhe për kryerjen e aktiviteteve të tjera në përputhje me dispozitat e këtij ligji. Shpërndarja e të ardhurave personale kryhet përmes planit financiar të cilin e miraton drejtori i Agjencisë.

(5) Revizionin e punës materiale dhe financiare të Agjencisë e kryen Enti Shtetëror për Revizion.

Buxheti

Neni 80

(1) Mjetet për kryerjen e funksionit të Agjencisë sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(2) Për sigurimin e mjeteve për punën e Agjencisë nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut nga neni 79 i këtij ligji, Agjencia përgatit propozim të cilin ia dërgon Ministrisë së Financave në përputhje me Ligjin për buxhetet.

(3) Drejtori i Agjencisë, dhe në mungesë të tij zëvendës-drejtori i Agjencisë, merr pjesë në mbledhjet e trupave punues të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në të cilat shqyrtohet propozim Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, që t'i prezantojë dhe arsyetojë nevojat për mjetet nga paragrafi (1) i këtij neni.

VII. OPERACIONE TË VEÇANTA TË PËRPUNIMIT TË TË DHËNAVE PERSONALE

Përpunimi dhe liria e shprehjes dhe informimit

Neni 81

(1) Në lidhje me përpunimin e kryer për qëllime gazetareske ose për qëllime të shprehjes akademike, artistike ose letrare, dispozitat e kapitullit II (Parimet), kapitullit III (Të drejtat e subjektit të të dhënave personale), kapitullit IV (Kontrolluesi dhe përpunuesi), kapitullit V (Transferimi i të Dhënave Personale) dhe kapitullit VI (Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale), si dhe dispozitat e këtij kapitulli të këtij Ligji, mund të përjashtohen ose të shmangen, nëse është e nevojshme për të balancuar të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale me lirinë e shprehjes dhe informimit.

(2) Dispozita nga paragrafi (1) i këtij neni, zbatohet veçanërisht në lidhje me përpunimin e të dhënave personale në fushën audiovizuale dhe në arkivat gazetareske (news archives), si dhe në bibliotekat e shtypit (press libraries).

(3) Dispozitat e këtij ligji që kanë të bëjnë me të drejtat e subjekteve të të dhënave personale nuk do të zbatohen mbi përpunimin e të dhënave personale të bëra për qëllime gazetareske vetëm nëse interesi publik mbizotëron mbi interesin privat të subjektit të të dhënave personale.

(4) Gjatë procesit të balancimit të së drejtës së mbrojtjes së të dhënave personale me lirinë e shprehjes dhe informacionit, merren parasysh kriteret në vijim:

- natyra e të dhënave personale;
- rrethanat në të cilat janë marrë të dhënat personale;
- ndikimi i informatës së publikuar ndaj diskutimit për interes publik;
- sa është i njohur personi i prekur fizik dhe cila është lënda e informacionit;
- sjellja paraprake e personit fizik të prekur;
- pëlqimi paraprak i personit fizik të prekur;
- përmbajtja, forma dhe pasojat e publikimit të informatës.

Përpunimi dhe qasja publike te dokumentet zyrtare

Neni 82

Organi i pushtetit shtetëror, organet shtetërore ose personi juridik që kryen autorizime publike të parashikuara me ligj mund të zbulojë të dhëna personale nga dokumentet zyrtare të cilat i posedon, me qëllim të zbatimit të punëve me interes publik në përputhje me ligjin e veçantë, me çka balancohet qasja publike në dokumentet zyrtare me të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale në përputhje me këtë ligj.

Përpunimi i numrit amë të qytetarit

Neni 83

(1) Numri amë i qytetarit mund të përpunohet vetëm:

- me pëlqim të shqiptuar paraprakisht të subjektit të të dhënave personale në pajtim me nenin 11 të këtij ligji;
- për realizimin e të drejtave të përcaktuara me ligj ose obligimeve të subjektit të të dhënave personale ose kontrollorit dhe
- në raste tjera të përcaktuara me ligj.

(2) Vetëm pas marrjes së lejes paraprake nga Agjencia mund të kryhet përpunim sistemor dhe i gjerë i numrit amë të qytetarit, sipas alinesë 1 paragrafit (1) të këtij neni.

(3) Në rastet nga alinetë 2 dhe 3 të paragrafit (1) të këtij neni, në ligj duhet të përfshihen masa mbrojtëse dhe masa të tjera për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të subjekteve të të dhënave personale, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

(4) Për rastet nga paragrafi (2) i këtij neni, Agjencia vendos me vendim në afat prej 90 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës për marrjen e lejes.

(5) Kundër vendimit të Agjencisë nga paragrafi (4) i këtij neni, mund të paraqitet padi për ngritjen e kontestit administrativ në gjykatën kompetente, në afat prej 30 ditëve nga dita e marrjes së vendimit.

(6) Kontrolluesi ose përpunuesi është i detyruar të mbaj llogari që numri amë i qytetarit të mos jetë i dukshëm pa nevojë, i shtypur ose i marrë nga përmbledhja e të dhënave personale.

Leja paraprake

Neni 84

(1) Vetëm me leje të marrë paraprake nga Agjencia kryhet përpunimi i të dhënave personale në vijim;

- të dhënat që kanë të bëjnë me shëndetin e njerëzve;

- të dhëna gjenetike, përveç nëse përpunimi i të dhënave nuk përpunohet nga persona profesionistë për nevojat e mjekësisë parandaluese, diagnozës mjekësore ose kujdesit dhe terapisë së subjektit të të dhënave personale dhe

- të dhënat biometrike.

(2) Leja nga paragrafi (1) i këtij neni nevojitet edhe në rastet kur përpunimi i të dhënave personale kryhet me pëlqimin paraprak të shqiptuar të subjektit të të dhënave personale të dhënë në pajtim me nenin 13 paragrafin (2) pikën 1) të këtij ligji.

(3) Leja nga paragrafi (1) i këtij neni nuk nevojitet në rastet kur përpunimi i të dhënave personale përcaktohet me ligj në të cilin përfshihen masat mbrojtëse dhe masat tjera për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të subjekteve të të dhënave personale në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

(4) Për rastet nga paragrafi (1) i këtij neni, Agjencia vendos me vendim në afat prej 90 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës për marrjen e lejes.

(5) Kundër vendimit të Agjencisë nga paragrafi (4) i këtij neni, mund të paraqitet padi për ngritjen e kontestit administrativ në gjykatën kompetente, në afat prej 30 ditëve nga dita e marrjes së vendimit.

Përpunimi në kontest të punësimit

Neni 85

(1) Me ligj ose marrëveshje kolektive mund të parashihen rregulla më specifike që të përcaktohet mbrojtja e të drejtave dhe lirive në lidhje me përpunimin e të dhënave personale në kontekstin e punësimit, veçanërisht për qëllimet e punësimit, përmbushjen e kontratës për punësim, duke përfshirë përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara me ligj ose marrëveshje kolektive, menaxhimin, planifikimin dhe organizimin e punës, barazinë dhe diversitetin në vendin e punës, shëndetin dhe sigurinë në punë, mbrojtjen e pronës së punëdhënësit ose të konsumatorëve për qëllimet e realizimit dhe përdorimit në baza individuale ose kolektive të të drejtave dhe përfitimeve nga punësimi, e gjithashtu edhe për qëllimet e pushimit të marrëdhënies së punës.

(2) Rregullat nga paragrafi (1) i këtij neni përfshijnë masa të përshtatshme dhe konkrete për mbrojtjen e dinjitetit njerëzor, interesat legjitime dhe të drejtat fundamentale të subjektit të të dhënave personale, veçanërisht në lidhje me transparencën e përpunimit, transferimit të të

dhënave personale në suaza të grupit të personave juridikë ose grupit të personave juridikë që kryejnë veprimtari të përbashkët ekonomike.

(3) Agjencia jep mendim nëse rregullat specifike të parashikuara në ligj ose marrëveshjet kolektive nga paragrafi (1) i këtij neni janë të harmonizuara me këtë ligj.

Masat mbrojtëse dhe shmangiet lidhur me përpunimin për qëllime arkivimi me interes publik, për hulumtime shkencore ose historike ose për qëllime statistikore

Neni 86

(1) Gjatë përpunimit të qëllimeve të arkivimit me interes publik, për hulumtime shkencore ose historike ose për qëllime statistikore, kontrollori është i detyruar të zbatojë masat mbrojtëse përkatëse për të drejtat dhe liritë e subjektit të të dhënave personale në përputhje me këtë ligj. Këto masa mbrojtëse sigurojnë zbatimin e masave teknike dhe organizative, veçanërisht në lidhje me respektimin e parimit të përpunimit të vëllimit minimal të të dhënave. Këto masa mund të përfshijnë pseudonim me kusht, qëllimet e theksuara të mund të arrihen në këtë mënyrë. Kur qëllimet e theksuara mund të arrihen nëpërmjet përpunimit të mëtutjeshëm, që nuk lejon ose nuk lejon më identifikimin e subjekteve të të dhënave personale, ato qëllime arrihen në këtë mënyrë.

(2) Kur të dhënat personale përpunohen për hulumtime shkencore ose historike ose për qëllime statistikore, me ligj mund të parashihen shmangie nga të drejtat e parashikuara në nenet 19, 20, 22 dhe 25 të këtij ligji, në përputhje me kushtet dhe masat mbrojtëse të theksuara në paragrafin (1) të këtij neni, deri në atë shkallë ku ekziston mundësia që këto të drejta ta bëjnë të pamundur ose seriozisht të pengojnë realizimin e qëllimeve konkrete, ndërsa shmangiet e theksuara nevojiten për arritjen e këtyre qëllimeve.

(3) Kur të dhënat personale përpunohen për qëllime të arkivimit me interes publik, me ligj mund të parashihen përjashtime nga të drejtat e theksuara në nenet 19, 20, 22, 23, 24 dhe 25 të këtij ligji, në përputhje me kushtet dhe masat mbrojtëse të theksuara në paragrafin (1) të këtij neni, deri në atë shkallë ku ekziston mundësia që këto të drejta ta bëjnë të pamundur ose seriozisht të pengojnë realizimin e qëllimeve konkrete, ndërsa shmangiet e theksuara nevojiten për arritjen e këtyre qëllimeve.

(4) Kur përpunimi i theksuar në paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni përdoret njëkohësisht edhe për një qëllime tjera, përjashtimet zbatohen vetëm për përpunimin e kryer për qëllimet e theksuara në paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni.

Përpunimi i të dhënave personale nga kishat, bashkësitë fetare ose grupet religjioze

Neni 87

Kishat, bashkësitë fetare ose grupet religjioze i zbatojnë rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale gjatë përpunimit të të dhënave personale të personave fizikë, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Përpunimi i të dhënave për personat e vdekur

Neni 88

(1) Kontrolluesi mund të japë të dhëna personale për personat e vdekur vetëm për ata përdorues të cilët në pajtim me ligjin janë të autorizuar t'i përpunojnë këto të dhëna personale.

(2) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, kontrollori është i detyruar të japë të dhëna për personin e vdekur për personin që është pasardhës ligjor i të ndjerit dhe për shkak të përmbushjes së interesave legjitime në përputhje me ligjin dhe nëse i vdekuri nuk e ka ndaluar me shkrim dhënien e të dhënave të tilla personale.

(3) Kontrolluesi mund t'i japë të dhënat nga paragrafi (2) i këtij neni ç' do personi tjetër i cili do t'i përpunojë këto të dhëna për hulumtime shkencore ose historike ose për qëllime statistikore, nëse i vdekuri nuk e ka ndaluar me shkrim dhënien e të dhënave personale, përveç nëse nuk përcaktohet ndryshe me ligj.

(4) Nëse i vdekuri nuk ka dhënë ndalim në përputhje me paragrafin (3) të këtij neni, personat që sipas ligjit janë trashëgimtarë të tij ligjorë, mundën me shkrim ta ndalojnë dhënien e të dhënave të tij, përveç nëse nuk është parashikuar ndryshe me ligj.

Video mbikëqyrje

Neni 89

(1) Dispozitat nga ky ligj zbatohen edhe në përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet kryerjes së video mbikëqyrjes, përveç nëse me ligj tjetër nuk është paraparë ndryshe.

(2) Dispozitat nga ky ligj nuk zbatohen në përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet kryerjes së video mbikëqyrjes nga ana e personave fizik ekskluzivisht për shkak të aktiviteteve në shtëpinë.

(3) Kontrollori i cili kryen video mbikëqyrje është i detyruar të theksojë njoftim. Njoftimi doemos duhet jetë i qartë, i dukshëm dhe i theksuar në mënyrë që u mundëson subjekteve të të dhënave personale të njihen me kryerjen e video mbikëqyrjes.

(4) Njoftimi nga paragrafi (3) i këtij neni përmban informatë:

- se kryeht video mbikëqyrja,
- për emrin/emërtimin e kontrollorit i cili e kryen video mbikëqyrjen dhe
- për mënyrën në të cilën mund të merren informata pë të atë ku dhe sa kohë ruhen incizimet nga sistemi për video mbikëqyrjen.

(5) Subjekti i të dhënave personale është informuar për përpunimin e të dhënave personale në pajtim me nenet 17 dhe 18 të këtij ligji, nëse është theksuar njoftimi në pajtim me paragrafët (3) dhe (4) të këtij neni.

(6) Kontrollori mund të kryejë video mbikëqyrje vetëm në hapësirën e cila është e mjaftueshme për plotësimin e qëllimeve për të cilat është vendosur.

(7) Kontrollori detyrimisht i njofton të punësuarit për kryerjen e video mbikëqyrjes në hapësira zyrtare ose afariste.

(8) Incizimet e bëra gjatë kryerjes së video mbikëqyrjes ruhen deri në plotësimin e qëllimeve për të cilat kryhet, por jo më gjatë se 30 ditë, përveç nëse me ligj tjetër nuk është paraparë afat më i gjatë në të cilin janë përmbajtur masa mbrojtëse dhe masa tjera për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të subjeteve të të dhënave personale në pajtim me dispozitat nga ky ligj.

(9) Në rast të vendosjes së kamerave në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, pronari i sistemit për kryerjen e video mbikëqyrjes ndërmerr masa për mënjanimin e tyre në shpenzim personal.

Përpunimi i të dhënave personale nëpërmjet sistemit për kryerjen e video mbikëqyrjes

Neni 90

(1) Kontrollori mund të kryejë video mbikëqyrje në hapësira zyrtare ose afariste nëse ajo nevojitet për:

- mbrojtjen e jetës ose shëndetit të njerëzve,
- mbrojtjen e pronësisë,
- mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të të punësuarve për shkak të natyrës së punës ose
- sigurimin e kontrollit mbi hyrjen dhe daljen nga hapësirat zyrtare ose afariste vetëm për qëllime sigurie.

(2) Kontrollori është i detyruar ta rregullojë mënyrën e kryerjes së video mbikëqyrjes me akt të veçantë.

(3) Është e ndaluar kryerja e video mbikëqyrjes në gardëroba, dhomat e zhveshjes, nyje sanitare dhe hapësira tjera të ngjashme.

(4) Përmbajtjen dhe formën e aktit nga paragrafi (2) i këtij neni i përcakton drejtori i Agjencisë.

Kryerja e video mbikëqyrjes në objekte njëbanesore dhe shumëbanesore

Neni 91

(1) Për kryerjen e video mbikëqyrjes në objektet njëbanesore dhe shumëbanesore detyrimisht nevojitet deklarata me shkrim për pëlqim prej së paku 70% nga numri i përgjithshëm i pronarëve, banorëve, përkatësisht qiramarrës të banesave.

(2) Pas sigurimit të pëlqimit nga paragrafi (1) i këtij neni, nevojitet pronarët, banorët, përkatësisht qiramarrësit e banesave detyrimisht të informohen për fillimin e funksionimit të sistemit për kryerjen e video mbikëqyrjes.

(3) Është e ndaluar bartja e incizimeve nga video mbikëqyrjes në objekte njëbanesore dhe shumëbanesore nëpërmjet televizionit kabllorik (rrjeti publik ose intern), nëpërmjet internetit ose mjeteve tjera elektronike për bartjen e të dhënave.

(4) Është e ndaluar incizimi i hyrjeve në banesat individuale të pronarëve, banorëve, përkatësisht qiramarrësve tjerë.

Analizë dhe vlerësim periodik

Neni 92

(1) Kontrollori është i detyruar të kryejë analizë të qëllimit, përkatësisht qëllimeve për të cilën vendoset video mbikëqyrja para fillimit të procesit për vendosjen e sistemit për kryerjen e video mbikëqyrjes, përveç nëse me këtë ligj nuk është paraparë ndryshe.

(2) Analiza nga paragrafi (1) i këtij neni i përmban shkaqet për vendosjen e video mbikëqyrjes me arsyetimin e nevojës për plotësimin e qëllimit, përkatësisht qëllimeve në pajtim me dispozitat nga neni 90 paragrafi (1) të këtij ligji, si dhe përshkrim të sendeve të patundshme dhe të tundshme, përkatësisht hapësirë të cilët do të mbrohen me vendosjen e video mbikëqyrjes.

(3) Kontrollori është i detyruar të kryejë vlerësim periodik të rezultateve të arritura nga sistemi për kryerjen e video mbikëqyrjes çdo dy vjet, ndërsa veçanërisht për:

- nevojën e mëtutjeshme nga shfrytëzimi i sistemit për kryerjen e video mbikëqyrjes,
- qëllimin, përkatësisht qëllimet për kryerjen e video mbikëqyrjes dhe
- zgjidhjet e mundshme teknike për zëvendësimin e sistemit për kryerjen e video mbikëqyrjes.

(4) Nga vlerësimi i kryer nga paragrafi (3) i këtij neni, kontrollori është i detyruar të përpunojë raport si pjesë përbërëse e dokumentacionit për vendosjen e sistemit të kryerjes së video mbikëqyrjes.

(5) Në raportin nga paragrafi (4) i këtij neni, kontrollori detyrimisht i fut edhe indikatorët statistikorë për qasjen në incizimet e bëra gjatë kryerjes së video mbikëqyrjes, si dhe mënyrën e shfrytëzimit të incizimeve.

(6) Përmbajtjen e analizës nga paragrafi (1) i këtij neni dhe raportin nga vlerësimi periodik i kryer i rezultateve të arritura nga sistemi për kryerjen e video mbikëqyrjes i përcakton drejtori i Agjencisë.

Kërkesa për përcaktimin e shkeljes së të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale e cila ka të bëjë me përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet kryerjes së video mbikëqyrjes

Neni 93

(1) Në rast kur personi fizik do të parashtrorë kërkesë për përcaktimin e shkeljes së të drejtës të mbrojtjes së të dhënave personale e cila ka të bëjë me përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet kryerjes së video mbikëqyrjes në objektet njëbanesore dhe shumëbanesore, parashtruesi i kërkesës është i detyruar t'i theksojë të dhënat për personin fizik, përkatësisht juridik kundër të cilit parashtrorë kërkesa edhe atë veçanërisht: emri dhe mbiemri, adresa e vendbanimit, përkatësisht emri dhe selia e personit juridik.

(2) Në rast kur kërkesa nuk i përmban të dhënat e theksuara në paragrafin (1) të këtij neni, parashtruesi është i detyruar me kërkesë të supervizorit të njëjtat t'i dorëzojë në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

(3) Nëse parashtruesi nuk i dorëzon të dhënat nga paragrafi (1) i këtij neni, përkatësisht nuk e plotëson kërkesën në afatin e përcaktuar, dhe për shkak të kësaj për të njëjtën nuk mund të vepohet do të konsiderohet se kërkesa as nuk është parashtruar, për çka supervizori do të miratojë aktvendim për refuzimin e kërkesës e cila nuk përmban këshillë juridike.

(4) Në rast kur është parashtruar kërkesë në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni, personi fizik, përkatësisht juridik kundër të cilit është parashtruar kërkesa është i detyruar me kërkesë të supervizorit të dorëzojë dëshmi në lidhje me kërkesën, ndërsa veçanërisht:

- fotografi nga monitori në të cilin shihen kamerat nga video incizimi (print screen), si dhe fotografi për vendosjen e kamerave nëpërmjet të cilave kryhet video mbikëqyrja, përkatësisht

- deklaratë të verifikuar në noter se nuk kryen video mbikëqyrje të hapësirës e cila është në pronësi, përkatësisht zotërim të parashtruesit të kërkesës, ndërsa në lidhje me të cilin është parashtruar kërkesa ose

- deklaratë se nuk kryen video mbikëqyrje të hapësirës e cila është në pronësi, përkatësisht zotërim të parashtruesit të kërkesës, ndërsa në lidhje me të cilin është parashtruar kërkesa, të dhënë me gojë në procesverbal të përpiluar nga supervizori.

(5) Pas dorëzimit të dëshmive nga paragrafi (4) i këtij neni, supervizori kryen supervizion në pajtim me këtë ligj.

Dhënia e të dhënave personale shfrytëzuesve

Neni 94

(1) Kontrollori do t'ia japë të dhënat personale për shfrytëzim shfrytëzuesit për rast konkret, kur është e zbatueshme, ndërsa në bazë të kërkesës me shkrim nga shfrytëzuesi, nëse ai shfrytëzues në pajtim me ligj është i autorizuar t'i përpunojë ato të dhëna personale.

(2) Nëse obligimi për dhënie e të dhënave personale shfrytëzuesit është përcaktuar me ligj dhe i njëjti bëhet me dinamikë të paraparë, shfrytëzuesi nuk parashtron kërkesë me shkrim te kontrollori në pajtim me dispozitat e këtij neni.

(3) Kërkesa me shkrim nga paragrafi (1) i këtij neni doemos duhet të përmbajë shkaqe, bazë ligjore për shfrytëzimin e të dhënave personale, kategori të subjekteve të të dhënave personale dhe kategori të të dhënave personale të cilat kërkohen.

(4) Kërkesa nga paragrafi (1) i këtij neni mund të parashtrorë edhe në formë elektronike në pajtim me ligj.

(5) Është ndaluar dhënia e të dhënave personale për shfrytëzim shfrytëzuesit përpunimi i të cilave, përkatësisht shfrytëzimi nuk mund të kryhet në pajtim me dispozitat nga nenet 10 dhe 13 të këtij ligji dhe nëse qëllimi për shkak të të cilit kërkohen të dhënat personale është në kundërshtim me nenin 9 paragrafi (1) alineja 2 të këtij ligji.

(6) Të dhënat personale të cilat janë përpunuar për qëllimet e arkivimit me interes publik, për hulumtime shkencore ose historike ose për qëllime statistikore nuk mund t'i jepen për shfrytëzim shfrytëzuesit në formë e cila mundëson identifikimin e personit fizik për të cilin kanë të bëjnë të dhënat personale.

(7) Në rastet nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, kontrollori është i detyruar të mbajë evidencë të veçantë për kategoritë e të dhënave personale të cilat janë dhënë për shfrytëzim, shfrytëzuesin e të dhënave personale, kategorinë e subjekteve të të dhënave personale, bazën ligjore dhe arsyen për të cilën këto të dhëna personale i janë dhënë shfrytëzuesit.

(8) Të dhënat personale të këtij neni mund të shfrytëzohen vetëm në kohën e cila është e domosdoshme për realizimin e qëllimit konkret të paraparë me ligj.

(9) Pas kalimit të kohës nga paragrafi (8) i këtij neni, të dhënat personale doemos duhet të shlyhen, përveç nëse me ligj nuk është paraparë ndryshe.

Shkëmbimi i të dhënave personale

Neni 95

Dispozitat nga neni 94 i këtij ligji për dhënien e të dhënave personale për shfrytëzim kanë të bëjnë edhe me shkëmbimin e të dhënave personale ndërmjet organeve të pushtetit shtetëror dhe organeve shtetërore, përveç nëse me ligj nuk është rregulluar ndryshe.

Marketing i drejtpërdrejtë

Neni 96

Përpunimi i të dhënave personale për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë i cili përfshin edhe profilimin deri në atë shkallë deri në të cilën e njëjta është e lidhur me marketingun e drejtpërdrejtë është e lejuar vetëm nëse të dhënat personale përpunohen me pëlqim të shqiptuar paraprak të subjektit të të dhënave personale në pajtim me nenin 11 të këtij ligji.

VIII. MJETE DHE PËRGJEGJËSI JURIDIKE

E drejtë e parashtrimit të kërkesës në Agjenci

Neni 97

(1) Çdo subjekt i të dhënave personale ka të drejtë të parashtrojë kërkesë në Agjencinë, nëse mendon se përpunimi i të dhënave personale të tij, i shkel dispozitat nga ky ligj, madje duke mos i vënë në pyetje cilat do qoftë mjete tjera administrative ose gjyqësore për mbrojtje juridike.

(2) Agjencia e informon parashtruesin e kërkesës për rrjedhën dhe rezultatin e procedurës, duke e përfshirë mundësinë për mbrojtje gjyqësore në pajtim me nenin 98 të këtij ligji.

(3) Formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni i përcakton drejtori i Agjencisë.

(4) Agjencia do të vendosë nëse gjatë procedurës palës kundërshtuese do t'ia zbulojë të dhënat personale të parashtruesit të kërkesës, si dhe dëshmitarit.

(5) Për kërkesën e parashtruar nga paragrafi (1) i këtij neni, Agjencia zbaton supervizion në pajtim me këtë ligj.

Të drejtë për mbrojtje gjyqësore efektive kundër vendimeve të Agjencisë

Neni 98

(1) Çdo person fizik ose person juridik ka të drejtë për mbrojtje gjyqësore efektive kundër vendimit obligues juridik të Agjencisë që ka të bëjë me atë, me këtë rast duke mos i vënë në pikëpyetje të cilat do qoftë mjete tjera administrative ose jashtë gjyqësore për mbrojtje juridike.

(2) Duke mos i vënë në pyetje cilat do qoftë mjete tjera administrative ose jashtë gjyqësore për mbrojtje juridike, çdo subjekt i të dhënave personale ka të drejtë për mbrojtje gjyqësore efektive, kur Agjencia në pajtim me kompetencat e përcaktuara në nenet 65 dhe 66 të këtij ligji nuk ka vepruar sipas kërkesës ose nuk e ka informuar subjektin e të dhënave personale në afat prej tre muaj për rezultatin e procedurës pas kërkesës së parashtruar sipas nenit 97 të këtij ligji.

Të drejtë për mbrojtje gjyqësore efektive kundër kontrollorit ose përpunuesit

Neni 99

(1) Duke mos i vënë në pikëpyetje cilat do qoftë mjete të qasshme administrative ose jashtë gjyqësore për mbrojtje juridike, duke e përfshirë edhe të drejtën e parashtrimit të kërkesës në Agjencinë në pajtim me nenin 97 të këtij ligji, çdo subjekt i të dhënave personale ka të drejtë për mbrojtje gjyqësore efektive kur konsiderohet se janë shkelur të drejtat e tij të përcaktuara me këtë ligj, si rezultat i përpunimit të të dhënave personale të tij në kundërshtim me këtë ligj.

(2) Subjekti i të dhënave personale të drejtën nga paragrafi (1) i këtij neni, e realizon me parashtrimin e padisë në gjykatën kompetente në pajtim me ligj.

Përfaqësimi i subjekteve të të dhënave personale

Neni 100

(1) Subjekti i të dhënave personale ka të drejtë të autorizojë shoqatë, të parashtrorë kërkesë në emër të tij në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale të tij dhe t'i realizon të drejtat nga nenet 97, 98 dhe 99 të këtij ligji, si dhe kur ajo është paraparë në ligj ta realizojë edhe të drejtën e kompensimit nga neni 101 të këtij ligji.

(2) Në statutin e shoqatës nga paragrafi (1) i këtij neni të themeluar në pajtim me ligj, detyrimisht duhet të theksohen qëllimet të cilat janë me interes publik, karakteri i tij joprofitabil, si dhe e njëjta duhet në mënyrë aktive të veprojë në sferën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të subjekteve të të dhënave personale.

E drejta e kompensimit të dëmit dhe përgjegjësia

Neni 101

(1) Çdo person i cili ka pësuar dëm material ose jomaterial si rezultat i shkeljes së këtij ligji, ka të drejtë të marrë kompensim nga kontrollori ose përpunuesi për dëmin e pësuar.

(2) Çdo kontrollor i cili është i përfshirë në përpunimin e të dhënave personale është përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga ai përpunim që i shkel dispozitat e këtij ligji. Përpunuesi është përgjegjës për dëmin që është shkaktuar nga përpunimi, vetëm nëse nuk i respekton detyrimet e këtij ligji të cilët janë posaçërisht të dedikuara për përpiluesit ose kur ka vepruar jashtë udhëzimit ligjor të kontrollorit ose në kundërshtim me të.

(3) Kontrollori ose përpunuesi përjashtohet nga përgjegjësia në bazë të paragrafit (2) të këtij neni, nëse dëshmon se në asnjë mënyrë nuk është përgjegjës për ngjarjen që e ka shkaktuar dëmin.

(4) kur në përpunimin e njëjtë janë të përfshirë më shumë se një kontrollor ose përpunues ose në të njëjtën përpunim marrin pjesë edhe kontrollor dhe përpunues, dhe kur në pajtim me paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni, ato janë përgjegjës për çfarë do dëmi i shkaktuar me përpunimin, atëherë çdo kontrollor ose përpunues konsiderohet për përgjegjës për tërë dëmin, me qëllim të sigurimit të kompensimit efektiv të dëmit për subjektin e të dhënave personale (përgjegjësi solidare).

(5) Kur kontrollori ose përpunuesi në pajtim me paragrafin (4) të këtij neni ka dërguar kompensim të plotë për dëmin e shkaktuar, kontrolluesi ose përpunuesi kanë të drejtë të kërkojnë nga kontrollorët tjerë ose përpunuesit të cilët janë të përfshirë në të njëjtin përpunim të të dhënave personale, kompensim i cili përgjigjet në pjesën e tyre nga përgjegjësia për dëmin e shkaktuar, në pajtim me kushtet e përcaktuara në paragrafin (2) të këtij neni.

(6) Procedura për realizimin e të drejtës së kompensimit të dëmit të këtij neni udhëhiqet para gjykatës kompetente në pajtim me ligjin.

IX. SUPERVIZION MBI MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Përfshirja dhe autorizimi për zbatimin e supervizionit

Neni 102

(1) Supervizioni mbi mbrojtjen e të dhënave personale në kuptim të këtij ligji është kontroll sistematik dhe i pavarur mbi ligjshmërinë e aktiviteteve të ndërmarra gjatë përpunimit të të dhënave personale dhe mbrojtja e tyre në zbatimin e këtij ligji dhe rregullat e miratuara në bazë të këtij ligji, i cili posaçërisht përfshin hulumtim, kontroll, dhënien e drejtimeve dhe preventivë të kontrollorëve dhe përpunuesve (në tekstin e mëtejshëm: supervizion).

(2) Supervizionin kryen Agjencia përmes supervisorëve për mbrojtjen e të dhënave personale (në tekstin e mëtejshëm: supervisorët).

(3) Supervisorët të cilët kryejnë supervizion, krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara për punësim në pajtim me rregullat për nëpunës administrativë, është e nevojshme të kenë edhe arsimin të lartë nga lëmi i së drejtës ose shkencave informatike.

(4) Supervisorët janë nëpunës administrativë.

Legjitimacioni zyrtar

Neni 103

(1) Agjencia supervisorit i jep legjitimacion zyrtar i cili u shërben për dëshmimin e cilësisë së tij zyrtare dhe i cili është i detyruar ta tregojë gjatë kryerjes së supervizionit.

(2) Forma dhe përmbajtja e legjitimacionit zyrtar nga paragrafi (2) i këtij neni dhe mënyrën e lëshimit dhe heqjes përcaktohen nga drejtori i Agjencisë.

Llojet e supervizionit

Neni 104

(1) Supervizionin, supervisorit e kryen përmes:

- supervizionit të rregullt,
- supervizionit të jashtëzakonshëm dhe
- supervizionit kontrollues.

(2) Supervizioni i rregullt është supervizion i paralajmëruar që kryhet sipas programit vjetor për supervizion që drejtori i Agjencisë e miraton deri në fund të vitit rrjedhës për vitin e ardhshëm.

(3) Supervizioni i jashtëzakonshëm sipas rregullës është supervizion i paparalajmëruar dhe bëhet në rast të kërkesës së paraqitur në pajtim me dispozitat e neneve 93, 97 dhe 100 të këtij ligji, me iniciativë të paraqitur nga organi i pushtetit shtetëror, person juridik ose fizik, sipas detyrës zyrtare ose në rast të dyshimit të supervizionit për shkelje të dispozitave të këtij ligji.

(4) Supervizioni kontrollues, supervisorit mund të kryhet në afat prej gjashtë muajve pas skadimit të afatit të fundit të përcaktuar për eliminimin e shkeljeve të konstatuara me aktvendim nga neni 107 paragrafi (4) të këtij ligji.

(5) Supervizioni nga paragrafi (1) i këtij neni sipas metodës dhe mjeteve të cilët shfrytëzohen mund të bëhet edhe në formë elektronike.

(6) Supervizioni nga paragrafi (1) i këtij neni bëhet në hapësirat e kontrollorit, përkatësisht përpunuesit ku përpunohen të dhënat personale dhe/ose në hapësirat e Agjencisë.

(7) Mënyra e kryerjes së supervizionit nga paragrafi (1) i këtij neni, si dhe formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës për supervizionet e kryera i përcakton drejtori i Agjencisë.

Të drejtat e supervizorit

Neni 105

Gjatë kryerjes së supervizionit, supervizori mund të:

- kontrollon akte të përgjithshme dhe individuale, datoteka, dokumente, dosje kompjuterike, informata dhe dëshmi tjera në vëllim sipas lëndës së supervizionit, si dhe të kërkojë dhe të mbajë kopje nga të njëjtat në letër ose formë elektronike pa kompensim,
- kryen kontroll në hapësirat afariste ose zyrtare dhe objekte tjera ku bëhet përpunimi i të dhënave personale dhe kërkon këqyrje në përpunimin e tyre,
- kryen këqyrje në dokumente për identifikim personal të personave për shkak të vërtetimit të identitetit të tyre në pajtim me ligjin,
- kërkon nga kontrollori, përkatësisht përpunuesi shpjegim me shkrim ose me gojë në lidhje me çështjet nga fushëveprimi i supervizionit,
- kërkon analizë eksperte dhe mendim kur është e nevojshme për supervizion;
- përdor mjete teknike për fotografimin si dhe sigurimin e video incizimeve të cilët mund të shfrytëzohen në supervizion,
- e hulumton pajisjen me të cilën bëhet përpunimi i të dhënave personale dhe pajisjen ku ruhen të dhënat personale, si dhe hulumtimin e sistemit të informatikës dhe infrastrukturën e informatikës në kuadër të së cilave bëhet përpunimi i të dhënave personale, me përfaqësues të autorizuar të kontrollorit, përkatësisht përpunuesit,
- i shfrytëzon pajisjet komunikative të kontrollorit, përkatësisht përpunuesit për shkak të përmbushjes së qëllimeve të supervizionit dhe
- siguron dëshmi të tjera të nevojshme sipas lëndës së supervizionit.

Detyrimet e kontrollorit dhe përpunuesit gjatë supervizionit

Neni 106

Kontrollori, përkatësisht përpunuesi është i detyruar t'i mundësojë supervizorit kryerje të papenguar të supervizionit, e posaçërisht:

- t'i vë në këqyrje të gjitha dokumentet, të dhënat dhe informatat (në formë me letër ose elektronike) të cilët janë të nevojshme për kryerjen e supervizionit, si dhe të sigurojë kopje të të njëjtave nëse është e nevojshme,
- të sigurojë prani të të gjithë personave përgjegjës, përkatësisht të autorizuar të cilët janë të nevojshëm për kryerjen e supervizionit,
- t'i sigurojë kushtet e domosdoshme për punë papengesë dhe përcaktimin e gjendjes faktike dhe
- t'i mundësojë qasje në hapësirat dhe pajisjet ku bëhet përpunimi i të dhënave personale, përkatësisht janë të detyruar me përpunimin e të dhënave personale dhe janë lëndë e supervizionit.

Procesverbali dhe masat në rast të shkeljes së rregullave

Neni 107

(1) Për supervizionin e kryer të rregullt ose të jashtëzakonshëm, supervizori në afat prej 30 ditësh nga dita e përfundimit të supervizionit harton procesverbal me konstatim të gjendjes dhe shkeljeve të përcaktuara, me ç'rast i njëjti i dorëzohet kontrollorit, përkatësisht përpunuesit.

(2) Nëse gjatë supervizionit nuk janë konstatuar shkelje të rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale ose shkeljet e konstatuara janë eliminuar gjatë zbatimit të supervizionit, mbikëqyrjes, përkatësisht deri në miratimin e aktvendimit për eliminimin e shkeljeve të konstatuara gjatë zbatimit të supervizionit, supervizori miraton aktvendim për ndërprerjen e procedurës, kundër së cilës pala e pakënaqur ka të drejtë të paraqesë padi për ngritjen e kontestit administrativ për gjykatën kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

(3) Me përjashtim të paragrafit (2) të këtij neni, nëse gjatë zbatimit të supervizionit e cila kryhet në bazë të kërkesës në pajtim me nenet 97 dhe 100 të këtij ligji, janë përcaktuar shkelje të rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale që janë mënjanuar gjatë zbatimit të supervizionit, përkatësisht deri në miratimin e aktvendimit për eliminimin e shkeljeve të përcaktuara, supervizori në vend të aktvendimit për ndërprerjen e procedurës nga paragrafi (2) i këtij neni, miraton aktvendim me të cilin e pranon kërkesën e neneve 97 dhe 100 të këtij ligji dhe konstaton shkelje të mbrojtjes së të dhënave personale, kundër të cilave pala e pakënaqur ka të drejtë të paraqesë ankesë për ngritjen e kontestit administrativ në gjykatën kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

(4) Për mënjanimin e shkeljeve të përcaktuara supervizori miraton aktvendim, me të cilin posaçërisht i përcakton këto masa korrigjuese:

- kompletim, azhurnim, korrigjim, zbulim ose sigurim të fshehtësisë së të dhënave personale,
- zbatim të masave plotësuese teknike dhe organizuese për sigurimin e fshehtësisë dhe mbrojtjes së përpunimit të të dhënave personale,
- ndalesë të përpunimit të mëtejme të të dhënave personale,
- ndërprerje e bartjes së të dhënave personale në vend tjetër ose organizatë ndërkombëtare,
- sigurim i të dhënave ose bartjen e tyre te subjekte të tjera,
- bllokim, shlyerje ose zhdukje e të dhënave personale,
- demontim, zhvendosje ose heqjen e pajisjeve, sendeve, instalimeve dhe sistemeve me të cilët përpunohen të dhënave personale,
- afat për miratimin e dokumentacionit, përkatësisht rregulla në pajtim me dispozitat e këtij ligji,
- afat për mënjanimin e shkeljeve, ose
- masa të tjera në pajtim me nenin 66 paragrafi 2 i këtij ligji.

(5) Nëse me aktvendimin e paragrafit (4) të këtij neni të kontrollorit, përkatësisht përpunuesit i është përcaktuar afat për veprim në pajtim me këtë ligj, është i detyruar pas skadimit të këtij afati ta njoftojë Agjencinë nëse ka vepruar sipas të njëjtit, si dhe të dorëzoj dëshmi përkatëse.

(6) Kundër aktvendimit të paragrafit (4) të këtij neni mund të parashtrohet padi për ngritjen e kontestit administrativ për gjykatën kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

(7) Dispozitat e këtij neni zbatohen dhe për kërkesën e parashtruar në pajtim me nenin 93 të këtij ligji.

Procesverbali për supervizion kontrollues

Neni 108

(1) Për kontrollin e kryer supervizioni përpilohet procesverbal në të cilin supervizori do të konstatojë se kontrollori, përkatësisht përpunuesi plotësisht ka vepruar, pjesërisht ka vepruar ose nuk ka vepruar sipas aktvendimit nga supervizioni i kryer i rregullt ose jashtëzakonshëm.

(2) Në rast të mosveprimit, përkatësisht veprimit të pjesshëm sipas aktvendimit, supervizori ngrit procedurë kundërvajtëse në pajtim me këtë ligj dhe Ligjin për kundërvajtjet.

Ngritje e procedurës kundërvajtëse

Neni 109

(1) Nëse gjatë zbatimit të supervizionit, supervizori përcakton shkelje të këtij ligji, parashtron kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse për Komisionin Kundërvajtës në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe Ligjit për kundërvajtjet.

(2) Në rast të kryerjes së supervizionit të rregullt, nëse supervizori përcakton shkelje të këtij ose ligji tjetër, me aktvendimin e nenit 170 paragrafi (4) të këtij ligji i përcakton afatet për mënjanimin e shkeljeve të përcaktuara. Pas skadimit të afateve të përcaktuara me aktvendim, supervizori mund të zbatoj kontrollë supervizion në pajtim me këtë ligj.

X. DISPOZITA KUNDËRVAJTËSE

Kundërvajtje të kategorisë I

Neni 110

(1) Gjobë në shumë prej në 2% nga të ardhurat vjetore të përgjithshme të kontrollorit ose përpunuesit - person juridik, (e shprehur në shumën absolute) të realizuar në vitin afarist që i paraprinë vitit kur është kryer shkelja ose nga të ardhurat e përgjithshme të realizuar për periudhë më të shkurtër të vitit që i paraprinë kundërvajtjes, nëse në atë vit personi juridik, ka filluar të punojë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik, nëse: 1) nuk siguron kushte për verifikim se pajtimi është dhënë nga përfaqësuesi ligjor të fëmijës në lidhje të shërbimeve të shoqërisë informatike sipas dispozitave të nenit 12 të këtij ligji;

2) kryen përpunim për të cilat nuk kërkohet identifikim i subjektit të të dhënave personale në kundërshtim të dispozitave të nenit 15 të këtij ligji;

3) nuk zbaton mbrojtje teknike dhe të integruar të të dhënave personale sipas dispozitave të nenit 29 të këtij ligji;

4) nuk i plotëson detyrimet në lidhje të veprimit të kontrollorëve të përbashkët sipas dispozitave të nenit 30 të këtij ligji;

5) nuk përcakton përfaqësues të autorizuar të kontrollorit ose përpunuesit i cili nuk është i themeluar në Republikën e Maqedonisë së Veriut sipas dispozitave të nenit 31 të këtij ligji;

6) gjatë angazhimit të përpunuesve vepron në mënyrë në kundërshtim të dispozitave të nenit 32 të këtij ligji;

7) kryen përpunim pa udhëzime të dhëna nga kontrollori në kundërshtim të dispozitave të nenit 33 të këtij ligji;

8) nuk mban evidencë të aktiviteteve për përpunim sipas dispozitave të nenit 34 të këtij ligji;

9) nuk bashkëpunon me Agjencinë me kërkesë të saj sipas dispozitave të nenit 35 të këtij ligji;

10) nuk e plotëson detyrimin për siguri të përpunimit sipas dispozitave të nenit 36 të këtij ligji;

11) nuk e plotëson detyrimin për njoftim për prishjen e sigurisë së të dhënave personale sipas dispozitave të nenit 37 të këtij ligji;

12) nuk i plotëson detyrimin për njoftimin e subjektit të të dhënave personale për prishjen e sigurisë së të dhënave personale sipas dispozitave të nenit 38 të këtij ligji;

13) nuk kryen vlerësim të ndikimit të mbrojtjes së të dhënave personale sipas dispozitave të nenit 39 të këtij ligji;

14) nuk kryen konsultim paraprak sipas dispozitave të nenit 40 të këtij ligji;

15) nuk e plotëson detyrimin për përcaktimin e oficerit për mbrojtjen e të dhënave personale sipas dispozitave të nenit 41 të këtij ligji;

16) nuk i plotëson detyrimin për sigurimin e pozitës së oficerit për mbrojtjen e të dhënave personale sipas dispozitave të nenit 42 të këtij ligji;

17) nuk i plotëson detyrimin për kryerjen e punëve të oficerit për mbrojtjen e të dhënave personale sipas dispozitave të nenit 43 të këtij ligji;

18) nuk e plotëson detyrimin në lidhje me dhënien e të dhënave personale të shfrytëzuesve në pajtim me dispozitat e nenit 94 të këtij ligji;

19) kryen përpunim të të dhënave personale për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë në kundërshtim me dispozitat e nenit 96 të këtij ligji dhe

20) nuk mundëson kryerje të supervizionit sipas dispozitave të nenit 106 të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 300 deri në 500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës në personin juridik për kundërvajtje të paragrafit (1) të këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 100 deri në 500 euro në kundërvlerë me denarë do të shqiptohet për kundërvajtje personit zyrtar në organet e pushtetit shtetëror për kundërvajtje të kryer të paragrafit (1) të këtij neni.

(4) Gjobë në shumë prej 100 deri në 250 euro në kundërvlerë me denarë do të shqiptohet për kundërvajtje personit fizik ose përpunues për kundërvajtje të kryer të paragrafit (1) të këtij neni.

(5) Gjobë në shumë deri 2% nga të ardhurat e përgjithshme vjetore të trupit që zbaton monitorim të harmonizimit të kodeksit të sjelljes (e shprehur në shumë absolute) i realizuar në vitin afarist që i paraprinë vitit kur është kryer kundërvajtja ose nga të ardhurat e përgjithshme të realizuara për periudhë më të shkurtër të vitit që i paraprinë kundërvajtjes, nëse në atë vit trupi ka filluar të punojë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 45 paragrafi (4) të këtij ligji.

(6) Gjobë në shumë deri 2% nga të ardhurat e përgjithshme vjetore të trupit certifikues (e shprehur në shumën absolute) i realizuar në vitin afarist që i paraprinë vitit kur është kryer kundërvajtja ose nga të ardhurat e përgjithshme të realizuara për periudhë më të shkurtër të vitit që i paraprinë kundërvajtjes, nëse në atë vit trupi certifikues ka filluar të punojë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e neneve 46 dhe 47 të këtij ligji.

(7) Gjobë në shumë prej 300 deri 500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës në trupin që zbaton monitorim të harmonizimit të kodeksit të sjelljes, përkatësisht personit përgjegjës në trupin e certifikuar për kundërvajtjet nga paragrafi (5) dhe (6) të këtij neni.

Kundërvajtje të kategorisë II

Neni 111

(1) Gjobë në shumë deri 4% nga të ardhurat e përgjithshme vjetore të kontrollorit ose përpunuesit-person juridik, (e shprehur në shumën absolute) i realizuar në vitin afarist që i paraprinë vitit kur është kryer kundërvajtja ose nga të ardhurat e përgjithshme të realizuara për periudhë më të shkurtër të vitit që i paraprinë kundërvajtjes, nëse në atë vit personi juridik, ka filluar të punojë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik, nëse:

- 1) nuk vepron sipas parimeve të lidhura me përpunimin e të dhënave personale të parapara në dispozitat e nenit 9 të këtij ligji;
- 2) nuk kryen përpunim ligjor sipas dispozitave të nenit 10 të këtij ligji;
- 3) nuk i siguron kushtet për pëlqim sipas dispozitave të nenit 11 të këtij ligji;
- 4) kryen përpunimin e kategorive të posaçme të të dhënave personale në kundërshtim me dispozitat e nenit 13 të këtij ligji;
- 5) nuk i përmbush detyrimet për realizimin e të drejtave të subjektit të të dhënave personale sipas dispozitave të nenit 16 të këtij ligji;
- 6) nuk dorëzon informata të subjektit të të dhënave personale gjatë grumbullimit
- 7) nuk dorëzon informata të subjektit të të dhënave personale kur të dhënat personale nuk janë marrë nga ai sipas dispozitave të nenit 18 të këtij ligji;
- 8) nuk mundëson qasje subjektit në të dhënat personale sipas dispozitave të nenit 19 të këtij ligji;
- 9) nuk kryen përmirësim të të dhënave personale sipas dispozitave të nenit 20 të këtij ligji;
- 10) nuk i përmbush detyrimet për të drejtën e shlyerjes (të drejtë që të harrohen) sipas dispozitave të nenit 21 të këtij ligji;
- 11) nuk mundëson kufizim të përpunimit të të dhënave personale sipas dispozitave të nenit 22 të këtij ligji;
- 12) nuk e përmbush detyrimin për njoftim gjatë korrigjimit ose shlyerjes së të dhënave personale ose kufizimin e përpunimit sipas dispozitave të nenit 23 të këtij ligji;
- 13) nuk mundëson bartje të të dhënave sipas dispozitave të nenit 24 të këtij ligji;
- 14) nuk vepron për kundërshtimin e paraqitur sipas dispozitave të nenit 25 të këtij ligji;
- 15) nuk i përmbush detyrimet për rregullimin e miratimit automatik të vendimeve individuale, duke përfshirë edhe profilimin sipas dispozitave të nenit 26 të këtij ligji;
- 16) nuk zbaton masa adekuate teknike dhe organizative sipas dispozitave të nenit 28 të këtij ligji;
- 17) nuk vepron sipas parimit të përgjithshëm për bartjen e të dhënave personale të parapara në dispozitat e nenit 48 të këtij ligji;
- 18) bën bartjen e të dhënave personale në bazë të vendimit për përshtatshmëri në kundërshtim me dispozitat e nenit 49 të këtij ligji;
- 19) bën bartjen e të dhënave personale që u nënshtrohet masave adekuate mbrojtëse në kundërshtim me dispozitat e nenit 50 të këtij ligji;
- 20) bën bartjen e të dhënave personale në bazë të rregullave të detyrueshme korporative në kundërshtim me dispozitat e nenit 51 të këtij ligji;
- 21) bën bartjen ose zbulimin e të dhënave personale në kundërshtim me dispozitat e nenit 52 të këtij ligji;
- 22) bën bartjen e të dhënave personale në situata specifike në kundërshtim me dispozitat e nenit 53 të këtij ligji;
- 23) nuk mundëson kryerjen e autorizimeve hulumtuese të Agjencisë sipas dispozitave të nenit 66 paragrafi (1) të këtij ligji;
- 24) nuk vepron për autorizime korrektive të Agjencisë sipas dispozitave të nenit 66 paragrafi (2) të këtij ligji;
- 25) kryen përpunimin e numrit të amzës të qytetarit në kundërshtim me dispozitat e nenit 83 të këtij ligji;
- 26) kryen përpunimin e të dhënave personale pa miratim të marrë paraprak nga Agjencia sipas dispozitave të nenit 84 paragrafi (1) të këtij ligji;
- 27) nuk zbaton masa mbrojtëse sipas dispozitave të nenit 86 paragrafi (1) të këtij ligji dhe
- 28) kryen përpunimin e të dhënave për personat e vdekur në kundërshtim me dispozitat e nenit 88 të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 300 deri 500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës në personin juridik për kundërvajtjen nga paragrafi (1) të këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 100 deri 500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit zyrtar në organet e pushtetit shtetëror për kundërvajtje të kryer nga paragrafi (1) i këtij neni.

(4) Gjobë në shumë prej 100 deri 250 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit fizik-kontrollor ose përpunues për kundërvajtje të kryer nga paragrafi (1) i këtij neni.

Kundërvajtje – video mbikëqyrje

Neni 112

(1) Gjobë me shumë prej 1.000 deri 10.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i për kundërvajtje personit juridik – kontrollorit, nëse:

- 1) kryen video mbikëqyrje në kundërshtim me dispozitat e nenit 89 të këtij ligji;
- 2) bën përpunimin e të dhënave personale përmes sistemit për kryerjen e video mbikëqyrjes në kundërshtim me dispozitat e nenit 90 të këtij ligji;
- 3) kryen video mbikëqyrje në objekte njëbanesore dhe shumëbanesore në kundërshtim të dispozitave të nenit 91 të këtij ligji dhe
- 4) nuk bën analizë dhe vlerësim periodik të dispozitave të nenit 92 të këtij ligji.

(2) Gjobë me shumë prej 100 deri 500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës në personin juridik për kundërvajtje nga paragrafi (1) të këtij neni.

(3) Gjobë me shumë prej 100 deri 500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit zyrtar në organet e pushtetit shtetëror për kundërvajtjen e kryer nga paragrafi (1) të këtij neni.

(4) Gjobë në shumë prej 100 deri 250 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit fizik – kontrollorit ose përpunuesit për kundërvajtjen e kryer nga paragrafi (1) të këtij neni.

Përcaktimi i gjobës

Neni 113

(1) Gjatë përcaktimit të gjobës në çdo rast konkret në mënyrë përkatëse shqyrtohen këto elemente:

- a) natyra, pesha dhe kohëzgjatja e shkeljes, duke marrë parasysh natyrën, vëllimin ose qëllimin e përpunimit përkatës, si dhe numrin e subjekteve të prekura me të dhënat personale dhe shkallën e dëmit të tyre të pësuar;
- b) nëse shkelja është kryer me qëllim ose nga pakujdesia;
- c) çdo aktivitet i ndërmarrë nga kontrollori ose përpunuesi për zbutjen e pasojave nga dëmet e shkaktuara nga ana e subjekteve të të dhënave personale;
- ç) shkalla e përgjegjësisë së kontrollorit ose përpunuesit, duke marrë parasysh masat teknike dhe organizuese të cilat zbatohen në pajtim me nenet 29 dhe 36 të këtij ligji;
- d) të gjitha kundërvajtjes relevante paraprake nga ana e kontrollorit ose përpunuesit;
- dh) shkalla e bashkëpunimit me Agjencinë me qëllim të mënjanimin të shkeljes dhe zbutjes së mundësive të efekteve negative nga ajo shkelje;
- e) kategoritë e të dhënave personale mbi të cilat ndikon shkelja;
- ë) mënyra në të cilën Agjencia ka njohuri për shkeljen, në veçanti nëse deri në cilën shkallë kontrollori ose përpunuesi e ka informuar për shkeljen;

f) nëse kundër kontrollorit ose përpunuesit lidhur me lëndën e njëjtë të përpunimit paraprakisht u janë shqiptuar masa nga neni 66 paragrafi (2) të këtij ligji, harmonizimi i tij me këto masa; g) respektimi i kodeve të miratuara për sjellje në pajtim me nenin 44 të këtij ligji ose mekanizmat e lejuar për certifikim në pajtim me nenin 46 të këtij ligji dhe

gj) të gjithë faktorët tjerë vështirësues ose lehtësues të cilat janë të zbatueshme të rrethanave në rast, siç janë realizuar përfitimet financiare direkt ose indirekt ose shmangia e humbjeve për shkak të shkeljes.

(2) Nëse kontrolluesi ose përpunuesi i të njëjtës ose për operacione të lidhura të përpunimit me qëllim ose nga pakujdesia ka shkelë disa dispozita të këtij ligji, shuma e plotë e gjobës nuk mund të tejkalojë shumën e përcaktuar për kundërvajtjen më të rëndë.

Kompetenca për kundërvajtje

Neni 114

(1) Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 110, 111 dhe 112 të këtij ligji, procedurë kundërvajtëse dhe sanksion kundërvajtës shqipton Agjencia (në tekstin e mëtejme: Organi kundërvajtës).

(2) Procedurën kundërvajtëse nga paragrafi (1) i këtij neni e mban Komisioni për vendimarrje për kundërvajtje (në tekstin e mëtejme: Komisioni kundërvajtës) i formuar nga ana e drejtorit të Agjencisë.

(3) Komisioni kundërvajtës përbëhet nga dy anëtarë dhe kryetari i Komisionit me zëvendësit e tyre.

(4) Anëtarët e Komisionit dhe zëvendësit e tyre duhet të kenë arsim sipëror dhe përvojë pune prej së paku një vit nga materia në fjalë, prej të cilës së paku njëri është jurist i diplomuar me provimin e dhënë të jurisprudencës.

(5) Mandati i anëtarëve të Komisionit kundërvajtës dhe zëvendësve të tyre është me kohëzgjatje prej dy vjetëve me të drejtë të rizgjedhjes.

(6) Krahas anëtarëve të Komisionit kundërvajtës dhe zëvendësve të tyre drjetori i Agjencisë mund të caktojë sekretar të Komisionit kundërvajtës i cili kryen punë administrative për Komisionin.

(7) Komisioni kundërvajtës miraton rregullore për punën e vet.

(8) Komisioni kundërvajtës ka të drejtë të nxjerr prova dhe grumbullojë të dhëna të cilat janë të domosdoshme për përcaktimin e kundërvajtjes, si dhe të kryejë punë të tjera dhe të ndërmerr veprime të përcaktuara me këtë ligj, Ligjin për kundërvajtje ose me ligj tjetër.

Mbrojtja gjyqësore në procedurën kundërvajtëse

Neni 115

(1) Kundër vendimit të Komisionit kundërvajtës lejohet shfrytëzimi i mjeteve juridike në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.

Parashkrimi

Neni 116

(1) Procedura kundërvajtëse nuk mundet të ngritet as të mbahet nëse kalojnë dy vjet nga dita kur ka ndodhur shkelja e ndonjë të drejte të garantuar me këtë ligj.

(2) Parashkrimi i ndjekjes kundërvajtëse fillon nga dita kur është kryer shkelja e ndonjë të drejte të garantuar me ligj.

(3) Parashkrimi nuk rrjedh gjatë kohës që sipas ligjit ndjekja nuk mund të fillojë ose të vazhtojë.

(4) Parashkrimi ndërpritet me çdo veprim të procesit që ndërmerret për shkak të ndjekjes së kryerësit të shkeljes.

(5) Parashkrimi ndërpritet edhe kur kryerësi gjatë kohës derisa rrjedh afati i parashkrimit kryen kundërvajtje të njëjtë të rëndë ose më të rëndë.

(6) Pas çdo ndërprerje parashkrimi fillon përsëri të rrjedh.

(7) Parashkrimi i ndjekjes kundërvajtëse shkaktohet në çdo rast kur do të kalojë dy herë më shumë kohë sesa kërkohet sipas ligjit për parashkrimin e ndjekjes kundërvajtëse.

XI. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Procedura të filluara

Neni 117

(1) Procedurat e filluara për mbikëqyrjen inspektuese, përkatësisht procedurat kundërvajtëse para ditës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të përfundojnë në pajtim me dispozitat e këtij ligji, nëse ato janë më të volitshme për kontrollorin, përkatësisht përpunuesin.

(2) Procedurat e filluara administrative para ditës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të përfundojnë sipas dispozitave të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 124/15) dhe Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 7/2005, 103/2008, 124/10, 135/11, 43/14, 153/15, 99/16 dhe 64/18), nëse ato janë më të volitshme për palët.

(3) Veprimet e ndërmarra lidhur me mbikëqyrjen inspektuese të cilat kanë filluar para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të përfundojnë në pajtim me dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 7/05, 103/08, 124/10, 135/11, 43/14, 153/15, 99/16 dhe 64/18) dhe dispozitat e miratuara në bazë të atij ligji.

Regjimi kalimtar i Agjencisë

Neni 118

(1) Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, vazhdon të punojë si Agjenci për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

(2) Të punësuarit nga Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji vazhdojnë të punojnë në Agjenci.

(3) Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, Agjencia i merr lëndët, arkivin, materialet, mjetet teknike dhe mjetet tjera për punë të nevojshme për zbatimin e këtij ligji nga Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

(4) Agjencia do ta harmonizojë punën e vet në pajtim me dispozitat e këtij ligji në afat prej 18 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(5) Regjistri qendror i përmbledhjeve të të dhënave personale që është i vendosur me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 7/2005, 103/2008, 124/10, 135/11, 43/14, 153/15, 99/16 dhe 64/18) do të vazhdojë të funksionojë si evidencë e përmbledhjeve të të dhënave personale me rrezik të lartë në pajtim me dispozitat e këtij ligji, me ç’rast kontrollorët janë të obliguar në afat prej 18 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji të dorëzojnë informim për përmbledhjet e paraqitura të të dhënave personale, sipas dispozitave të nenit 71 të këtij ligji. Pas aderimit të Republikës së Maqedonisë së

Veriut në Bashkimin Evropian, dispozitat e nenit 71 të këtij ligji të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e evidences së përmbledhjeve të të dhënave personale me rrezik të lartë do të shfuqizohen, me ç'rast të dhënat e përmbajtura në evidencë ruhen përgjithmonë në pajtim me dispozitat për material arkivor.

(6) Drejtori dhe zëvendësdrejtori i Drejtorisë, në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do ta kryejnë funksionin e vet si drejtor dhe zëvendësdrejtor të Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, deri në ditën e skadimit të mandatit të tyre sipas Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 7/05, 103/08, 124/10, 135/11, 43/14, 153/15, 99/16 и 64/18).7/2005, 103/2008, 124/10, 135/11, 43/14, 153/15, 99/16 dhe 64/18). (7) Agjencia është trashëgimtar juridik i të gjitha të drejtave dhe obligimeve të Drejtorisë për Mbrojtjen e të Dhëna Personale.

Periudha e harmonizimit

Neni 119

Kontrollorët dhe përpunuesit janë të obliguar ta harmonizojnë punën e vet në pajtim me dispozitat e këtij ligji në afat prej 18 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Harmonizimi i dispozitave me të cilat rregullohet grumbullimi, përpunimi, ruajtja, përdorimi dhe dërzimi i të dhënave personale

Neni 120

Ligjet dhe dispozitat tjera me të cilat rregullohet grumbullimi, përpunimi, ruajtja, pëpunimi, ruajtja, shfrytëzimi dhe dorëzimi i të dhënave personale, do të harmonizohen me dispozitat e këtij ligji në afat prej 18 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Periudha e miratimit të akteve nënligjore

Neni 121

(1) Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj, drejtori i Agjencisë do t'i miratojë në afat prej 18 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Deri në fillimin e zbatimit të dispozitave nga paragrafi (1) i këtij neni do të zbatohen dispozitat ekzistuese nëse nuk janë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

Shfuqizimi i zbatimit

Neni 122

Dispozitat nga kreu II (përpos nenit 12), III, IV (përpos neneve 46 dhe 47), V dhe VIII të këtij ligji do të shfuqizohen deri në aderimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Evropian.

Shfuqizimi

Neni 123

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 7/2005, 103/2008, 124/10, 135/11, 43/14, 153/15, 99/16 dhe 64/18).

Hyrja në fuqi

Neni 124

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.